

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS
BOTIME TË VEÇANTA CXXVIII
SEKSIONI I SHKENCAVE SHOQËRORE
LIBRI 42

JUSUF OSMANI, RAMË MANAJ

**NDARJA ADMINISTRATIVO-
TERRITORIALE E KOSOVËS 1944-2010**



PRISHTINË
2014

KOSOVA ACADEMY OF SCIENCES AND ARTS
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS
SPECIAL EDITIONS CXXVIII
SECTION OF SOCIAL SCIENCES
BOOK 42

JUSUF OSMANI, RAMË MANAJ

**ADMINISTRATIVE AND TERRITORIAL
DIVISION OF KOSOVO 1944 - 2010**

Approved for publication at the meeting of the section of social science
held on 15 May 2014 after review by
prof. dr. Jusuf Arafati and prof. dr. Arif Ramizi

Editor: Academician Arif Ramizi, Secretary of the section of social science



PRISHTINA
2014

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS
BOTIME TË VEÇANTA CXXVIII
SEKSIONI I SHKENCAVE SHOQËRORE
LIBRI 42

JUSUF OSMANI, RAMË MANAJ

NDARJA ADMINISTRATIVO- TERRITORIALE E KOSOVËS 1944-2010

U miratua për botim në mbledhjen e Seksionit të Shkencave Shoqërore,
mbajtur më 29 maj 2013, në bazë të recensioneve të
prof. dr. Jusuf Bajraktari dhe prof. dr. Arsim Bajrami.

Redaktor: Akademik Mark Krasniqi, Sekretar i Seksionit të Shkencave Shoqërore.



Copyright © ASHAK

PËRMBAJTJA

PARATHËNIE	11
PJESA E PARË	13
HYRJE.....	15
NDARJA ADMINISTRATIVE-TERRITORIALE E KOSOVËS PAS LUFTËS SË DYTË BOTËRORE	19
Konferenca e Bujanit.....	19
Administratimi ushtarak.....	21
NDARJA ADMINISTRATIVE-TERRITORIALE E KOSOVËS NË KËSHILLA POPULLORË TË RRETHEVE DHE KËSHILLA POPULLORË TË VENDEVE	23
NDARJA ADMINISTRATIVE-TERRITORIALE E KOSOVËS NË KËSHILLA POPULLORË TË KOMUNAVE, RRETHEVE DHE QYTETEVE	33
NDARJA ADMINISTRATIVE-TERRITORIALE E KOSOVËS NË KOMUNA	41
ORGANIZIMI TERRITORIAL I KOSOVËS PAS SUPRIMIMI TË AUTONOMISË SË KOSOVËS MË 1989.....	51
NDARJA ADMINISTRATIVE-TERRITORIALE E KOSOVËS PAS ÇLIRIMIT	55
DECENTRALIZIMI I KOSOVËS – FORMIMI I KOMUNAVE TË REJA	57
Rekomandimet e faktorit ndërkombëtar për decentralizimin në Kosovë.....	57
Decentralizimi i zbatuar në Kosovë	58
Komuna e Novobërdës.....	60
Komuna e Hanit të Elezit.....	60
Komuna e Junikut	61
Komuna e Mamushës	61
Komuna e Graçanicës	62
Komuna e Kllkotit.....	63
Komuna e Ranillugut	63
Komuna Partesh-Pasjan	63
Kosova sot.....	63

PJESA E DYTË DOKUMENTE	65
PREZANTIMI DHE PUBLIKIMI I DOKUMENTEVE	67
DOKUMENTI 1	70
DOKUMENTI 2	72
DOKUMENTI 3	73
Ligji për ndarjen administrative të Serbisë	73
DOKUMENTI 4	75
Ligji për themelimin dhe rregullimin e Krahinës Autonome të Kosovës dhe Metohisë.....	75
DOKUMENTI 5	77
Vendimi i Kuvendit Kushtetues të Republikës Popullore Fedrative të Jugosllavisë për shpalljen e kushtetutës të Republikës Popullore Fedrative të Jugosllavisë	77
KUSHTETUTA E REPUBLIKËS POPULLORE FEDERATIVE TË JUGOSLLAVISË	78
DOKUMENTI 6	81
Ligji i përgjithshëm për Këshillat Popullorë.....	81
DOKUMENTI 7	86
Ligji për ndryshimin e ligjit për rregullimin dhe formimin e Krahinës Autonome të Kosovë dhe Metohisë	86
DOKUMENTI 8	87
Ligji për ndarjen administrative-territoriale të Republikës së Serbisë	87
DOKUMENTI 9	107
Vendimi kushtetues i Kuvendit të Republikës së Serbisë për shpalljen e kushtetutës së Republikës së Serbisë.....	107
DOKUMENTI 10	112
Ligji për shpalljen e Prishtinës, Pejës dhe Mitrovicës për qytete	112
DOKUMENTI 11	113
DOKUMENTI 12	115
Statuti i Krahinës Autonome i Kosovës e Metohisë në Republikën Popullore të Serbisë	115
DOKUMENTI 13	117
Dekreti për ndryshimet administrative-territoriale	117
DOKUMENTI 14	119
DEKRET.....	119
Ligji për ndryshimet dhe plotësimet e ligjit për ndarjen administrative-territoriale të Republikës së Serbisë	119

DOKUMENTI 15	121
Dekreti për ndryshimet administrative territoriale në territorin e Republikës Popullore të Serbisë	121
DOKUMENTI 16	126
Ligji për ndarjen administrative-territoriale të Republikës Popullore të Serbisë	126
DOKUMENTI 17	146
DOKUMENTI 18	147
Ligji për ndarjen e territorit të Republikës Popullore të Serbisë në komuna, qytete dhe rrethe.....	147
DOKUMENTI 19	161
Ligji për zbatimin e riorganizimit të Këshillave Popullore.....	161
DOKUMENTI 20	162
Statuti i Krahinës Autonome të Kosovës e Metohisë	162
DOKUMENTI 21	163
Dekret për shpalljen e ligjit për ndryshimet dhe plotësimet e ligjit për ndarjen territoriale të Republikës Popullore të Serbisë në komuna, qytete dhe rrethe.....	163
DOKUMENTI 22	166
Hartë – Pasqyrë e vendeve në Krahinën e K. e M. për ndarjen administrative-territoriale.....	166
DOKUMENTI 23	167
Dekret për shpalljen e ligjit për territoret e rretheve dhe komunave në Republikën Popullore të Serbisë.....	167
Ligji për territorin e rretheve dhe komunave të Republikës Popullore të Serbisë	167
DOKUMENTI 24	178
Statuti i Krahinës Autonome të Kosovës e Metohisë	178
DOKUMENTI 25	180
Dekret për shpalljen e ligjit për ndryshimet dhe plotësimet e ligjit për territoret e rretheve dhe komunave në Republikën Popullore të Serbisë....	180
Ligji për ndryshimet dhe plotësimet e ligjit për territoret e rretheve dhe komunave në Republikën Popullore të Serbisë	180
DOKUMENTI 26	183
Dekret për shpalljen e ligjit për ndryshimet dhe plotësimet e ligjit për territoret e rretheve dhe komunave në Republikën Popullore të Serbisë....	183
Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për territorin e rretheve dhe komunave në Republikën Popullore të Serbisë	184

DOKUMENTI 27	194
DOKUMENTI 28	195
VENDIM PËR SUPRIMIMIN E RRETHEVE NË KRAHINËN AUTONOME TË KOSOVËS E METOHISË	195
DOKUMENTI 29	201
Dekret për shpalljen e ligjit për territoret e komunave dhe rretheve në Republikën Popullore të Serbisë.....	201
Ligji për territoret e komunave dhe rretheve në Republikën Popullore të Serbisë	202
DOKUMENTI 30	220
Ligji kushtetues i krahinës socialiste autonome të Kosovës	221
DOKUMENTI 31	222
KUSHTETUTA E KRAHINËS SOCIALISTE AUTONOME TË KOSOVËS	223
DOKUMENTI 32	225
Ligji për organizimin territorial të komunave.....	225
DOKUMENTI 33	241
Ligji mbi ndryshimet dhe plotësimet e ligjit për organizimin territorial të komunave.....	241
DOKUMENTI 34	243
Ligji për formimin e komunës së Malishevës	243
DOKUMENTI 35	245
Ligji për ndryshimet dhe plotësimet e ligjit mbi organizimin territorial të komunave.....	245
DOKUMENTI 36	247
Dekret për shpalljen e ligjit për formimin e komunës së Zubin Potokut ...	247
Ligji për formimin e komunës së Zubin Potokut	247
DOKUMENTI 37	249
Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit mbi organizimin territorial të komunave.....	249
DOKUMENTI 38	251
Dekret për shpalljen e ligjit për formimin e komunave Shtimje dhe Shterpçë.....	251
Ligji për formimin e komunave Shtime dhe Shterpçë	251
DOKUMENTI 39	253
Ligji për ndryshimet dhe plotësimet e ligjit për organizimin territorial të komunave.....	253
DOKUMENTI 40	255

KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS	255
DOKUMENTI 41	257
RREGULLORE NR. 2000/43	257
TABELA “B”	259
DOKUMENTI 42	274
KUSHTETUTA E PËRKOHSHME E KOSOVËS	274
RREGULLORE NR. 2001/9 për kornizën kushtetuese të vetëqeverisjes së përkohshme në Kosovë.....	274
DOKUMENTI 43	277
URDHËRESË ADMINISTRATIVE NR. 2004/23	277
Për zbatimin e rregullores së ndryshar të UNMIK-ut nr. 2003/43 për numrat, emrat dhe kufijtë administrativë të komunave.....	277
DOKUMENTI 44	293
KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS	293
Dispozitat themelore.....	293
DOKUMENTI 45	295
Ligji nr. 03/l-041 për kufijtë administrativë të komunave	295
SUMMARY	319
ADMINISTRATIVE AND TERRITORIAL DIVISION OF KOSOVO 1944 - 2010	319
SHKURTESAT	321
BURIMET DHE LITERATURA.....	322

PARATHËNIE

Sa i përket ndarjes territoriale-administrative gjatë së kaluarës historike, territori i Kosovës sikurse edhe territoret e tjera shqiptare, varësisht nga sunduesit e ndryshëm, pësonte ndryshime. Çdo sundues në këto treva kishte organizuar dhe vendosur pushtetin e vet në bazë të sistemit administrativ që e kishte organizuar në vendin e vet. Kështu ishte vepruar edhe me trevën e Kosovës.

Ndarja administrative-territoriale e Kosovës sidomos pas Luftës së Dytë Botërore, nga aspekti shkencor deri më tani nuk është trajtuar në ndonjë botim të veçantë. Siç është e ditur, trevat e Kosovës pas Luftës së Dytë Botërore, pa dëshirën e popullit vihen nën administrim të Republikës Federative Popullore të Jugosllavisë, përkatësisht Republikës Popullore të Serbisë, andaj në aspektin e rregullimit administrativ-territorial të gjitha kompetencat i merr Republika e Serbisë. Ky status i Kosovës me disa ndryshime të vogla zgjatë deri në vitin 1974, kur me Kushtetutën e re të Jugosllavisë Kosova bëhet element konstituiv në Federatën Jugosllave. Dispozita e parë e rregullimit administrativ-territorial për Kosovën miratohet nga ana e Kuvendit të Kosovës në vitin 1975.

Ndarja e parë administrative e Kosovës pas Luftës së Dytë Botërore është bërë në vitin 1945 me Ligjin për Kosovën. Republika Popullore e Serbisë, në krahasim me republikat e tjera, në përbërjen e vet kishte dy krahina autonome. Ajo nxori ligjet që përcaktuan se Serbia si njësi federale përbëhet nga qarqet dhe nga Provinca Autonome e Vojvodinës dhe Krahina Autonome e Kosovës dhe Metohisë. Ajo përkitazi me Kosovën aprovoi “Ligjin për themelimin dhe rregullimin e Krahinës Autonome të Kosovës dhe Metohisë”. Ndërsa dispozita e fundit që e rregullon ndarjen administrative të Kosovës të bazuar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës është prurë më 15 qershor 2008, kur miratohet ligji për kufijtë administrativë të komunave.

Kjo vepër paraqet kontribut për ndriçimin e ndarjes administrative-territoriale të Kosovës, e cila deri në periudhën e

çlirimit të vendit më 1999 kryesisht është bërë për interesa të pushtetit, me disa përjashtime. Në këto shqyrtime së pari të bëhet hulumtimi i literaturës së shkruar për këtë ndarje e pastaj hulumtimi dhe studimi i dispozitave (kushtetutave, ligjeve, dekreteve, udhëzimeve administrative etj.) të botuara në gazeta zyrtare ose në ndonjë botim të veçantë.

Dokumentet janë marrë kryesisht nga fondet dhe koleksionet e Arkivit Shtetëror të Kosovës dhe Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës. Këto dokumente kryesisht janë publikuar në gazetatat zyrtare të ish-Republikës Federative Popullore të Jugosllavisë, Republikës Popullore të Serbisë dhe të ish-Krahinës Autonome Socialiste të Kosovës, tani të Republikës së Kosovës, si dhe në ndonjë publikim të veçantë.

Çështja e ndarjes administrative–territoriale, si dhe procesi i decentralizimit në Kosovë në vitet e fundit ka zgjuar interesim për opinion, meqë ende ekzistojnë disa paqartësi rreth ndarjes territoriale e administrative të Kosovës në periudha të caktuara kohore, si dhe për shkak të qëllimit të decentralizimit.

PJESA E PARË

HYRJE

Territori i Kosovës së sotme që nga lashtësia ishte territor i banuar nga ilirët, përkatësisht fisi dardanë. Para pushtimeve romake Dardania ishte bashkësi e pavarur politike, kulturore e fetare dhe njihet me emrin Mbretëria Dardane. Në aspektin territorial-administrativ Dardania përfshinte një sipërfaqe mjaft të gjerë, sepse e përfshinte pjesën e epërme të rrjedhës së Vardarit, pjesën e epërme të Drinit të Bardhë, Fushën e Kosovës e deri te Nishi. I tërë Ballkani qendror gjatë kohës së sundimit romak quhej *Iliricum – Iliri*. Dardania kishte shumë vendbanime të vogla dhe qendra të mëdha. Ndërsa, siç dihet, Shkupi ishte kryeqytet i Dardanisë. Periudha e sundimit romak në këtë trevë filloi me nënshtrimin e Dardanisë nën romakët në fillim të shek. II para erës së re dhe zgjati deri me ndarjen e Perandorisë Romake. Me emrin *Iliricum* është quajtur Gadishulli Ballkanik deri në fund të shek. XVIII dhe në fillim të shek. XX.

Pas sundimit romak, përkatësisht bizantin, pastaj një kohë edhe bullgar, tokat shqiptare në shekullin XII u pushtuan nga sllavët. Stefan Nemanja e zgjeroi pushtetin e vet në pjesën më të madhe të tokave shqiptare. Stefan Dushani gjatë shek. XIII në Perandorinë e vet përfshiu edhe pjesën më të madhe të tokave shqiptare.

Osmanlinjtë depërtojnë në Kosovë në vitin 1389, ku zhvillohet edhe Beteja e Kosovës. Pas pushtimit të pjesës më të madhe të territorit të sotëm të Kosovës, në vitin 1455 formojnë njësinë territoriale e administrative, të cilën e pagëzojnë me emrin "*Vilajeti Vëllk*", sipas sundimitarit të kohës së parapushtimit osman Vuk Brankoviçit. Vilajeti i Vëllkut shndërrohet në sanxhak që në kohën e sundimit të sulltan Mehmetit II dhe njihet me emrin Sanxhaku i Vushtrrisë.¹

Bazuar në të dhënat burimore të njohura deri më tash del se territori i sotëm i Kosovës në shekujt XV e XVI në pikëpamje administrative

¹ Hazim Šabanović, Upravna podjela jugoslovenskih zemalja pod turskom vlašću do Karlovačkog mira 1699, "Godišnjak istorijskog društva Bosne i Hercegovine", Sarajevo, 1952, fq. 177.

bënte pjesë në kuadrin e sanxhaqeve të Vushtrrisë, të Prizrenit, të Dukagjinit dhe të Shkodrës.² Përjashtim bënë disa vise rreth Zveçanit e Mitrovicës, që bënë pjesë në gjirin e Pashallëkut të Bosnës, si dhe Kaçaniku me rrethinë, i cili gjendej në kuadrin e Vilajetit, përkatësisht Sanxhakut të Shkupit.³

Në vitin 1864 është aprovuar Ligji për vilajetet, kurse në vitin 1868 u bë riorganizimi i ri, kështu që u formua Vilajeti i Prizrenit me seli në Prizren. Ky Vilajet ishte i ndarë në katër sanxhaqe: i Prizrenit, i Shkupit, i Dibrës dhe i Nishit. Më vonë, me reformat e vitit 1877, u formua Vilajeti i Kosovës me qendër në Prishtinë, kurse prej vitit 1888 në Shkup.

Në kuadër të Perandorisë Osmane deri në vitin 1878, kur Vilajetit të Kosovës i merret Sanxhaku i Nishit nga Serbia dhe disa pjesë të tjera dëbohen me dhunë nga ato vise shqiptarët. Popullata shqiptare shtrihej përveç në Vilajetin e Kosovës edhe në Vilajetin e Janinës, Shkodrës dhe të Manastirit. Prej këtyre vilajeteve padyshim më i madhi ishte Vilajeti i Kosovës, që përfshinte territoret në veri deri përtej Nishit, në veriperëndim territoret përtej Sjenicës, në jug deri përtej Dibrës dhe në lindje deri përtej Vranjës.

Pas pushtimit të Kosovës (1912) nga Serbia dhe Mali i Zi menjëherë filloi edhe rregullimi administrativ, përkatësisht ndarja administrative-territoriale. Sipas regjistrimit serb të vitit 1913/14 Kosova ishte e ndarë në tri qarqe: Qarku i Kosovës (rrethet: Gjilan, Graçanicë, Llap dhe Nerodime); Qarku i Zveçanit (rrethet: Vushtrri, Drenicë dhe Mitrovicë); Qarku i Prizrenit (rrethet: Gorë, Podgur, Podrime, Sharr). Rrethi i Kaçanikut bënte pjesë në Qarkun e Shkupit.⁴

Pas Luftës së Parë Botërore, në fund të vitit 1918 siç dihet është krijuar Mbretëria Serbe, Kroate e Sllovene, përkatësisht jugosllave, e cila u shkatërrua në prill të vitit 1941. Sa i përket ndarjes administrative-territoriale pas mbarimit të Luftës së Parë Botërore, ndarja territoriale në qarqe, rrethe dhe organizimi i pushtetit civil në vitin 1918 mbetet e njëjtë si ai i vitit 1913. Kosova u nda në tri qarqe:

² Skender Rizaj, *Rudarstvo Kosova i susednih krajeva od XV dhe XVII veka*, Priština, 1968, fq. 7-19.

³ Dr. Muhamed Tërnavë, *Popullsia e Kosovës gjatë shekujve XIV-XVI*, Prishtinë, 1995, fq. 21.

⁴ Rečnik Mesta u oslobođenoj oblasti Stare Srbije, po službenim podacima, Beograd, 1914.

të Kosovës, të Zveçanit dhe të Prizrenit.⁵

Sipas ndarjes së re territoriale në vitin 1920, territori i Kosovës u nda në 5 qarqe: 1. Qarku i Zveçanit me seli në Mitrovicë me rrethin e Mitrovicës, të Vushtrrisë dhe të Drenicës (Llaushës); 2. Qarku i Kosovës me seli në Prishtinë me rrethin e Gjilanit, Graçanicës (Prishtinës), Ferizajt, Llapit (Podujevë); 3. Qarku i Dukagjinit (Metohisë) me seli në Pejë me rrethin e Gjakovës, Istogut dhe Pejës; 4. Qarku i Prizrenit me seli në Prizren me rrethin e Gorës (Vranishtë), Lumës (Bicaj), Podgurit (Suharekë), Anadrinës (Rahovec), Sharrit (Prizren) dhe Hasit (Krumë)*. Qarku i Shkupit në përbërjen e të cilit bënte pjesë territori i Kaçanikut.⁶

Mbretëria SKS, sipas Kushtetutës së Vidovdanit, ishte e ndarë në 33 krahina. Sipas Dekretligjit të 22 prillit 1922 territori i Kosovës ishte i ndarë në pjesët e këtyre krahinave: 1. Krahina e Kosovës në përbërjen e së cilës hynin këto rrethe: i Graçanicës, i Nerodimës – Ferizajt, i Llapit, i Gorës, i Anadrinisë, i Podgurit, i Sharrit dhe i Vushtrrisë; 3. Rrethi i Zveçanit ishte në përbërjen e Krahinës së Rashkës me seli në Çaçak; Rrethi i Pejës dhe i Gjakovës ishin përfshirë në Krahinën e Zetës me seli në Cetinë dhe Rrethi i Kaçanikut në Krahinën e Shkupit.⁷

Kjo ndarje administrative dhe territoriale ka mbetur deri më 6 janar 1929, kur vendoset diktatura monarko-fashiste e janarit. Atëherë Mbretëria e ndërron emrin në Mbretërinë Jugosllave, ndërsa territori i saj është ndarë në njësi të reja administrative-territoriale – në banovina, në krye me banin. Kjo ndarje është bërë me Ligjin e datës 3.X.1929. Tërë shteti është ndarë në 9 banovina. Territori i banovinave në mes të cilave u copëtua Kosova, sipas Ligjit mbi emrin dhe ndarjen e Mbretërisë në njësi administrative⁸ ishte e ndarë në këto rrethe: 1. Rrethi i Mitrovicës, i Istogut, i Pejës dhe prej vitit 1931 edhe rrethi i Gjakovës, i Anadrinisë dhe i Drenicës i takonin Banovinës së Zetës; 2. Rrethi i Graçanicës, i Nerodimës, i Podgurit, i Sharrit, i Kaçanikut, i Gorës, i Gjilanit, deri në vitin 1931 rrethi i Gjakovës dhe

⁵ Dr. Liman Rushiti, *Lëvizja kaçake në Kosovë 1918-1928*, Prishtinë, 1981, fq. 15; Arhiv Srbije, Ministarstvo inostranih poslova, Solun, k. 18, dok. 307, 14 X 1918.

* Duhet theksuar se Luma dhe Hasi ishin pjesë të Shqipërisë, por Serbia në këtë kohë i kishte pushtuar dhe i konsideronte të vetat, sikurse viset e tjera shqiptare në Kosovë, Maqedoni e në Mal të Zi.

⁶ Almanah Kraljevine SHS, 1921, Beograd, 1922, fq. 123-126.

⁷ Službene Novine Kraljevine SHS, nr. 9/28.IV.1922.

⁸ Službene Novine KJ, nr. 323/4.X.1929.

i Anadrinisë ishin brenda suazave të Banovinës së Vardarit. Rrethi i Vushtrrisë, i Llapit dhe i Drenicës i mbetën Banovinës së Moravës, ky i fundit prej vitit 1931 në Banovinën e Zetës.

Me fillimin e Luftës së Dytë Botërore dhe ardhjen e trupave gjermane, italiane dhe bullgare, Kosova u nda në tri zona pushtuese: në zonën gjermane, italiane dhe bullgare, të cilat vendosën administratën e vet.

NDARJA ADMINISTRATIVE-TERRITORIALE E KOSOVËS PAS LUFTËS SË DYTË BOTËRORE

Rregullimi administrativ i Kosovës pas mbarimit të Luftës së Dytë Botërore bëhet nga ana e Republikës Popullore të Serbisë, për shkak se Kosova pa dëshirën e popullit dhe synimet e saj për pavarësi hyn në kuadër të saj.

Republika Popullore e Serbisë i kishte të gjitha kompetencat për ndarjen territoriale të Kosovës. Edhe pse Kosova gjatë kohës së Luftës së Dytë e kishte pozitën e krahinës, prapëseprapë pas Luftës është bërë objekt i pazarllëqeve për ndarje dhe bashkim me territoret e tjera të Jugosllavisë.

Kosova si njësi politike-territoriale e ka pasur të përcaktuar pozitën e vet edhe gjatë Luftës së Dytë Botërore. Që në ditët e para të LNÇ-së, PKJ në Kosovë e Metohi, duke u mbështetur në parimet e Konferencës V të Vendit të PKJ-së⁹ kishte lidhje të drejtpërdrejtë me Komitetin Qendror të PKJ-së dhe si e tillë ka qenë përfaqësuese direkte e territorit të Kosovës në pikëpamje partiake në Komitetin Qendror të PKJ-së.

Konferenca e Bujanit

Edhe nga aspekti i organizimit të pushtetit në Kosovë qëndrimet ishin të qarta, ky territor si njësi e caktuar kishte organin më të lartë të pushtetit popullor – Këshillin Krahinor Nacionalçlirimtar, i cili konstituohet në Konferencën e mbajtur më 31.XII.1943 dhe 1-2 janar 1944.

Konferenca Nacionalçlirimtare për Kosovën dhe Rrafshin e Dukagjinit u mbajt në Bujan të Malësisë së Gjakovës nga 31 dhjetori i vitit 1943 deri më 2 janar 1944. Konferenca ishte mbledhja e parë, por edhe e vetmja në të cilën morën pjesë përfaqësues nga të gjitha rajonet dhe nga të gjithë popujt që jetonin në Kosovë. Nga 61 delegatët e

⁹ Konferenca V e Vendit e PKJ-së është mbajtur në Zagreb në tetor të vitit 1940.

thirur në Konferencë morën pjesë 49 vetë, nga të cilët 43 ishin shqiptarë dhe 6 serbë e malazezë. Konferenca e Bujanit u organizua me iniciativën e Komitetit Krahinor të PKJ-së për Kosovë dhe Rrafsh të Dukagjinit.

Konferenca e Bujanit zgjati tri ditë. Në të u mbajtën dy referate dhe u miratuan dy dokumente themelore: Rezoluta dhe Thirrja drejtuar popujve të Kosovës dhe të Rrafshit të Dukagjinit.

Në Rezolutën e Konferencës çështja e Kosovës u trajtua si një problem i lidhur ngushtë me strukturën e saj kombëtare dhe si çështje e vetëvendosjes kombëtare. Bëhet shpallja botërisht e strukturës kombëtare të popullsisë së Kosovës si një territor i banuar me shumicë shqiptare dhe e dëshirës së shqiptarëve në ato vise për bashkimin me Shqipërinë, si rrjedhojë e luftës kundër okupatorit dhe e zbatimit të parimeve universale për vetëvendosje deri në shkëputje. Aty tekstualisht thuhet: *“Kosova e Rrafshi i Dukagjinit asht një krahinë e banueme me shumicë nga populli Shqiptar, i cili si gjithmon ashtu dhe sot deshiron me u bashkue me Shqipnin. Prandaj e ndiejmë për detyrë me i tregue rrugën e drejtë që duhet me ndjekë populli Shqiptar për me realizue aspiratat e veta. Rruga e vetme pra që populli shqiptar i Kosovës dhe i Rrafshit ë Dukagjinit të bashkohet me Shqipnin asht lufta e përbashkët me popujt e tjerë të Jugosllavisë kundër okupatorit nazist gjaksuar e rrogatave të tij, sepse kjo asht e vetmja rrugë për me fitue lirinë, në të cilën të gjithë popujt, pra edhe populli Shqiptar do të kenë mundësi me vetvendos mbi fatin me të drejtën e vetvendosjes deri në shkëputje. Garancija për këtë asht Ushtria Nacional Çlirimtare e Jugosllavisë dhe Ushtria Nacional Çlirimtare e Shqipnisë, me të cilën ngushtsisht asht e lidhur. Përveç këtyne, për këtë garantojnë aleatët tonë të mëdhenj Bashkimi Sovjetik, Anglija, Amerika (Karta e Atlantikut, Konferenca e Moskës dhe e Teheranit)”*.¹⁰

Zhvillimi i qëndresës antifashiste në Kosovë dhe në viset e tjera shqiptare, veçanërisht nga gjysma e dytë e vitit 1943 dhe gjatë vitit 1944 u ballafaqua hapur me qëndrimet sektare dhe me vijën antishqiptare të udhëheqjes së PK-së të Jugosllavisë, të cilat patën në atë kohë e më pas pasoja negative për zhvillimin e luftës së armatosur dhe për pjesëmarrjen e shqiptarëve në të. Akuzat e udhëheqësisë së PKJ-së se shqiptarët paskëshin ndjenja shqiptaromëdha, iluzione mbi fashizmin etj. nuk qëndrojnë dhe bien ndesh me vlerësimet e

¹⁰ Këshilli Populluer i Krahinës Autonome të Kosovë-Metohisë 1943-1953, Prishtinë, 1955, f. 7-16.

shprehura në Konferencën e Bujanit.

Qëndrimi përfundimtar i PKJ-së shprehej nëpërmjet vendimeve të Mbledhjes II të KANÇJ mbajtura në Jajcë në nëntor 1943. Në këtë mbledhje, në të cilën nuk morën pjesë shqiptarët, sepse nuk u thirrën, u vendos krijimi i Jugosllavisë me kufijtë e para luftës dhe për rrjedhojë shqiptarëve jo vetëm që iu mohua e drejta për të vetëvendosur deri në shkëputje për të ardhmen e tyre, por edhe vetë Kosovës iu mohua barazia me viset e tjera të Jugosllavisë. Në këtë mënyrë u shkelën principet e bashkëpunimit për luftë. Ajo kishte pranuar me qëllime demagogjike se çështja e kufijve të ardhshëm ndërmyet Jugosllavisë e të Shqipërisë do të rregullohej me marrëveshje vëllazërore dhe në bashkëpunim ndërmjet UNÇJ e KANÇJ të Jugosllavisë dhe UNÇSH e KANÇJ të Shqipërisë. Pra, nga të dyja partitë, nga regjimet demokratike popullore që do të vendoseshin në Shqipëri e në Jugosllavi, si dhe nga vetë popullsia e atjeshme, në bazë të parimit për të drejtën e popujve për vetëvendosje.

Administratimi ushtarak

Duke u mbështetur në historiografinë bashkëkohore shqiptare, Shtabi Suprem i UNÇ-së dhe APJ-ja e shndërroi më 2 shtator 1944 Shtabin kryesor¹¹ të UNÇ dhe AP për Kosovë dhe Metohi në Shtab Operativ, i cili më 14 shtator 1944 iu nënshtrua Shtabit Kryesor të UNÇ dhe AP për Serbi.¹² Komandant i Shtabit Operativ u caktua Fadil Hoxha, komisar politik Kërsto Filipoviq, zëvendëskomandant Millutin Pavliçiq dhe anëtar i Shtabit Pavle Joviçeviq. Më vonë, në dhjetor 1944, kadri komandues u ndryshua: zëvendëskomandant ishte Petar Brajeviq, ndihmës i shefit të shtabit Ante Vallançiq, kurse shef i Drejtorisë së Personelit Pavle Joviçeviq.¹³

Ky ndryshim në organizimin e UNÇ-së në Kosovë dhe në skemën dhe strukturat komanduese, sipas PKJ-së, u bë me qëllim të

¹¹ Shtabi kryesor ishte formuar në fund të prillit 1943 në Sharr, por nuk ishte plotësuar me oficerë shqiptarë siç ishte paraparë; komandant i Shtabit Kryesor u emërua Fadil Hoxha, komisar Predrag Ajtiq, zëvendëskomisar Pavle Joviçeviq, shef i Shtabit Branko Shotra.

¹² Hadri, dr. Ali, *Lëvizja Nacional-çlirimtare në Kosovë (1941-1945)*, "Rilindja", Prishtinë, 1971, f.409; Nasi, Lefter, *Ripushtimi i Kosovës, shtator 1944 – korrik 1945*, Tiranë, 1994, f. 130.

¹³ Hadri, Ali, vep. e cit. f. 410.

pengimit të konsolidimit të "reaksionit".¹⁴

Më 8 shkurt të vitit 1945 ishte lëshuar Urdhëresa e Shtabit Suprem të UNÇJ-së e nënshkruar nga Tito për vendosjen e Administrimit Ushtarak në Kosovë.¹⁵ Me vendosjen e pushtetit të administratës ushtarake u bënë ndryshime në komandën dhe në organizimin e reparteve ushtarake. Me urdhër të Komandantit Suprem të UNÇ të Jugosllavisë J. B. Titos pushteti i Administratës Ushtarake në Kosovë u vu nën varësinë e drejtpërdrejtë të Shtabit Suprem të Jugosllavisë. Komanda e Zonës dhe Shtabit Operativ i Krahinës u vunë nën varësinë e Administratës Ushtarake.

Për drejtimin e këtij pushteti dhe të Shtabit Operativ u ngarkuan si komandant koloneli Savo Dërleviq, ish-shef i Shtabit i Armatës së UNÇJ-së dhe si komisar nënkoloneli Gjuro Medenica. Komandant i Zonës Ushtarake të Kosovës u emërua koloneli Nikolla Bozhoviq.¹⁶

Ndryshime të shumta u bënë në organizimin e reparteve ushtarake, në kuadrin komandues të këtyre reparteve dhe të seksioneve të Shtabit të Qarkut. Në detyrat komanduese-udhëheqëse u emëruan kadro serbe e malazeze, të cilat kryesisht ishin nga territoret jashtë Kosovës. Nga detyra u shkarkua Fadil Hoxha, i cili deri në këtë kohë kishte qenë komandant i Shtabit Kryesor, e më pas i shtabit Operativ për Kosovë.

Një nga masat e para të ndërmarra nga repartet ushtarake ishte çarmatosja e shqiptarëve në Kosovë e në viset e tjera. Nën pretekstin e mbledhjes së armëve dhe të shtypjes së reaksionit, repartet jugosllave filluan fushatën e terrorit pa dallim moshe, gjinie, pasurie etj. Shumë familjeve iu grabitën edhe veshjet e trupit.

Në këtë operacion morën pjesë njësitë nga brigada e 25-të, 26-të dhe 27-të të Divizionit të 46-të, si dhe njësitë e divizionit të 22-të dhe 41-të. Këto veprime rezultuan me revoltën e popullit shqiptar të Kosovës, revoltë e cila është shuar me gjak, vrasje, internime, burgosje dhe përdhunime nga më të ndryshmet. Operacionet e organizuara me pjesëmarrjen e reparteve të shumta ushtarake jugosllave kundër forcave të rezistencës në Kosovë kishin filluar që në dhjetor të vitit 1944, për të vazhduar me shtim të intensitetit gjatë fillimit të vitit 1945, veçmas pas vendosjes së administrimit ushtarak më 8 shkurt 1945.

¹⁴ E njëjtë.

¹⁵ Nasi, Lefter, vep. cit. fq. 161.

¹⁶ Nasi, Lefter, vep. cit. fq. 163.

NDARJA ADMINISTRATIVE-TERRITORIALE E KOSOVËS NË KËSHILLA POPULLORË TË RRETHEVE DHE KËSHILLA POPULLORË TË VENDEVE

Rregullimi administrativ i Kosovës pas Luftës së Dytë Botërore bëhet nga ana e Republikës Popullore të Serbisë, për shkak se ky territor pa dëshirën e popullit, në mënyrë arbitrare hyn në kuadër të Serbisë. Në Kosovë të gjitha kompetencat për rregullimin administrativ për ndarje territoriale ishin në Republikën Popullore të Serbisë, prandaj të gjitha burimet përkritazi me ndarjen dhe rregullimin administrativ të territorit të Kosovës na çojnë në drejtim të akteve ligjore të RP të Serbisë të kësaj sfere veprimtarie.¹⁷

Vendimin për statusin e Krahinës së Kosovës dhe të Metohisë e merr Këshilli Popullor i Kosovës e i Metohisë në Seancën e mbajtur më 8 – 10 korrik 1945 në Prizren për bashkim me Serbinë federale si krahinë autonome. Këtu, nën pikën 6 të Sesionit të parë të rregullt të legjislaturës së parë të Këshillit Popullor Krahinor të Krahinës Autonome të Kosovës e Metohisë, i mbajtur në Prizren më 8,9,10 korrik të vitit 1945 është aprovuar “Projekti i rezolutës për aneksimin e Kosovë e Metohisë me Serbinë Federale”, që në dokument quhet “Rezolucion i Asambles krahinore popullore të Kosovës e Metohisë”.¹⁸ Në procesverbalin e Mbledhjes së Parë të Këshillit Popullor Krahinor të Krahinës Autonome të Kosovës dhe Metohisë të mbajtur më 8.VII 1945 në Prizren, shihet se janë shqyrtuar 6 pika të rendit të ditës. Pasi që shqyrtohen të gjitha pikat e rendit të ditës, kryesuesi i mbledhjes Mehmet Hoxha paraqet edhe një pikë të rendit të ditës: “Propozimi për miratimin e rezolutës për bashkangjitje të

¹⁷ Dr. Seit Lipa, Kosova në periudhën e rindërtimit, Insituti i Historisë së Kosovës, Prishtinë, 1982, fq. 44.

¹⁸ KËSHILLI Popullor i Krahinës Autonome të Kosovë-Metohisë 1943-1953, Prishtinë, 1955, fq.46-47; ASHK, Fondi Këshilli Popullor Krahinor, Prizren. Procesverbalet dhe materialet nga mbledhja e I, II, III dhe IV e mbledhjeve të rregullta, viti 1945-1946, kut. 1.

Kosovës dhe Metohisë R. P. të Serbisë dhe përcaktimit të deputetëve për Kuvendin e R. P. të Serbisë”. Këshilli e aprovon këtë propozim-rezolutë dhe i cakton deputetët për Kuvendin e R. P. të Serbisë. Kjo është bërë pa dëshirën e popullit, kurse në dokumentin e shkruar thuhet kinse populli këtë e ka dashur. Disa delegatë, të cilët ishin në këtë mbledhje dhe votuan kundër më pastaj u vranë ose vuajtën burgje të gjata.

Më 7 gusht 1945 Këshilli Antifashist i Kuvendit Popullor të Çlirimit të Jugosllavisë e ka aprovuar Rezolutën e Kuvendit Krahinor të Krahinës Autonome të Kosovës dhe të Metohisë.¹⁹ Kryesia e Kuvendit Popullor të Serbisë, në bazë të vendimit të Kuvendit të Përkohshëm Popullor të Jugosllavisë e bien Ligjin për themelimin dhe rregullimin e KAKM-së. Me këtë Ligj Kosova është ndarë në 15 rrethe, siç janë: i Gjilanit, Pejës, Drenicës, Gorës, Graçanicës, Kaçanikut, Podgorës, Vushtrisë²⁰, Zveçanit, Llapit, Podrimës, Istogut, Gjakovës, Nerodimës dhe Sharrit. Këshillat e rretheve quhen ende sipas krahinave që përfshinin e që është rezultat i ndarjes territoriale sipas emërimit regjional të kohës së Mbretërisë Jugosllave.

Republika Popullore e Serbisë, në krahasim me republikat e tjera, në përbërjen e vet kishte dy krahinat autonome. Ajo miratoi ligjet, që përcaktuan se Serbia si njësi federale përbëhet nga qarqet dhe nga Krahinat Autonome e Vojvodinës dhe Krahinat Autonome e Kosovës dhe Metohisë.²¹

Sipas atyre dispozitave ligjore Krahinat Autonome e Kosovës dhe Metohisë përbëhej prej Këshillave Popullore të Rretheve, Këshillave Popullore të Vendeve dhe të Qyteteve. Këshillat Popullore të Rretheve, siç u pa, kanë filluar të funksionojnë menjëherë në vitin 1945. Rrethi ka përfshirë territorin e disa Këshillave Popullore të Vendit, të lidhur në një tërësi natyrore dhe ekonomike, të cilët kanë pasur interesat e veta të përbashkëta ekonomike, kulturore dhe administrative.

Këshillat Popullore të Rretheve ishin organet më të larta të pushtetit në territorin e vet. Ata e kanë orientuar dhe siguruar

¹⁹ Zakon o ustanovljavanju i ustrojstvu Autonomne Kosovsko-Metohijske Oblasti, “Službeni Glasnik NR Srbije”, nr.28/45.

²⁰ Në dokumente përdoret emri Vuçitërnë. Ne do ta përdorim termin Vushtrri, siç shqiptohet sot në popull.

²¹ Zakon o ustanovljavanju i ustrojstvu Autonomne Kosovsko-Metohijske Oblasti, “Službeni glasnik NR Srbije”, nr.28/45.

zhvillimin e tyre ekonomik, kulturor dhe social në territorin e vet dhe kanë udhëhequr me pasurinë e përgjithshme popullore të karakterit lokal. Organ ekzekutiv i rrethit ka qenë Këshilli Ekzekutiv.



Ndarja territoriale-administrative e Kosovës në vitin 1945 në 15 rrethe

Pas miratimit të Kushtetutës së RFPJ-së më 31 janar 1946 të gjitha organet e pushtetit filluan të quhen Këshilla Popullore.²² Në bazë të Kushtetutës është miratuar Ligji i parë i përgjithshëm mbi KP-të të datës 25.5.1946.²³ Pas vitit 1946 është karakteristikë administrimi lokal, që ka kaluar nëpër disa faza të zhvillimit, të cilat ishin të llojllojshme, kundërtënjësore dhe ishin në kundërshtim njëra me tjetrën.

²² Sl. List FNRJ, nr.10, më 01.02.1946.

²³ Sl. List FNRJ, nr.40, më 28.05.1946.

Në këtë kohë formohet rrethi i Kamenicës, kryesisht nga vendbanimet e rrethit të Gjilanit dhe disa të atij të Prishtinës, sipas një dokumenti arkivor të datës 17. 6. 1947 – Rregullores për ndarjen e buxhetit të të ardhurave dhe të dalurave të Këshillit Popullor Krahinor të Krahinës Autonome të Kosovës dhe Metohisë. Në Kosovë ekzistojnë këto rrethe: i Vushtrrisë, Gjilanit, Dragashit, Gjakovës, Istogut, Kaçanikut, Mitrovicës, Rahovecit, Pejës, Podujevës, Prishtinës, Prizrenit, Serbicës, Suharekës, Ferizajt dhe Kamenicës.²⁴

Më pastaj në këtë vit suprimohet rrethi i Kaçanikut dhe i bashkëngjitet rrethit të Nerodimës. Arsyeja e suprimimit të Rrethit të Kaçanikut ishte se në vitin 1946 pushteti zbuloi se pjesa dërmuese e zyrtarëve të këtij rrethi ishin anëtarë të Organizatës Nacional Demokratike Shqiptare.²⁵

Me Kushtetutën e RP të Serbisë të datës 17 janarit 1947, territori i RP të Serbisë është ndarë në disa njësi territoriale-administrative ku bënin pjesë Krahina Autonome e Vojvodinës dhe Krahina Autonome e Kosovës dhe Metohisë. Me Ligjin për ndarjen administrative-territoriale në Republikën e Serbisë,²⁶ njësitë administrative-territoriale në territorin e Republikës së Serbisë janë: rrethet, qytetet, rajonet e qyteteve dhe territoret e këshillave popullorë të vendeve ose vendbanimeve urbane. Çdo pjesë e territorit të Republikës Popullore të Serbisë është në përbërjen territoriale-administrative të një qyteti, rajoni të qytetit ose territorit të këshillit popullor të vendit a të vendbanimit urban.

Kryeqyteti i Republikës Popullore të Serbisë është Beogradi në të cilin janë selitë e organeve më të larta të pushtetit shtetëror dhe të administratës shtetërore të Republikës Popullore të Serbisë. Selia e organeve më të larta të pushtetit shtetëror dhe të organeve të administratës shtetërore të Krahinës Autonome të Vojvodinës është Novi Sadi.

Selia e organeve më të larta të pushtetit shtetëror dhe të organeve të administratës shtetërore të Krahinës Autonome të Kosovës dhe Metohisë është Prishtina.

Me Ligjin për ndarjen administrative të RP të Serbisë më 18

²⁴ ASHK, Fondi: Këshilli Popullor Krahinor, Prizren, Kut. 1, vit. 1945-1946.

²⁵ Deklaratë e Rexhep Bunjakut, anëtar i NDSH-së, atdhetar dhe i burgosur politik, në dhjetor 2011.

²⁶ Službeni Glasnik N.R. Srbije br. 17/24 prill 1947.

prill 1947²⁷ është përcaktuar se njësitë administrative-territoriale janë: rrethet, qytetet, rajonet e qyteteve. Me këtë Ligj janë **suprimuar qarqet** si njësi administrative-territoriale, kështu që organet republikane drejtpërsëdrejti lidhen me rrethet.



Ndarja administrative-territoriale e Kosovës në rrethe më 1947 (16 rrethe)

Presheva me këtë Ligj pushon së funksionuar si rreth, siç ishte rasti në Mbretërinë SKS dhe Mbretërinë Jugosllave. Kështu, suprimohet roli shekullor i Preshevës si qendër rajonale, që e ka pasur gjatë kohës së Perandorisë Osmane si seli e Moravicës, pastaj si vilajet në shek. XV dhe kaza në shekullin XIX, kështu që Presheva përfshihet

²⁷ Službeni glasnik NRS, br. 17/24 april 1947.

në Rrethin e Bujanocit. Arsyeja e zhvendosjes së administratës shtetërore nga Presheva në Bujanoc ishte, sepse pushteti qysh në ditët e para të vendosjes së regjimit të ri (komunist) Preshevën e shikonte si element jo të sigurt.

Sipas Ligjit për ndarjen administrative territoriale të Serbisë të vitit 1947,²⁸ në kuadër të Rrethit të Gjilanit – KPV të Pogradjës u takonin edhe vendbanimet **Maxherë** dhe **Ranatovc**, ndërsa Rrethit të Kamenicës, KPV – Zarbincë i takonin fshatrat **Zarbincë** dhe **Pribovc**. Më datën 1.XII 1949 fshati Zarbincë kalon në kuadër të Rrethit të Bujanocit. Ky ndryshim publikohet më parë edhe në Gazetën zyrtare të RPS-së.²⁹

Sipas Ligjit për ndarjen administrative-territoriale të Republikës Popullore të Serbisë nr.7/1950, Rrethit të Bujanocit, KPV të Gospaxhnicës i takojnë fshatrat Maxherë dhe Ranatovc, ndërsa në KPV – Zarbincë i takonin fshatrat Zarbincë dhe Pribovc. Po këtij rrethi të Bujanocit, komunës së Caravajkës i takojnë vendbanimet: Stanec, Sefer, Caravajkë, Peçenë dhe Depcë.

Sipas Ligjit të vitit 1947 në territorin e “Krahinës Autonome të Kosovës dhe Metohisë” përcaktohen këto rrethe në kuadër të të cilave janë Këshillat Popullorë të Vendeve: 1. I **Vushtrrisë**, 2. **Gjilanit**, 3. **Gorës** (me seli në Dragash), 4. **Gračanicës**, me seli në Prishtinë, 5. **Drenicës**, me seli në Sërbicë (Skënderaj J.O), 6. **Gjakovës**, 7. **Zveçanit**, me seli në Mitrovicë, 8. **Istogut**, me seli në Gurrakoc, 9. **Kamenicës**, 10. **Llapit**, me seli në Podujevë, 11. **Nerodimes**, me seli në Ferizaj, 12. **Pejës**, 13. **Podrimës**, me seli në Rahovec, 14. **Sitnicës**, me seli në Lipjan, 15. **Suharekës**, 16. **Sharrit**, me seli në Prizren. Siç po shihet me këtë Ligj formohet Këshilli Popullor i Rrethit të Sitnicës me seli në Lipjan. Këtij Këshilli i bashkëngjiten 12 Këshilla Popullorë të Vendit të kësaj treve.

Sipas këtij Ligji në territorin e Krahinës Autonome të Kosovës dhe Metohisë: Prishtina, Mitrovica, Peja dhe Prizreni e kishin statusin e qytetit.

Të dhënat përkitazi me këtë ndarje i gjejmë edhe në proces-verbalin e Sesionit të dytë të rregullt të legjislaturës së dytë të Këshillit Popullor Krahinor të Krahinës Autonome të Kosovë-Metohisë, mbajtur më **23 e 24 maj 1948** në Prishtinë. Në pikën 6 të rendit të ditës u dha Propozimi për ndryshimin administrativ-territorial. “Me

²⁸ Službeni glasnik NRS br. 17/24 april 1947.

²⁹ Službeni glasnik N.R. Srbije, br. 11/7 mart 1949.

kalimin në pikën 6 të rendit të ditës e mori fjalën këshilltari Hivzi Sulejmani, si referues, i cili arsyetoi propozimin për ndryshimin administrativ-territorial, në periferin e KA të Kosovë-Metohisë dhe mandej lexoi në gjuhët serbisht e shqip propozimet për këto ndryshime. Në lidhje me këtë çështje diskutoi këshilltari Ymer Pula. Mandej u kalue në votim dhe propozimi u pranuar njezani”.

Sipas statutit të Krahinës Autonome të Kosovës dhe Metohisë të aprovuar në Sesionin II të Këshillit Popullor Krahinor të Krahinës Autonome të Kosovë-Metohisë më **24 maj 1948**, nr. 1096, datë 30.X 1948, në nenin 4 të **Statutit** thuhet: “Krahina Autonome e Kosovë-Metohisë përfshin territoret:

1. E rretheve të tashme: Vuçitërn, Gilan, Gorë, Graçanicë, Drenicë, Gjakovë, Istok, Kamenicë, Zveçan, Llab, Nerodime, Pejë, Podrime, Sitnicë, Suharekë dhe Sharr;
2. E qyteteve të tashme: Mitrovicë, Prizren, Pejë e Prishtinë. Qendra e organeve më të larta të pushtetit e t’administratës shtetërore të Krahinës Autonome të Kosovë-Metohisë është Prishtina”.

Në vitin 1949 në Kosovë përsëri bëhet riorganizimi i rregullimit dhe i ndarjes organizative të territorit të KAKM në pikëpamje të shtimit të numrit të rretheve, që përfshinte kjo krahinë.³⁰ Në këtë vit Kosova, atëherë KAKM, përbëhej prej 17 rretheve: Rrethi i Graçanicës, Rrethi i Llapit, Rrethi i Vushtrrisë, Rrethi i Zveçanit, Rrethi i Sitnicës, Rrethi i Nerodimes, Rrethi i Gjilanit, Rrethi i Kamenicës, Rrethi i Podgorit, Rrethi i Sharrit, Rrethi i Pejës, Rrethi i Istogut, Rrethi i Drenicës, Rrethi i Moravës së Epërme, Rrethi i Podrimës, Rrethi i Gjakovës dhe Rrethi i Gorës.

Gjatë këtij viti, përveç shtimit të numrit të rretheve, formohet rrethi i ri i Moravës së Epërme, bëhen edhe ndryshime të tjera, që u përkasin këshillave popullorë të vendit, respektivisht bëhen ndryshime në përbërjen e Rrethit të Gorës, Rrethit të Graçanicës, Rrethit të Podrimës, Rrethi të Sitnicës, Rrethit të Suharekës dhe Rrethit të Sharrit.

Këto ndryshime, siç thuhej, janë të karakterit të masave për përshtatjen e organizimit të ndarjes administrative sipas kushteve të përkatësisë territoriale të fshatrave të ndryshme ndaj këshillave popullorë të vendit, si dhe të masave të përshtatjes sipas gravimitit

³⁰ “Službeni glasnik NRS” nr.44/49.

gjeografik të fshatrave ndaj selive të këshillave popullorë të vendit. Këto ndryshime bëheshin me qëllim që funksioni i organeve të këshillave popullorë të vendit të bëhet sa më efikas dhe të jetë sa më afër banorëve të territorit të caktuar, për të cilët edhe ekzistonin këto organe të pushtetit.



1949

*Ndarja administrative-territoriale e Kosovës në rrethe në vitin 1949
(17 rrethe)*

Me dekretin për ndryshimet administrative-territoriale³¹ të vitit 1949, në territorin e Krahinës Autonome të Kosovës dhe Metohisë disa Këshilla popullorë të vendeve suprimohen, formohen disa të rinj, apo disa prej tyre e ndërrojnë selinë ose bashkohen me Këshillin Popullor të vendit tjetër. Kjo më së miri shihet në dokumentin që është në shtojcë të këtij libri.

Në fillim të vitit 1950³² prapë bëhet ndarja administrative-territoriale e Kosovës, kuptohet në kuadër të Republikës së Serbisë. Territori i Kosovës, në bazë të Ligjit mbi ndarjen administrative-territoriale të Republikës Popullore të Serbisë, është i ndarë në rrethe në kuadrin e të cilave ekzistojnë këshillat popullorë të vendeve.

Në territorin e Krahinës Autonome të Kosovës dhe Metohisë ekzistojnë këto rrethe: 1. I Vushtrisë, me seli të Këshillit Popullor të Rrethit në Vushtrri; 2. I Gjilanit, me seli të Këshillit Popullor të Rrethit në Gjilan; 3. I Moravës së Epërme, me seli të Këshillit Popullor të Rrethit në Viti; 4. I Gorës, me seli të Këshillit Popullor të Rrethit në Dragash; 5. I Graçanicës, me seli të Këshillit Popullor të Rrethit në Prishtinë; 6. I Drenicës, me seli të Këshillit Popullor të Rrethit në Serbicë; 7. I Gjakovës, me seli të Këshillit Popullor të Rrethit në Gjakovë; 8. I Zveçanit, me seli të Këshillit Popullor të Rrethit në Mitrovicë; 9. I Istogut, me seli të Këshillit Popullor të Rrethit në Gjurakoc; 10. I Kamenicës, me seli të Këshillit Popullor të Rrethit në Kamenicë; 11. I Llapit, me seli të Këshillit Popullor të Rrethit në Podujevë; 12. I Nerodimës, me seli të Këshillit Popullor të Rrethit në Ferizaj; 13. I Pejës, me seli të Këshillit Popullor të Rrethit në Pejë; 14. I Podrimës, me seli të Këshillit Popullor të Rrethit në Rahovec; 15. I Sitnicës, me seli të Këshillit Popullor të Rrethit në Lipjan; 16. I Suharekës, me seli të Këshillit Popullor të Rrethit në Suharekë dhe 17. I Sharrit, me seli të Këshillit Popullor të Rrethit në Prizren.

Sipas këtij ligji në territorin e Krahinës Autonome të Kosovës janë edhe qytetet: Mitrovica, Peja, Prizreni dhe Prishtina.

³¹ Službeni glasnik NRS, nr.2, më 15 janar 1949 dhe Službeni Glasnik N.R. Srbije, nr.44/12 tetor 1949.

³² Službeni glasnik NRS br. 7/20 februar 1950.

NDARJA ADMINISTRATIVE-TERRITORIALE E KOSOVËS NË KËSHILLA POPULLORË TË KOMUNAVE, RRETHEVE DHE QYTETEVE

Me zbatimin e Ligjit për aplikimin e riorganizimit të Këshillave Popullorë të Vendeve dhe Ligjit për ndarjen administrative-territoriale të vitit 1952 suprimohen Këshillat e Vendit dhe në vend të tyre formohen Këshillat Popullorë të Komunave. Kështu, disa Këshilla Popullorë të Vendeve e ndërrojnë emrin në Këshilla Popullorë të Komunave, zgjerohen kompetencat territoriale, përkatësisht i bashkëngjiten disa territore të Këshillave Popullorë të Vendeve. Formohet sistemi i komunave si njësi themelore politike dhe ekonomike. Qëllimi ishte, siç thuhej në dokumente, forcimi i pavarësisë politike, normative dhe materiale i komunave si bashkësi themelore territoriale shoqërore-politike. Komunitat në atë kohë ishin shprehje e autonomisë lokale dhe e administrimit lokal. Qëllimi themelor ishte që njerëzit punues dhe qytetarët të vendosin për çështjet qenësore për jetesë dhe punë, dhe çështje të tjera të caktuara, që barteshin në instancat më të larta. Kjo vendosje e sistemit komunal ka ndikuar në zvogëlimin e numrit të komunave dhe zgjerimin e territorit të tyre. Mirëpo praktika ka treguar se ky rregullim më tepër ishte normativ dhe më pak efikas, sepse ka ekzistuar një mosharmoni ndërmjet çështjes normative dhe të efikasitetit. Problemet janë shprehur në marrëdhëniet e shtetit dhe të vetëqeverisjes, në mosefikasitetin e mekanizmave të organeve shtetërore në normativizimin e theksuar, në mbylljen brenda suazave territoriale të ngushta etj.

Kuvendi Popullor i RFPJ-së e ka miratuar më 104.1952 Ligjin e përgjithshëm për Këshillat Popullorë, i cili ka caktuar këshillat si organe lokale të pushtetit shtetëror si dhe organe të qeverisjes popullore në **komuna, rrethe e qytete**³³.

Duke u bazuar në Ligjin Federativ për Këshillat Popullorë të

³³ Službeni list FNRJ br. 33/19.04.1952.

vitit 1952 dhe Ligjit për ndarjen administrative-territoriale të RP të Serbisë,³⁴ territori i Serbisë është ndarë në komuna, rrethe dhe qytete. Kjo ndarje është bërë në bazë të kompetencave që kishte Republika e Serbisë, me Dekretin e Presidiumit të RP të Serbisë më 22 prill 1952 lidhur me vendimin për decentralizimin e aparatit ekonomik dhe administrativ.

Ndryshimi i rolit të këshillave popullorë të qyteteve dhe komunave është përcaktuar me Ligjin për këshillat popullorë dhe Ligjin për këshillat popullorë të qyteteve dhe komunave, të cilin e ka aprovuar Kuvendi i Serbisë më datën 8.9.1952.³⁵

Me këtë Dekret, me Ligjin e 20 shtatorit 1952 është plotësuar ndarja e paraparë. Territori i Kosovës është i ndarë në këto rrethe: 1. I Vushtrrisë, 2. Gjilanit, 3. Moravës së Epërme, 4. Gorës, 5. Graçanicës, 6. Drenicës, 7. Gjakovës, 8. Zveçanit, 9. Istogut, 10. Kamenicës, 11. Llapit, 12. Nerodimës, 13. Pejës, 14. Podrimës, 15. Sitnicës, 16. Suharekës, 17. Sharrit dhe qyteti Prishtina.

Në bazë të këtij Ligji në Kosovë, përveç Prishtinës si kryeqyteti i Krahinës, funksionin e qyteteve e kanë edhe Mitrovica, Peja, Prizreni dhe Gjakova. Në Kosovë, duke filluar nga viti 1953 funksionojnë këta këshilla popullorë të komunave në kuadër të rretheve:

Rrethi i Drenicës: Çirezi, Gllgovci, Klina e Epërme, Abria e Epërme, Prekazi i Epërm, Likoci, Polaci, Runiku, Skënderaj, Tërsteniku dhe Turiçeci.

Rrethi i Gjakovës: Beci, Bistrazhini, Brekoci, Deçani, Gjakova, Gërgoci, Juniku, Ponosheci, Rogova, Irzniqi dhe Skivjani.

Rrethi i Gjilanit: Bostani, Bresalci, Cërnica, Gjilani, Sllakovci i Epërm, Malisheva, Parallova, Parteshi, Pasjani, Pogradja, Përlepnica, Stanishori, Shurdhani dhe Zhegra.

Rrethi i Moravës së Epërme: Binça, Sadovina e Çerkezëve, Gjelekare, Gushica, Letnica, Pozharani, Radivojci, Tërpeza, Vitia dhe Vërboci.

Rrethi i Gorës: Brodi, Brodosana, Dragashi, Krusheva dhe Hani i Llapushës.

Rrethi i Graçanicës: Nëntë Jugoviqi, Dobreva e Poshtme, Graçanica, Keçikolla, Komarani, Fushë-Kosova, Llukari, Marevci, Mramori, Obiliqi, Slivova dhe Bellaqevci i Madh.

³⁴ Sluzbeni glasnik NRS, br.15/1952.

³⁵ E njëjtë.

Rrethi i Istogut: Banja, Cërkolezi, Ujëmiri, Dobrusha, Dubrava, Gjurakovci, Istogu, Jashanica, Klina, Jabllanica e Vogël, Rakoshi, Vrella, Zllokuqani dhe Zallqi.



Ndarja territoriale-administrative e Kosovës në vitin 1953

Rrethi i Kamenicës: Hajkobilla, Hajnovci, Shipashnica e Poshtme, Kamenica, Lisocka, Hogoshti, Poliçka, Ranillugu, Rogoçica, Strezovci, Topanica, Tugjevci dhe Ropotova e Madhe.

Rrethi i Llapit: Batllava, Dumnica e Poshtme, Lupçi i Poshtëm, Gllamniku, Llapashtica e Epërme, Kërpimehu, Lluzhani, Orllani, Pollata, Perani, Podujeva, Sveçla dhe Shajkovci.

Rrethi i Nerodimës: Doganaj, Drajkovci, Hani i Elezit, Gaçka, Ivaja, Kaçaniku, Kosina, Neredimja, Kaçaniku i Vjetër, Fshati i Vjetër (Starasella), Shtërrpca, Talinovci, Tankosiqi, Ferizaj dhe Zaskoku.

Rrethi i Pejës: Barani i Poshtëm, Drelaj, Drenovci, Gllogjani, Strellci i Epërm, Gorazhdevci, Krusheci, Kuçishta, Peja, Raushiqi i Vjetër, Treboviqi, Tresteniku, Videja, Vitomirica dhe Zahaqi.

Rrethi i Podrimës: Bellacërka, Qifllaku, Drenovci, Kijeva, Malisheva, Rahoveci, Arllati, Astrazubi, Ratkoci, Svërka, Hoça e Madhe dhe Llashkadrenoci.

Qyteti i Prishtinës: Prishtina.

Rrethi i Sitnicës: Babushi, Gushterica e Poshtme, Gadimja e Epërme, Goleshi, Janjeva, Lipjani, Muzeçina, Sedllari, Gracka e Vjetër dhe Shtimja.

Rrethi i Suharekës: Banja, Bukoshi, Dulja, Mushtishti, Semetishti, Sopia, Studençani dhe Suhareka.

Rrethi i Sharrit: Dushanova, Serbica e Epërme, Hoça e Qytetit, Lubizhda, Planeja, Prizreni, Reçani, Sredcka, Krusha e Madhe, Zymi dhe Zhuri.

Rrethi i Vushtrrisë: Babinmost, Cecelia, Stanovci i Poshtëm, Dërvari, Gojbula, Dumnica e Llugave, Nevolani, Novosella, Pantina, Prilluzha, Skroma, Smrekonica dhe Vushtrria.

Rrethi i Zveçanit: Banjska, Bare, Bërrnjaku, Çabra, Mitrovica, Laposaviqi, Tuneli i Parë, Rezalla, Sllatina, Stantërgu, Shipoli, Vllahia, Zubin Potoku dhe Zveçani.

Në bazë të Statutit të Krahinës Autonome të Kosovës dhe Metohisë të aprovuar nga “Këshilli populluer i Krahinës Autonome të Kosovë-Metohisë”, në seancën VII të rregullt më 20 shkurt 1953, Krahina Autonome e Kosovës dhe Metohisë përfshin territorin e rretheve: Vushtrri, Gjilan, Moravë e Epërme, Gorë, Graçanicë, Drenicë, Gjakovë, Zveçan, Istog, Kamenicë, Llap, Nerodime, Pejë, Podrimë, Sitnicë, Suharekë, Sharr dhe qyteti i Prishtinës. Selia e organeve krahinore të pushtetit të Krahinës Autonome të Kosovë-Metohisë është Prishtina.

Në bazë të Ligjit të përgjithshëm për rregullimin e komunave dhe rretheve, të cilin Kuvendi Federativ e ka miratuar më 16.6.1955,³⁶ filloi decentralizimi i mëtejshëm i pushtetit popullor. Ndryshimin më të rëndësishëm e paraqet futja e rregullimit komunal. Në bazë të këtij

³⁶ Službeni list FNRJ, nr. 16/22.06.1955.

Ligji të përgjithshëm, Kuvendi Popullor i RPS-së më 11 korrik 1955 e ka miratuar Ligjin për territoret e rretheve dhe komunave në Republikën e Serbisë.³⁷ Sipas këtij Ligji suprimohen: rrethet e Llapit, Sitnicës dhe Nerodimës, kështu që Rrethi i Graçanicës përfshin edhe territorin e këtyre rretheve. KPRR-ja e Graçanicës e ndërron emrin në KPRR të Prishtinës; rrethi i Vushtrrisë, ku vendbanimet i bashkëngjiten rrethit të Mitrovicës, që më parë është quajtur i Zveçanit; rrethi i Kamenicës dhe i Moravës së Epërme, që i bashkëngjiten KPRR-së të Gjilanit; rrethi i Gorës, Podrimës dhe Suharekës, që i bashkëngjiten KPRR-së të Prizrenit, që më parë quhej i Sharrit; rrethi i Istogut dhe Gjakovës i bashkëngjiten KPRR-së të Pejës; rrethi i Drenicës, disa vendbanime i bashkëngjiten KPRR-së të Mitrovicës dhe të Graçanicës. Duhet theksuar se disa vendbanime të një rrethi i bashkëngjiten territorit të dy apo më shumë rretheve.

Kështu, në bazë të Statutit të Krahinës Autonome të Kosovës dhe Metohisë nr. 2328 të datës 9 tetor 1956, të aprovuar nga Këshilli Ekzekutiv, në aspektin territorial “Krahina e Kosovës e Metohisë është krahinë autonome në kuadrin e shtetit socialist demokratik të Republikës popullore të Serbisë”.... **“Krahina Autonome e Kosovës e Metohisë përfshin territoret e rretheve të tashme: Gjilanit, Mitrovicës, Pejës, Prizrendit dhe Prishtinës. ... Qendra e organeve krahinore të pushtetit të Krahinës Autonome të Kosovës e Metohisë është Prishtina”.**

Duke filluar nga viti 1955 suprimohen edhe disa këshilla popullore të komunave dhe iu bashkëngjiten këshillit popullor të komunës tjetër. Gradualisht, deri në vitin 1959 suprimohen edhe disa këshilla të tjerë popullore të komunave, ndërsa miratohet ligji për ndarjen administrative-territoriale të vitit 1959, duke u aplikuar nga viti 1960.

Në bazë të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për territorin e rretheve dhe të komunave në Republikën e Serbisë, të aprovuar nga Kuvendi Popullor i Republikës Popullore të Serbisë, në mbledhjen e Dhomës së Republikave të mbajtur më 10 qershor 1957 territori i Kosovës është ndarë në këto rrethe dhe komuna në kuadër të rretheve.³⁸

³⁷ Službeni glasnik NRS, br. 56/20.07.1955.

³⁸ Službeni glasnik NRS nr. 27/22 jun 1957.



Ndarja territoriale-administrative e Kosovës në rrethe gjatë viteve 1956-1959.

1. Rrethi i Gjilanit – Këshilli popullor i komunave: Vitia, Gjilani, Zhegra, Kamenica, Muçiverci, Novobërda, Hogoshti, Pozharani dhe Ranillugu.

2. Rrethi i Mitrovicës – Këshilli popullor i komunave: Banjska, Vushtrria, Zubin Potoku, Mitrovica, Leposaviqi, Prilluzha, Runiku, Sllatina, Skënderaj dhe Stantërgu.

3. Rrethi i Pejës – Këshilli popullor i komunave: Barani, Deçani, Ujëmiri, Drelaj, Gjakova, Gjurakovci, Istogu, Juniku, Kijeva, Klina, Leshani, Peja, Ponosheci dhe Cërmjani.

4. Rrethi i Prizrenit – Këshilli popullor i komunave: Banja, Bellobradë, Krusha e Madhe, Vlashnja, Dragashi, Prizreni, Ratkovci, Rogova, Srecka dhe Suhareka.

5. Rrethi i Prishtinës – Këshilli popullor i komunave: Gllgovci, Graçanica, Nëntë Jugoviqi, Hani i Elezit, Janjeva, Kaçaniku, Kaçikolli, Komarani, Kërpimehu, Lipjani, Lluzhani, Magura, Babushi i Muhaxhirëve, Obiliqi, Orlani, Podujeva, Prishtina, Ferizaj, Shtimja dhe Shtërpca.

Organizimi i brendshëm i komunave ka pësuar ndryshime në bazë të ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit të përgjithshëm për rregullimin e komunave dhe rretheve të miratuara në korrik të vitit 1957.³⁹

³⁹ Sl.list FNRJ, nr. 29/10.07.1957.

NDARJA ADMINISTRATIVE-TERRITORIALE E KOSOVËS NË KOMUNA

Me Ligjin për territoret e komunave dhe rretheve në RP të Serbisë në vitin 1959⁴⁰ është përcaktuar se në Serbi ka 21 rrethe, ndërsa rrethet në “Krahinën Autonome të Kosovës dhe Metohisë” janë suprimuar. Me këtë ligj është përcaktuar që në Kosovë të ekzistojnë vetëm komunat. Këto komuna duhet të lidhen drejtpërdrejt me organet republikane, pa ndërmjetësimin e rretheve, kështu që Kosovës i pamundësohet udhëheqja e pavarësisë rajonale dhe e politikës autonome dhe administrative. Ajo kohë është kur aksioni i grumbullimit të armëve, i cili është udhëhequr nga UDB-a dhe policia, ishte në vrullin më të madh dhe ka shkaktuar lumë të shpërnguljes së shqiptarëve në Turqi dhe deklarimin masiv për “turq”, në mënyrë që në njëfarë forme të mbrohen nga reprezaljet e shtetit dhe policisë.

Kuvendi Popullor i Republikës Popullore të Serbisë në mbledhjen e mbajtur më 25 nëntor 1959 miraton vendimin për shpalljen e **Ligjit për suprimimin e rretheve në Krahinën Autonome të Kosovës** e Metohisë.⁴¹ Kështu, më datën 31 dhjetor 1959 përfundimisht në territorin e Kosovës pushojnë së funksionuari rrethet duke filluar të funksionojnë vetëm komunat.

Me vendimet përkatëse të Serbisë në vitin 1958 Republika e Serbisë ia merr rrethit të Kragujevcit tërë **komunën e Leshakut** (më parë rrethit të Studenicës me qendër në Rashkë) prej 197 km² dhe ia bashkëngjit komunës së Leposaviqit, rrethi i Mitrovicës (më parë rrethi i Zveçanit). Duke krahasuar regjistrat e vendbanimeve të bazuara në dispozitat ligjore, në Ligjin për ndryshimet dhe plotësimet e ligjit të territoreve të rretheve dhe komunave në Republikën e Serbisë⁴² të vitit 1957, vendbanimet e komunës së Leshakut, që është në kuadër të rrethit të Kragujevcit përfshijnë vendbanimet: Bare, Bellobërda, Pllaninica, Belluçë, Berberishta, Bistrica, Jarinje, Borova,

⁴⁰ Sluzbeni glasnik NRS, nr. 51/1959.

⁴¹ Sluzbeni glasnik NRS, nr. 50/1959.

⁴² Sluzbeni glasnik NRS, nr. 27/22 jun 1957.

Vraçeva, Gumnishta, Kërnini i Poshtëm, Zemanica, Iseva, Leshaku, Miokoviqi, Ostraça, Postenja, Potkomnje, Gulia, Rëvatska, Trebiqi, Cirkoviqi dhe Cërnotova. Sipas ligjit për territoret e komunave dhe rretheve në Republikën Popullore të Serbisë⁴³ të vitit 1959 këto vendbanime ishin në kuadër të komunës së Leposaviqit. Kjo është bërë me qëllim që Leposaviqi si komunë të zgjerohet territorialisht dhe në pikëpamje etnodemografike të rritej numri i serbëve në këtë komunë e edhe në Kosovë.

Sipas Ligjit për territorin e komunave dhe të rretheve në Republikën e Serbisë të vitit 1959, në Kosovë ekzistojnë këto komuna: E Deçanit, Dragashit, Gjakovës, Gjilanit, Ferizajit, Prishtinës, Pejës, Mitrovicës, Kamenicës, Vitisë, Podujevës, Suharekës, Rahovecit, Vushtrrisë, Istogut, Klinës, Kaçanikut, Shtërrpcës, Zymit, Zubin Potokut, Lipjanit, Skënderaj, Gllgovcit, Malishevës, Leposaviqit, Novobërdës, Prizrenit dhe Orllanit. Kështu, në Kosovë prej vitit 1960 deri në vitin 1965 ekzistojnë 28 komuna.

Në bazë të vendimit të Kuvendit Komunal të Prishtinës nr.01-25522, datë 26 tetor 1965, komunës së Prishtinës i bashkëngjiten disa vendbanime të komunës së deritanishme e Orllanit, e cila suprimohet, ndërsa vendbanimet e tjera i bashkëngjiten komunës së Podujevës. Ndërsa sipas vendimit tjetër të Kuvendit Komunal të Prishtinës nr.01-25451 të datës 26 tetor 1965, një numër i vendbanimeve të komunës së deritanishme të Novobërdës, e cila suprimohet, i bashkëngjiten komunës së Prishtinës, ndërsa numri tjetër i bashkëngjitet komunës së Gjilanit.

⁴³ Službeni glasnik Narodne Republike Srbije, nr. 51/1959.



Ndarja territoriale-administrative e Kosovës në vitet 1966-1984 (22 komuna)

Komunat të tjera, ajo e Zymit i bashkëngjitet komunës së Prizrenit, komuna e deritanishme e Shtërpçës i bashkëngjitet komunës së Ferizajt dhe vendbanimet e komunës së Zubin Potokut i bashkëngjiten komunës së Mitrovicës. Vendbanimet e komunës së Malishevës ndahen ndërmjet komunave të Rahovecit, Suharekës, Klinës dhe Drenasit.



*Ndarja administrative territoriale e Kosovës në komuna në vitet 1960-1965
(28 komuna)*

Tani në territorin e Kosovës funksionojnë 22 kuvende komunale. Në vitin 1966 në Kosovë ekzistojnë këto komuna: e Deçanit, Dragashit, Gjakovës, Gjilanit, Ferizajt, Prishtinës, Pejës, Mitrovicës, Kamenicës, Vitisë, Podujevës, Suharekës, Rahovecit, Vushtrrisë, Istogut, Klinës, Kaçanikut, Lipjanit, Skënderaj, Glllogovcit, Leposaviqit dhe Prizrenit.

Në ndërkohë me Kushtetutën e RPFJ dhe Kushtetutën e Serbisë të vitit 1963, këshillat popullorë të komunave ngrihen në kuvende

komunale.⁴⁴ Sipas tyre, kuvendi i komunës është organi më i lartë i pushtetit dhe organ i vetëqeverisjes shoqërore në suazën e të drejtave dhe detyrave të komunave. Ai e përcaktoi politikën dhe vendosi edhe për çështjet e tjera themelore me rëndësi për jetën politike, ekonomike e kulturore dhe zhvillimin shoqëror, pastaj miratoi edhe akte të tjera të përgjithshme, etj. Deri në vitin 1963 Kosova si krahinë, që quhej edhe provincë, nuk e kishte statusin e Krahinës sikurse Krahina Autonome e Vojvodinës. Në prill të vitit 1963 u ngrit Kosova në këtë nivel. Me ndryshimet kushtetutare të RFPJ-së, me amadamentet e aprovuara më 26 dhjetor 1968 ndryshohet emri i Krahinës Autonome të Kosovës e Metohisë në Krahinë Socialiste Autonome të Kosovës.

Ndryshime qenësore ndodhin në vitin 1974, kur me Kushtetutën e Republikës Federative Socialiste të Jugosllavisë zgjerohen kompetencat e krahinave. Krahinat e fitojnë statusin e elementit konstituiv të federatës, edhe pse nuk e kanë pasur karakterin e njësisë federale me emrin republikë. Me Kushtetutën e vitit 1974 komuna ishte e pavarur në suaza të Kushtetutës dhe ligjeve, ndërsa si organ themelor i pushtetit ishte kuvendi komunal. Komuna ka zgjedhur këshillin ekzekutiv si organ i vet ekzekutiv. Punët administrative i kryenin organet komunale administrative dhe organet e tjera. Akti më i lartë komunal ishte statuti, i cili është dashur të jetë në harmoni me kushtetutën dhe me ligjet.

Pas Kushtetutës së vitit 1974 Kosova e bëri organizimin e parë territorial të vendit. Kuvendi i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më datën 15 korrik 1975 ka miratuar Ligjin për organizimin territorial të Kosovës. Në bazë të këtij Ligji janë formuar 22 komuna më 1.431 vendbanime,⁴⁵ siç janë komunat: Vitia, Vushtrria, Glllogovci, Gjilani, Deçani, Dragashi, Gjakova, Istogu, Kaçaniku, Klina, Kamenica, Mitrovica, Leposoviqi, Lipjani, Rahoveci, Peja, Podujeva, Prizreni, Prishtina, Skënderaj, Suhareka dhe Ferizaj.

Kjo ndarje territoriale-administrative e Kosovës ishte deri në vitin 1985. Me ndryshimin e Ligjit për organizimin territorial në vitin 1985 dhe në bazë të nenit 335 të Kushtetutës së Krahinës Autonome të Kosovës shpallet **Ligji për formimin e komunës së Malishevës**.⁴⁶

⁴⁴ Sluzbeni glasnik NRS, br. 14/1963.

⁴⁵ KK nr.015-1, Prishtinë, më 15 korrik 1975; Gazeta zyrtare e Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, nr.25/ 29 korrik 1975.

⁴⁶ “Gazeta zyrtare e Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës” nr.48/29, dhjetor 1985.

Kjo komunë përbëhet nga 44 vendbanime. Ajo formohet nga këto vendbanime të Komunës së Rahovecit: Bubël, Guraçevë, Gajrak, Guriq, Damanek, Dragobil, Janqishtë, Joviq, Llapçevë, Lubizhdë, Maxharë, Malishevë, Morali, Millanoviq, Mirushë, Astrozub, Pagarushë, Ponorc, Turjakë, Caravranë, Rud dhe Çypevë; të Komunës së Klinës: Balincë, Bubavec, Golluboc, Vermnicë, Kijevë, Llozicë, Llashkadrenoc, Mleçan, Ploçicë, Carallukë dhe Shkorashnik; të Komunës së Gllgovcit: Berishë, Tërpezë e Poshtme dhe Tërpezë; të Komunës së Suharekës: Banjë, Bellanicë, Guncat, Kërvasari, Lladroc, Lladrovic, Senik dhe Temeçinë.

Në bazë të nenit 335 të Kushtetutës së Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, në vitin 1987 shpallet **Ligji për formimin e Komunës së Zubin Potokut**.⁴⁷ Komuna e Zubin Potokut formohet prej këtyre vendbanimeve, të cilat deri në vitin 1987 ishin në kuadër të Komunës së Mitrovicës: Babiqe, Babudovica, Banje, Bojnoviqe, Bernjak, Bube, Burlate, Kalludra e Madhe, Velibreg, Vojmislqi, Vërba, Vitakovë, Vukojoviqe, Vuksavljeviq, Gazivodë, Varragë e Epërme, Jasenovik i Epërm, Stremc i Epërm, Dobroshevinë, Varragë e Poshtme, Jasenovik i Poshtëm, Dragolice, Dragoviq, Dren, Zhareviq, Zagrahje, Zagule, Zeçeviq, Zubin Potok, Zupçe, Jabukë, Jagnjenicë, Junake, Kijevë, Kleçkë, Kobillogllavë, Kopiloviq, Kovaqe, Kozarevë, Kerligatë, Ledenikë, Luçarekë, Kalludra e Vogël, Presekë, Prevllakë, Pridvoricë, Rançiqe, Rezallë, Ruishte, Tushiqe, Uglare, Crepulë, Çabër, Çeçevë, Çeshanoviq, Çiflluk dhe Shipovë.

Në bazë të nenit 335 të Kushtetutës së Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës shpallet **Ligji për formimin e komunave Shtime dhe Shtërpc**.⁴⁸

Komuna e Shtimës formohet nga vendbanimet: Belincë, Vojnovc, Godanc i Epërm, Davidovc, Devetak, Godanc i Poshtëm, Dugë, Gjurovc, Zborc, Karaçicë, Lanishtë, Molopolc, Muzeçinë, Pjetreshticë, Petrovë, Petroviq, Rancë, Reçak, Rashincë, Topillë, Carralevë, Shtime, Godanc i Epërm, Dugë, Karaçicë dhe Pjetërshticë. Selia e komunës është në Shtime. Komuna e Shtimes formohet nga vendbanimet e deritanishme të komunës së Ferizajt dhe Lipjanit. Komuna e Shtimes u krijua prej gjithsej 23 vendbanimeve: 19 vendbanime të Ferizaji dhe 4 vendbanime të Lipjanit.

⁴⁷ Gazeta zyrtare e KSAK-së nr. 9, 20 mars 1987.

⁴⁸ Gazeta zyrtare e Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës nr.5/26 shkurt 1988.



Ndarja administrative-territoriale e Kosovës në vitin 1985- 1990 (në 29 komuna)

Komuna e Shtërpçës formohet nga vendbanimet: Barovc, Brezovicë, Brod, Viçë, Vërbeshticë, Bitinjë e Epërme, Gotovushë, Bitinjë e Poshtme, Drajkovc, Izhanc, Jazhincë, Kashtanjevë, Sevcë, Sushicë, Firajë, Shtërpc. Komuna e Shtërpçës u formua nga 16 vendbanime të Ferizajt. Selia e komunës është në Shtërpçë.

Kuvendi i Krahinës Autonome Socialiste të Kosovës më 23 qershor 1988 e ka miratuar Ligjin për themelimin e komunave të **Fushë-Kosovës, të Obiliqit dhe të Novobërdës**. Territorin e vendbanimeve të **Fushë-Kosovës** e përbëjnë vendbanimet, që deri atëherë ishin në kuadrin e komunës së Prishtinës, siç janë: Fushë-Kosova, Bresja, Uglari, Miradia e Epërme, Miradia e Poshtme,

Bellaçevci i Madh, Bellaçevci i Vogël, Graboci i Poshtëm, Pomozotini, Kuzmini, Lismiri dhe Nakarada.

Territorin e vendbanimeve të **Obiliqit** e përbëjnë vendbanimet: Kryesheci, Cërkvenavodica, Hadja, Graboci i Epërm, Shipitulla, Leskoshiqi, Siboci, Hamidia, Plementini, Millosheva, Breznica, Babimoci, Llazareva dhe Mazgiti.

Territorin e vendbanimeve të **Novobërdës** e përbëjnë vendbanimet, që deri atëherë ishin në kuadër të Komunës së Prishtinës, siç ishin: Bostoni, Novobërda, Prekoci, Tërniçevci, Kllobukari, Llabjani, Zebinca, Izvori dhe Manishinci.

Në muajin korrik të vitit 1991 është formuar **Komuna e Zveçanit** nga vendbanimet e deritanishme të komunës së Mitrovicës: Banovdolli, Banjska, Banjska Reka, Suhadolli i Banjës, Bresnica, Vallaqi, Josheviku, Kulla, Llozishta, Ruadari i Madh, Boletini, Lipa, Rudari i Vogël, Graboci, Dolani, Zhazha, Zherovnica, Zhitkovci, Zveçani, Zveçani i Vogël, Izvori, Grizhani, Jankov Potoku, Kamenica, Medindolli, Korila, Llovaci, Vilishta, Lipovica, Llokva, Matica, Rudina, Rahovica, Sendolli dhe Sërboveci⁴⁹. Formimi i kësaj komuneje kishte më tepër karakter politik.

⁴⁹ Më parë është quajtur me emrin Bugariq.



Ndarja territoriale-administrative e Kosovës në vitin 1991(30 komuna)

ORGANIZIMI TERRITORIAL I KOSOVËS PAS SUPRIMIMI TË AUTONOMISË SË KOSOVËS MË 1989

Pas ndryshimeve kushtetutare në RSFJ, me Kushtetutën e Kosovës të vitit 1974, menjëherë në vitet e tetëdhjeta, e sidomos të atyre të nëntëdhjeta të shek. XX filloi një politikë nacionaliste e shoviniste serbe kundër autonomisë së Kosovës. Sidomos kjo është manifestuar me ardhjen në pushtet të politikës së Millosheviqit. Përhapëj parulla „*Oj Srbijo iz tri dela, ponovo ćeš biti cela*“ (“*Oj Serbi prej tri pjesëve, prapë do të jesh e tërë*”). Përveç kësaj, Qeveria e Beogradit arriti të mobilizojë gjithë popullin nën parullën "Serbi unike". Disa vjet rresht u organizuan me qindra mitingje e demonstrata antishqiptare. Për të bërë kthesa nacionaliste nga Qeveria serbe u organizuan marshime dhe demonstrata shoviniste në Kosovë, në Serbi dhe para organeve serbo-jugosllave në Beograd. Parullat e tyre ishin: "*Kosova është Serbi!*", "*Kosova është zemra e Serbisë!*", "*Kosova është tokë e shenjtë serbe!*", "*Ne do të luftojmë për këtë vend të tokës së vjetër serbe!*", "*Serbi mos e lësho Kosovën nga dora!*" etj. Kjo qeveri serbe para organeve shtetërore përdori si paravan shpërnguljen nga Kosova të serbo-malazezëve. Ky ishte vetëm një pretekst i pabazë dhe jashtë realitetit. Në vitin 1989 Qeveria e Serbisë nëpërmjet organeve policore-ushtarake bëri pushtimin klasik të Kosovës, në kundërshtim me pozitën kushtetuese të Kosovës në ish-federatën jugosllave.

Në këtë mënyrë u abrogua subjektiviteti kushtetues i Kosovës në ish-Jugosllavi, si njëra nga tetë njësitë e barabarta, si dhe u suspendua struktura institucionale e autonomisë së gjerë territoriale e politike. Pushteti serb zhvilloi një luftë speciale në forma të ndryshme të pashpallur kundër popullatës shqiptare të Kosovës, duke filluar nga viti 1989 me rrënimin e autonomisë së Kosovës si element konstituiv në federatën e ish-Jugosllavisë Socialiste. Kjo luftë në vitin 1998 eskaloi në sulm të armatosur dhe u zbatua nga formacionet ushtarako-policore e paramilitare të cilat me qëllim të spastrimit etnik të

Kosovës dhe ndërrimit të strukturës nacionale me qëllim të serbizimit të saj vranë, masakruan, zhdukën, dhunuan, dëbuan dhe deportuan popullsinë civile shqiptare, plaçkitën, dogjën dhe rrënuan shtëpitë, pasuritë dhe vendbanimet shqiptare.

Në aspektin juridik Kuvendi i Republikës së Serbisë më 26 qershor 1990 miratoi Ligjin mbi veprimet e organeve republikane në rrethana të veçanta. Me atë Ligj juridikisht dhe praktikisht u rrënuar rendi kushtetues-juridik i RSFJ-së, u suprimua autonomia politike-juridike dhe ekonomike e Kosovës dhe iu morën të gjitha kompetencat e organeve legjislativë, ekzekutive dhe gjyqësore Kosovës, të cilat u bartën në organet e Republikës së Serbisë. Tetë ditë më vonë, më 5 korrik 1990, Kuvendi i RSS-së miratoi Ligjin për ndërprerjen e punës së Kuvendit të KSA të Kosovës dhe të Këshillit Ekzekutiv të Kuvendit të KSA të Kosovës. Sipas atij vendimi, të drejtat dhe detyrat e Kuvendit dhe të Këshillit Ekzekutiv të Kuvendit të Kosovës i morën Kuvendi, respektivisht Këshilli Ekzekutiv i RS të Serbisë. Këshilli Ekzekutiv i Kuvendit të RS të Serbisë më 13 korrik 1990 nxori Dekretligjin për zbatimin e Ligjit për ndërprerjen e punës së Kuvendit të KSA të Kosovës dhe të Këshillit Ekzekutiv të Kuvendit të KSA të Kosovës. Me atë dekretligj përcaktohej mënyra e marrjes së funksioneve të organeve dhe të organizatave të Kosovës, duke iu dhënë autorizime të pakufishme funksionarëve të organeve të RS të Serbisë për sa i përket marrjes së vendimeve ekzekutive dhe administrative.

Pushteti serb bëri ndryshime në ndarjen administrative-territoriale. Janë suprimuar 18 “bashkësitë regjionale ndërkomunale” dhe janë formuar 29 qarqe. Me këtë Serbia është centralizuar. Autonomia e Kosovës u suprimua, kështu që Serbia është centralizuar maksimalisht, ku janë reduktuar pavarësia e krahinës së deriatëhershme autonome e Kosovës, si dhe komunat Presheva dhe Bujanovci, që përbënin shumicën me popullatë shqiptare, me vënien e sistemit shumëpartiak nga aspekti politik janë pavarësuar, kështu që duhet “shpronësuar”.

Përkitazi me këtë nacionalisti, politikani dhe shkrimtari serb Dobrica Qosiq kishte thënë: “Duhet sa më parë të lirohet Kosova dhe të shpëtojë Serbia”⁵⁰

Qeveria e Serbisë me një dekretligj të aprovuar më 3 gusht të vitit 1991 e suprimoi komunën e Malishevës dhe mori qendrim që

⁵⁰ Dobrica Ćosić, Kosovo, Novosti, Beograd, 2004. fq. 181.

vendbanimet e kësaj komuneje të shpërndahen në komunat kufitare: Rahovec, Klinë, Suharekë dhe Glllogvc.

Pas suprimimit të autonomisë së Kosovës, Sekretariati për legjislacion në kuadër të të ashtuquajturës Krahinë Autonome e Kosovës dhe Metohisë, më 30.3.1990 bëhet organizimi territorial i komunave në territorin e Kosovës. Në Kosovë sipas këtij organizimi funksionojnë këto komuna: e Deçanit, Gorës (me seli në Dragash), Glllogocit, Gjilanit, Gjakovës, Vitisë, Vushtrrisë, Zveçanit, Zubin Potokut, Istogut, Kaçanikut, Klinës, Fushë Kosovës, Kamenicës, Leposaviqit, Lipjanit, Malishevës, Novobërdës, Obiliqit, Opojës (me seli në Bresanë), Rahovecit, Pejes, Podujevës, Prizrenit, Prishtinës, Skënderajt, Suharekës, Mitrovicës, Ferizajt, Shtimes dhe Shtërpçës.

Në anën tjetër, në mbledhjen e Kuvendit të Republikës së Kosovës, mbajtur më 7 shtator 1990 në Kaçanik, KK nr. 1/90 është aprovuar Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Me këtë Kushtetutë organizimi territorial i Republikës rregullohet me ligj. Komuna dhe qyteti janë formë e bashkësisë territoriale, ku realizohet vetadministrimi lokal. Me nenin 87 të kësaj Kushtetute organizimi territorial i Republikës së Kosovës është përbërë nga komuna dhe qyteti. Komuna është njësi territoriale në të cilën qytetarët realizojnë vetadministrimin në harmoni me statutin e komunës. Ndërsa me nenin 92 Qyteti i Prishtinës është njësi e posaçme territoriale. Qyteti ka statusin, me të cilin rregullohen funksionet e qytetit, organizimi dhe punët e organeve të qytetit, si dhe çështje të tjera me interes për qytetin.

Me Dekretligjin e Republikës së Serbisë, më 29 janar 1992 Republika e Serbisë, ku ishte edhe Kosova nën administrim të dhunshëm, ishte e ndarë në 29 qarqe. Në Kosovë kishte formuar Qarkun e Kosovës, Qarkun e Pejës, Qarkun e Prizrenit, Qarkun e Mitrovicës dhe Qarkun Moravës. Organet legjitime paralele shqiptare të Kosovës nuk e kishin pranuar një ndarje të tillë administrative të bërë nga pushteti i dhunshëm serb.

Qarqet paraqesin qendra territoriale të administratës shtetërore, të cilat përfshijnë njësitë territoriale të qarqeve. Në Republikën e Serbisë ekzistojnë 25 qarqe administrative, ndërsa territori i çdo qarku administrativ përfshin numër të caktuar të komunave dhe të qyteteve.

NDARJA ADMINISTRATIVE-TERRITORIALE E KOSOVËS PAS ÇLIRIMIT

Pas mbarimit të luftës dhe çlirimit të Kosovës, në vitet e para nuk kishte ndonjë ndarje të caktuar administrative-territoriale. U zbatua ai organizim që ishte para marrjes së autonomisë, me përfshirje të Komunës së Zveçanit.

Në vitin 2000 u soll Rregullorja e UNMIK-ut – UNMIK/REG/2000/43, datë 27 korrik 2000, mbi numrin, emrat dhe kufijtë e komunave në Kosovë. Këtë Rregullore e nënshkroi z. Bernard Kouchner, Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm. Sipas kësaj Rregullore Kosova përbëhej prej 30 komunave: Deçani, Gjakova, Gllgovci, Gjilani, Dragashi, Istogu, Kaçaniku, Klina, Fushë Kosova, Kamenica, Mitrovica, Leposaviqi, Lipjani, Novobërda, Obiliqi, Rahoveci, Podujeva, Prishtina, Prizreni, Skënderaj, Shtimja, Shtërrpca, Suhareka, Ferizaj, Vitia, Vushtrria, Zubin Potoku, Zveçani dhe Malisheva.

Siç po shihet, me këtë Rregullore Malishevës iu kthye statusi i Komunës me ato vendbanime që ishte krijuar në vitin 1985.

Më 15 maj 2001, Hans Hakerup, Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm ka nënshkruar Rregulloren e UNMIK-ut 2001/9. Në këtë rregullore është përfshirë organizimi i Qeverisë së Përkohshme të Kosovës dhe i territorit të saj. Kjo është Rregullore e rëndësishme e lëshuar në dy vitet e fundit, që nga ardhja e UNMIK-ut dhe KFOR-it në Kosovë, sepse kjo krijon një kornizë kushtetuese gjithëpërfshirëse për vetëqeverisje në Kosovë.

Korniza Kushtetuese mbi Vetëqeverisjen e Përkohshme në Kosovë përshkruan institucionet, të cilat do t'u lihen në duar të liderëve kosovarë dhe nëpunësve publikë pas zgjedhjeve më 17 nëntor 2001.

Sipas kësaj kornize të Kushtetutës, në aspektin territorial Kosova është një territor i pandashëm anëmbanë të të cilit ushtrojnë përgjegjësitë e tyre institucionet e përkohshme të themeluara të

vetëqeverisjes. Kosova përbëhet nga komunat, të cilat janë njësi territoriale bazë të vetëqeverisjes lokale me përgjegjësitë e përcaktuara nga legjislacioni i UNMIK-ut, që është në fuqi, mbi vetëqeverisjen lokale dhe komunat në Kosovë.

Kosova qeveriset në mënyrë demokratike nëpërmjet organeve dhe institucioneve ligjvënëse, ekzekutive dhe gjyqësore në pajtim me këtë Kornizë Kushtetuese dhe Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara. Më 22 shtator 2004, sipas Rregullores të cilin e nënshkroi z. Seren Jessen Petersen, në Kosovë ekzistojnë 30 komuna me 1466 vendbanime.

DECENTRALIZIMI I KOSOVËS – FORMIMI I KOMUNAVE TË REJA

Ideja e decentralizimit të administratës në Kosovë erdhi si rezultat i premtimit të Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së për Kosovën Mihajl Shtajnerit dhënë komunitetit serb, si pjesë e planit të tij shtatëpikësh që kishte për qëllim t'i nxiste serbët të marrin pjesë në zgjedhjet lokale të vitit 2002. Shtajner në atë rast pati ftuar Këshillin e Evropës për ta udhëhequr procesin e decentralizimit në Kosovë. Ftesës së Shtajnerit Këshilli i Evropës iu përgjigj në shkurt të vitit 2003 duke e dërguar në Kosovë misionin e ashtuquajtur „*Këshilli i Evropës - Misioni për Decentralizim në Kosovë.*”

Rekomandimet e faktorit ndërkombëtar për decentralizimin në Kosovë

Misioni i Këshillit të Evropës i ka shqyrtuar këto opsione:

- a. Ruajtjen e numrit ekzistues të komunave dhe dhënien e përgjegjësive shtesë,
- b. Krijimin e komunave të reja në kuadër të atyre ekzistuese;
- c. Ndarjen e përgjegjësive dhe kompetencave vendimmarrëse midis niveleve komunale dhe atyre nënkomunale përmes krijimit të këshillave lokale të zgjedhura në mënyrë demokratike;
- d. Krijimit të nivelit rajonal të qeverisjes dhe një numri të kufizuar të komunave të reja;
- e. Krijimit të niveleve rajonale të vetëqeverisjes të përqendruara në 5-7 qytetet më të mëdha të Kosovës;
- f. Krijimit të njëjësive nënkomunale në çdo fshat;
- g. Krijimit të rajoneve të reja dhe një niveli të ri nënkomunal.

Rekomandimet e faktorit ndërkombëtar më së miri e ilustrojnë qëndrimet e prezantuara në vazhdim.

Në raportin e të dërguarit special të OKB-së Kai Eide ndër të tjerat thuhet në pikën 58: "Për të realizuar një kthim të qëndrueshëm dhe komunitete të qëndrueshme minoritare do të nevojitet procesi i decentralizimit". Kurse në pikën 60, Eide vazhdon: "Decentralizimi tani duhet të shqyrtohet seriozisht në një kornizë më të gjerë duke çuar në decentralizim të pushtetit dhe rritje të kompetencave në nivel lokal. Kjo kornizë do të mund të përfshinte një numër komunash të reja dhe në veçanti në ato pjesë ku serbët e Kosovës do të kishin shumicën e theksuar. Kjo mund të parashikonte kompetenca të shtuara në sferën si ajo e policisë, drejtësisë, arsimit, kulturës, mediave, ekonomisë, duke përfshirë edhe emërimin e zyrtarëve kyç. Do të mund të lejonte po ashtu lidhje horizontale midis komunave me shumicë serbe. Mund të shqyrtohen edhe modalitete për lidhje të posaçme me Beogradin, pa i dhënë Beogradit autoritet mbi komunitete të tilla". Kurse Drejtori i Iniciativës Ballkanike të Institutit Amerikan për Paqe Daniel Server disa herë ka tërhequr vërejtjen se serbët në emër të decentralizimit po mundohen ta ndajnë Kosovën në baza etnike. Në lidhje me këtë Server ndër të tjerat ka thënë: "Ndarja në vija etnike nuk është zgjidhje për Kosovën, ky nuk është parim në harmoni me standardet moderne të të drejtave të njeriut".

Albert Rohan, ndihmës i Athissarit (OKB) ka thënë: "Është më se e qartë se një sistem i arsyeshëm i decentralizimit do të jetë kërkesë thelbësore për zgjidhjen e statusit të Kosovës".

Nga qëndrimet e lartpërmendura del se faktori ndërkombëtar është pro decentralizimit. Një pjesë e tij i përkrah kërkesat serbe për decentralizim, që janë të motivuara politikisht, e realisht nuk kanë asgjë të bëjnë me decentralizimin. Pjesa tjetër tërheq vërejtjen se kërkesat serbe nuk kanë asgjë të përbashkët me decentralizimin dhe interesat e qytetarëve të Kosovës.

Decentralizimi i zbatuar në Kosovë

Procesi i reformimit të pushtetit lokal dhe decentralizimit përbën një proces shumë kompleks dhe kërkon themelimin e komunave të reja, bartjen graduale të kompetencave nga institucionet qendrore në pushtetin lokal, duke ngritur kapacitetet lokale për vetëqeverisje efektive dhe duke reformuar sistemin e financave lokale, me miratimin e ligjeve të reja. Krijimi i një sistemi të qëndrueshëm dhe efektiv të vetëqeverisjes lokale në të gjithë territorin e Kosovës do të sigurojë kushte të mira jetese për të gjithë qytetarët e saj duke i

kushtuar kujdes të posaçëm nevojave dhe brengave të komuniteteve joshumicë në Kosovë. UNIMIK-u dhe Qeveria e Kosovës në vitin 2005 miratuan dokumentin kornizë për reformimin e pushtetit lokal dhe decentralizimin.



Ndarja territoriale-administrative e Kosovës në vitet 2005 – 2008 (33 komuna)

Që nga viti 2005 në Kosovë kanë funksionuar si pilot-njësi komunale Komuna e Hanit të Elezit, Komuna e Junikut dhe Komuna e Mamushës.

Me Kushtetutën e Republikës së Kosovës të miratuara më 15 qershor 2008 nga Kuvendi i Kosovës, Kosova në aspektin territorial, si

njësi themelore territoriale të vetëqeverisjes lokale në Republikën e Kosovës ka komunat; organizimi dhe kompetencat e njërive të vetëqeverisjes lokale rregullohen me ligj. Kryeqyteti i Republikës së Kosovës është Prishtina.

Me hyrjen në fuqi të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe aprovimit nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, nga Presidenti i Republikës së Kosovës më 15 qershor 2008 u nënshkruar Ligji për kufijtë e komunave. Neni 5.5 i Ligjit për kufijtë administrativë të komunave përcakton numrin e komunave të Republikës së Kosovës, duke përfshirë edhe komunat: Hani i Elezit, Junik dhe Mamushë. Këto tri komuna disa vite kanë qenë pilot-njësi komunale, të njëjtat tani ushtrojnë kompetencat dhe përgjegjësitë e plota komunale në bazë të Ligjit për vetëqeverisje lokale.

Komuna e Novobërdës

Me Ligjin për ndarjen administrative-territoriale të Serbisë në vitin 1952, kur suprimohen këshillat popullore të vendeve, formohet komuna e Novobërdës me seli në Boston. Në vitin 1964 suprimohet kjo komunë dhe vendbanimet ndahen ndërmjet komunës së Prishtinës dhe të Gjilanit. Në vitin 1988 formohet komunë e re. Me Ligjin për kufijt administrativë të komunave të vitit 2008 Komuna e Novobërdës zgjerohet, duke përfshirë edhe këto vendbanime të Komunës së Gjilanit: Kufca e Epërme, Makreshi i Epërm, Makreshi i Poshtëm, Draganca, Koretishta, Mozgova, Paralova, Pasjaku, Stanishori dhe Strazha; nga Komuna e Kamenicës përfshinë vendbanimet Bolevc, Bushincë, Miganovc, Tirincë dhe Carevc.

Komuna e Hanit të Elezit

Komuna e Hanit të Elezit është themeluar në vitin 2005 si pilot-komunë nga vendbanimet jugore të komunës së Kçanikut. Më vonë në bazë të Ligjit për kufijtë administrativë të komunave të Kosovës të datës 20 shkurt 2008, më datën 17 tetor 2008 mbahet mbledhja konstituive e kuvendit komunal. Kësaj komune i takojnë vendbanimet: Dimcë; Dërmjak, Paldenicë, Seçishtë, Gorancë, Rezhancë, Pustenik, Krivenik, Vërtomicë (vendbanim i pabanuar), Neçavcë (vendbanim i pabanuar) dhe Hani i Elezit. Si vendbanime janë edhe: Lagja e Re, Lagja Uji i Thartë, Lagja Meliq, Lagja Brava, Lagja Rana, ende pa status të rregulluar, por njihen si lagje. Territori i komunës së Hanit të Elezit ka një sipërfaqe prej 83 km².

Komuna e Junikut

Komuna e Junikut është themeluar në vitin 2005 si pilot-komunë nga tri vendbanime të komunës së Deçanit: Juniku, Jasiqi Gjacaj. Në bazë të Ligjit për kufijtë administrative të komunave të datës 20 shkurt 2008 është konstituuar si komunë.

Komuna e Mamushës

Komuna e Mamushës është themeluar në vitin 2005 si pilot-komunë nga komuna e Prizrenit dhe ka rreth 5.500 banorë, ku shumica janë të nacionalitetit turk. Përfshinë vetëm një zonë kadastrale – Mamushën. Si komunë e pavarur është konstituuar në muajin tetor të vitit 2008.

Më datën 13 maj 2008 bihet Raporti i të Dërguarit të Posaçëm të Sekretarit të Përgjithshëm për statusin e ardhshëm të Kosovës. Ky është Propozimi Gjithpërfshirës Përfundimtar për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës. Në fillim jepen të dhënat për rregullat kushtetuese, më pastaj për mënyrën e decentralizimit. Ofrimi i sistemit të decentralizimit ka për qëllim të avancojë qeverisjen e mirë, transparencën dhe efikasitetin e shërbimeve publike. Marrëveshja i ofron komunitetit serbë një shkallë të lartë të kontrollit të punëve të tyre.

Me marrëveshje formohen gjashtë komuna të reja apo komuna me kompetenca shtesë me shumicë serbe të Kosovës: Mitrovica Veriore, Graçanica, Ranillugu, Parteshi, Klllokoti/Vërboci dhe Novobërda. Komuna e tanishme e Mitrovicës do të ndahet në dy komuna, në Mitrovicë Veriore dhe Mitrovicë Jugore, me një bashkëpunim dhe bashkërendim mes veti të ndihmuar nga një këshill i përbashkët i ri i formuar.

Decentralizimi i pushtetit lokal, formimi i komunave serbe në Kosovë është një ndër pikat dhe obligjimet kryesore që dalin në planin e Marti Ahtisarit. Qëllimi i këtyre ndryshimeve administrative-territoriale është siguri i të drejtave të gjëra dhe pavarësia politike dhe administrative e serbëve në Republikën e Kosovës. Siç thuhet, vetëqeverisja lokale është e një rëndësie të veçantë dhe ka rol kyç në funksionimin e shoqërisë bashkëkohore.



Ndarja territoriale-administrative e Kosovës në vitin 2010 (38 komuna)

Komuna e Graçanicës

Komuna e Graçanicës është formuar në bazë të Ligjit për kufijtë administrativë të komunave të datës 20 shkurt 2008, pas mbajtjes së zgjedhjeve të para lokale më 15 nëntor 2009. Zyrtarisht Komuna e Graçanicës ekziston prej datës 29 dhjetor 2009 kur është mbajtur mbledhja inauguruese e Kuvendit të Komunës së Graçanicës. Komuna e Graçanicës shtrihet në pjesën qendrore të Kosovës dhe kufizohet në jug me komunën e Lipjanit, kurse në perëndim me Komunën e Fushë-Kosovës. Territori i komunës përfshinë sipërfaqen prej 131,25 kilometra katrorë. Në harmoni me ligjin, kufijtë administrativë të saj përbëhen prej 16 zonave kadastrale: Badovci, Batusa, Çagllavica,

Dobratini, Graçanica, Gushterica e Poshtme, Gushterica e Epërme, Llapllesella, Lepia, Preoci, Skullani, Sushica, Suhadolli, Radeva dhe Uglari.

Komuna e Kllokotit është formuar në bazë të Ligjit për ndarjen administrative të komunave të Kosovës të datës 20 shkurt 2008. Kjo komunë përfshinë fshatrat kadastrale Vërbovc, Gërçar, Kllokot dhe Mogilë. Zgjedhjet dhe parlamenti lokal është mbajtur më 15 nëntor 2009. Kjo komunë është formuar sipas planit të Marti Ahtisarit për decentralizimin e Kosovës me qëllim të formimit të komunave me shumicë etnike serbe në komunën e Vitisë. Sipërfaqja e komunës është 23,39 kilometra katrorë.

Komuna e Ranillugut është formuar sipas Ligjit për kufijtë administrativë të komunave të Kosovës të datës 20 shkurt 2008. Përfshin vendbanimet dhe komunat kadastrale Ranillug, Bozhevc, Ropotovë e Madhe, Gillogovc, Kormjan i Epërm, Domorodc, Kormjan i Poshtëm, Drenovc, Ropotovë e Vogël, Hodovc, Pançelë, Rajanovc dhe Tomancë. Këto komuna më parë ishin në kuadër të komunës së Kamenicës. Zgjedhjet dhe parlamenti lokal është mbajtur më 15 nëntor 2009. Sikurse komunat tjera edhe kjo është formuar sipas planit të Marti Ahtisarit. Kuvendi i komunës ka filluar punën më 5 janar 2010. Sipërfaqja e komunës është 74,28 kilometra katrorë. Është krijuar nga 15% i territorit të komunës së Kamenicës.

Komuna Partesh-Pasjan është formuar më 19 gusht 2010, në harmoni me Propozimin Gjithpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës dhe pas zgjedhjeve lokale të mbajtura më 18 qershor 2010. Territori i Komunës Partesh-Pasjan përfshin zonat kadastrale: Budriga e Poshtme, Pasjani dhe Parteshi.

Kosova sot

Republika e Kosovës shtrihet në pjesën perëndimore të Gadishullit Ballkanik dhe bën pjesë në shtetet e Evropës Juglindore. Sipas regjistrimit të vitit 1981 Kosova kishte 1.584.440 banorë, prej tyre shqiptarë 1.226.736 ose 74,4%, serbë 209.497 ose 13.2%, malazezë 27.028 ose 1.07%, myslimanë 58.562 ose 3.7%, turq 12.513 ose 0.8%, romë 34.126 ose 2.2%, të tjerë 15.978 ose 1.0%. Por, sipas një vlerësimi të bazuar në shtimin natyror Popullata shqiptare e bojkotoi regjistrimin e vitit 1991 Kosova kishte 1.956.196 banorë, prej tyre 1.596.072 ose 81.6% shqiptarë. Ndërsa, sipas regjistrimit serb të këtij viti, Kosova kishte 194.190 ose 9.9% serbë, 20.369 ose 1.0%

malazezë, 66.189 ose 3.4% boshnjakë, 10.445 ose 0.5% turq, 45.745 ose 2.3% romë dhe të tjerë 23.190 ose 1.2%.

Agjencia e Statistikave të Kosovës publikoi, rezultatet e regjistrimit të popullsisë, i pari në këto 30 vitet e fundit. Numri i banorëve që jetojnë në territorin e Kosovës, sipas rezultateve përfundimtare të vitit 2011, është 1 milion e 739 mijë e 825 banorë. Nga ta, 92.93 për qind janë shqiptarë. Duhet theksuar se në këtë regjistrim nuk janë përfshirë banorët e Kosovës në mërgim me punë jashtë atdheut. Kosova ka një sipërfaqe prej 10.887 km². Kryeqyteti i Kosovës është Prishtina.

PJESA E DYTË
DOKUMENTE

PREZANTIMI DHE PUBLIKIMI I DOKUMENTEVE

Në çdo vepër shkencore arkivore-historike është me rëndësi qasja, përpunimi dhe prezantimi i temës së paraqitur. Publikimi i dokumenteve arkivore është i lidhur ngushtë me metodologjinë e regjistrimit dhe prezantimit të tyre. Ky publikim i dokumenteve, pa marrë parasysh qëllimin, bëhet në bazë të parimeve të caktuara shkencore dhe procedurës metodologjike të përcaktuara në bazë të njohurive teorike dhe përvojave shumëvjeçare. Nga metodologjia e punës në fund varen edhe rezultatet e punës së sendërtuar.

Publikimi i dokumenteve arkivore paraqet veprimtari shkencore dhe profesionale të llojit të vet, i cili kërkon njohjen e mirë të problematikës dhe qëllimit të caktuar të publikimit, njohuritë për dokumentet, përvojën e redaktimit, njohjen e mirë e gjuhës në të cilën është shkruar dokumenti, vlerësimin e dokumenteve etj., kështu që kjo është punë mjaft me rëndësi, e ndërlikuar dhe me përgjegjësi.

Rëndësia e publikimit është e shumëfishtë, por më qenësoret janë këto çështje: publikimi i burimeve arkivore mundëson mbrojtjen më të mirë të lëndës arkivore, lehtëson punën e hulumtuesve shkencorë sidomos në kohë dhe me mjete financiare. Publikimi e zgjeron horizontin e njohurive nga historia dhe shkencat e tjera, e me këtë edhe popullaritetin e saj. Publikimi i përmbledhjeve – koleksioneve ose edicioneve të dokumenteve shërbejnë për njohjen me ngjarjet apo ndodhitë historike jo vetëm të punëtorëve shkencorë, por të një rrethi më të gjerë të cilëve iu intereson e kaluara historike. Me publikimin e dokumenteve ruhen burimet origjinale nga përdorimi i shpeshtë dhe dëmtimi dhe njëherësh ato u vihen në dispozicion një numri më të madh të shfrytëzuesve, në radhë të parë punëtorëve shkencorë. Puna e kryer në mënyrë të drejtë dhe të plotë, në bazë të parimeve shkencore-profesionale bashkëkohore në publikimin e dokumenteve është me vlerë të përhershme, sepse publikimi i tejkalon shumë paraqitjet historike të ngjarjeve, të cilat u nënshtrohen ndryshimeve dhe plotësimeve të përhershme. Publikimi kontribuon në zgjidhjen e shumë çështjeve e detyrave të caktuara në fushëveprimet e

ndryshme nga lëmi i veprimtarisë shkencore-hulumtuese, arsimore dhe qëllimeve ideologjike-politike e edukative, si dhe për nevoja të tjera kulturo-historike.

Qëllimi i publikimit të dokumenteve duhet të jetë: botimi shkencor, diplomatik, shkencor-popullor, shkollor, filologjik etj. Puna në publikimin e dokumenteve përbëhet prej grumbullimit të dokumenteve dhe zgjedhjes së tyre, përcaktimi i origjinalitetit, shikimi i tekstit me qëllim të shpjegimit të së metave dhe stilit, ose të gabimeve dhe përcaktimit eventual të instruksioneve, në zgjedhjen e shkurtësive dhe mjaft shpesh në transkriptimin nga shkrimi i vjetër në atë modern, me faksimilin origjinal eventual, etj. Puna në publikim përfshin edhe shumë shpjegime të dukurive historike, ngjarjeve, personaliteteve me lidhjet e tyre, hartimi i legjendave të dokumenteve (institucioni arkivor, sinjatura, lloji dhe fizionomia, botimi eventual) dhe përcaktimi i elementeve të titullit të tij në libër, përpilimi i indeksit, shtojcat eventuale, pasqyrat dhe fjalorthi, përpilimi i regestave, parathënies, karakterit redaktues ose në përgjithësi hyrja në lëndën e cila publikohet.

Puna në temën “Ndarja administrative-territoriale e Kosovës 1944-2010” është filluar në hulumtimin dhe regjistrimin e dokumenteve në fonde e koleksione arkivore, gazeta e revista, që kishin të dhëna për këtë temë dhe më pastaj është vazhduar në procedura të tjera të punës në prezantim.

Për përzgjedhjen e dokumenteve për publikim duhet të zbatohen edhe disa kritere, siç janë: ato të cilat në mënyrë të drejtë dhe të plotë e paraqesin temën e prezantuar nga aspekti historik janë më interesante; janë më të rëndësishmet; i kënaqin nevojat e hulumtimeve shkencore moderne; shërbejnë për qëllime edukative; janë më tipike; janë të sakta nga aspekti shkencor etj.

Sipas standardeve ndërkombëtare ekzistojnë disa **tipa** të publikuar të dokumenteve, siç janë:

- a. Publikimi akademik, shkencor dhe shkencor-hulumtues, ku përfshihen të gjitha dokumentet për temën kryesore të paraqitur;
- b. Publikimi shkencor i dokumenteve të zgjedhura;
- c. Botimet shkencore-popullore – vetëm për dokumentet më të rëndësishme;
- d. Krestomacitë shkollore dhe universitare (botime të tipit studiues);

e. Publikimi i lëndës arkivore në revista dhe gazeta, etj.

Ndërsa, sipas **kategorive** të dokumenteve arkivore i dallojmë këto publikime: shkencor i tipit standard; diplomatik; i dorëshkrimeve të autorëve; shkencor-popullarizues dhe shkollor.

Sa i përket formës së kritereve të publikimit të dokumenteve ekzistojnë këto **kritere** të publikimit: sistematik-kronologjik; tematik (i cili ka të bëjë për një çështje apo problem); sipas karakterit, përkatësisht llojit të burimeve; sipas proveniencës; botimi i një fondi; në bazë të gjuhës; shkrimit; autenticitetit, etj.

Dokumentet mund të publikohen në këto **mënyra**: tërë teksti (*in exenco*); ekstrakte të dokumentit; në formë regesti; në formë të tabelës e cila përfshin shënimet e shkurta nga disa dokumente të formës së njëjtë; në përkthim mund të bëhen publikime të dokumenteve në formë të kombinuar. Për këtë temë të ndarjes administrative-territoriale të Kosovës është shfrytëzuar forma e publikimit në formë të kombinuar. Disa dokumente janë publikuar në tërësi, disa vetëm ekstrakte që flasin për ndarjen administrative-territoriale dhe kanë të bëjnë për territorin e Kosovës.

Në fund mund të konstatojmë se publikimi i dokumenteve duhet të përbëjë aso lloj shënimesh, të cilat janë të rëndësishme jo vetëm për historianin, por edhe për juristin, gazetarin, profesorin dhe në përgjithësi për njeriun e arsimuar. Pra, duhet botuar ato dokumente të cilat paraqesin më shumë informata që janë aktuale.

DOKUMENTI 1

*Konferenca e parë e
Keshillit Nacional Çlirimtar për
Kosovë e Metohi*

31-XII-1943 dhe 2-I-1944.

KONFERENCA E PARË

KESHILLIT NACIONAL ÇLIRIMTAR PËR KOSOVË E METOHI
31-XII-1943 - 1 e 2-I-1944

ZHVILLIMET NE KRASHIQË KATONË BUNIAJ, LAGJIA FANG NE
SHTETIN E PATRIOTIT "SALIH RAN MUJOSMANI".-

REZOLUCION

NEA KONFERENCA E PARË E KESHILLIT NACIONAL ÇLIRIMTAR
PËR KOSOVË E GRASHI TE DUKAGJINIT E MBAJTUR NE 31
DENVER 1943 NE 1 DHE 2 KALENDOR 1944".-


Perfaqesues nga te gjithe vliet e Kosoves e Rrafshit Dukagjinit, Shqiptare, Serb, e Malazez: nacionalist, komuniste, rrial antifashiste, rrial komuniste, gra antifashiste, perfaqesues t'Ushterise Nacional çlirimtare, etj. te frymezue nga ideali i malte per bashkimia e teadecave te adrysha politike, per zhvillimia e bashkimia e popujve te Kosoves e te Rrafshit Dukagjinit dhe per forcimia e luftes s'armatosur t'orgaizuesme te popujve t'ose kuadra zaptusave fashiste dhe hyzmeqarëve te tyre, u mbledha ne çastia kur situata e jashteme dhe e mbroedeshme eshte e kjarste, shqyrtuaa puses e deri tashme te Keshillit Nacional çlirimtar dhe zgjedha Kryesia e Keshillit Nacional çlirimtar.

Konferenca koastatoj :

I

A) Ngjarjet mderkohetare po zhvilloha ne shpeitesi te madhe ne dem te fashizmit gjerman, disfata e te cilit eshte e pa svtitushme dhe e aferte.





Ekstrakt i procesverbalit të Konferencës së Bujanit
(ASHK, Këshilli Popullor Krahinor, 1944-1946, kutia 1)

DOKUMENTI 2

СУВАТИСТАЛНО

ВРХОВНИ ШТАБ
НАРОДНО ОСЛОБОДИЛАЧКЕ ВОЈСКЕ
И ПАРТИЗАНСКИХ ОДРЕДА ЈУГОСЛАВИЈЕ

Стр.Пов.Бр. 31
8 фебруар 1945 год.

По указаној потреби,

П Л Р Е Д Л О Ж Е Н И Е

1. Да се у Косову и Метохији заведе и успостави Војна управа, која ће бити орган војно-државне власти у поменутој области.

2. За команданта војне управе Косова и Метохије постављам пуковника Заво Државина, команданта Оперативног штаба за Косово и Метохију.


За политичког комесара постављам пуковника Тура Меденицу, политичког комесара Оперативног штаба за Косово и Метохију.

Пуковник Заво Државина и потпуковник Тура Меденица вршиће ову дужност уз своју редовну дужност у Оперативном штабу.

3. За команданта Војне области Косова и Метохије постављам пуковника Ђуковића Ђипокоу Ђокићина.

Команда војне области је непосредно потчињени орган Војној управи, односно Оперативном штабу за Косово и Метохију.

СМРТ РАДНИЦИ - СЛОБОДА НАРОДУ.



ВРХОВНИ ШТАБ
НАРОДНО ОСЛОБОДИЛАЧКЕ ВОЈСКЕ
И ПАРТИЗАНСКИХ ОДРЕДА
ЈУГОСЛАВИЈЕ
Београд, 1945

ВРХОВНИ КОМАНДАНТ
НАРОДНО ОСЛОБОДИЛАЧКЕ ВОЈСКЕ
И ПАРТИЗАНСКИХ ОДРЕДА ЈУГОСЛАВИЈЕ
Косовска Југославије,

[Signature]

ПОСТАВЉАМО:

- Оперативном штабу за Косово и Метохију,
- Главном штабу за Србију,
- Команди позадине НКО,
- Персоналном оделу НШ.

Urdhëresë e Aministrimit ushtarak në Kosovë 1945
(Arhiv Vojno Istorijskog Instituta Beograd, P.16)

DOKUMENTI 3

Në bazë të pikave 1, 4 dhe 8 të Kuvendit të Madh Antifashist Nacional-Çlirimtar të Serbisë dhe konstituimit të ASNOS-it si organ suprem ligdhënës i pushtetit shtetëror të Serbisë Demokratike, në lidhje me nenin 3 të Ligjit për ndryshimet dhe plotësimet të këtij Vendimi – Kryesia e Kuvendit Popullor të Serbisë miraton

Ligjin⁵¹ për ndarjen administrative të Serbisë

Neni 1

Serbia si njësi federale në përbërje të Republikës Fedrative Demokratike të Jugosllavisë përbëhet nga:

1. Qarku i Beogradit (Beograd), Valevës (Valevë), Vranjës (Vranje), Kragujevcit (Kragujevc), Krushevcit (Krushevc), Leskovcit (Leskovc), Moravës (Jagodinë), Novipazarit (Novi Pazar), Nishit (Nish), Pirotit (Pilot), Podrimës (Shabac), Pozharevcit (Pozharevc), Timokut (Zajeçar), Toplicës (Prokuple), Uzhicës (Uzhicë), Çaçakut (Çaçak) dhe territori i Qytetit të Beogradit.
2. Krahina Autonome e Vojvodinës dhe
3. Krahina⁵² Autonome e Kosovës dhe Metohisë.

Neni 2

Krijimi dhe rregullimi i Krahinës Autonome të Vojvodinës dhe Krahinës Autonome të Kosovës dhe Metohisë përkohësisht do të rregullohen me ligje të veçanta.

⁵¹Dokumentet janë kryesisht në gjuhën serbe.

Neni 3

Ky Ligj hyn në fuqi kur të publikohet në “Gazetën zyrtare të Serbisë”.

Kryesia e Kuvendit Popullor të Serbisë

Në Beograd, 1 shtator 1945.

Nr. 1986.

Kryetari

Dr. Sinisha Stanković, d.v.

Sekretari

Dr. Mil. Vllajković, d.v.

(NBB, Službeni glasnik NRS, nr. 28/1945)

DOKUMENTI 4

Në bazë të dëshirës të cilën popullata e Krahinës Autonome të Kosovës dhe Metohisë e ka shprehur në rezolutën e Kuvendit të vet të Krahinës më datën 10 qershor 1945 dhe në bazë të rezolutës së Kuvendit të Përkohshëm të Kuvendit Popullor të Republikës Federative Demokratike të Jugosllavisë të datës 10 qershor 1945, Kryesia e Kuvendit Popullor të Serbisë miraton

Ligjin për themelimin dhe rregullimin e Krahinës Autonome të Kosovës dhe Metohisë

Neni 1

Krahina Autonome e Kosovës dhe Metohisë përbëhet nga rrethet: e Gorës (Dragash), Suharekës (Suharekë), Sharrit (Prizren), Gjakovës (Gjakovë), Podrimës (Rahovec), Pejës (Pejë), Istogut (Istog), Zveçanit (Mitrovicë), Vushtrrisë (Vushtrri), Llapit (Podujevë), Drenicës (Skënderaj⁵³), Nerodimës (Ferizaj), Graçanicës (Prishtinë), Kaçanikut (Kaçanik), Gjilanit (Gjilan). Selia e krahinës përkohësisht është në Prizren.

Neni 2

Krahina Autonome e Kosovës dhe Metohisë përbën pjesë të Serbisë dhe përbën edhe Kuvendin Popullor, zgjedhjen e deputetëve proporcionalisht me numrin e deputetëve popullorë.

Krahina Autonome e Kosovës dhe Metohisë zgjedh 10 deputetë për Kuvendin Popullor të Kuvendit Kushtetues të Republikës Demokratike të Jugosllavisë.

⁵³ Në dokument – Serbicë.

Neni 3

Pushteti popullor i Krahinës Autonome të Kosovës dhe Metohisë, pra pushtetet vendore, të rrethit dhe të krahinës punojnë në bazë të ligjit të Serbisë dhe ligjit të Jugosllavisë Demokratike Fedrative, si dhe në bazë të vendimit të Kuvendit Popullor të Krahinës Autonome të Kosovës dhe Metohisë, të cilat organe dalin nga ligji i përmendur më lart dhe po kështu në bazë të vendimeve dhe urdhëresave të Qeverisë Popullore të Serbisë dhe të ministrave të saj, Qeverisë Fedrative dhe të ministrave të tyre. Ato udhëheqin të varura nga organet administrative dhe sigurojnë ruajtjen e rendit shtetëror dhe të drejtat e qytetarëve.

Neni 4

.....⁵⁴

Neni 11

Ky Ligj hyn në fuqi kur të publikohet në “Gazetën zyrtare të Serbisë”.

Kryesia e Kuvendit Popullor të Serbisë

Në Beograd, 3 shtator 1945.

Nr. 1990.

Kryetari

Dr. Sinisha Stanković, d.v.

Sekretari

Dr. Mil. Vllajković, d.v.

(*NBB, Službeni glasnik NRS, br. 28/1945*)

⁵⁴Disa pjesë të këtij ligji dhe të dokumenteve të tjera nuk kanë të bëjnë me ndarjen administrative-territoriale, andaj nuk janë paraqitur në këtë vepër. Shenjat (pika) tregojnë se teksti në dokument ekziston, por nuk ka të bëjë me temën në shqyrtim.

DOKUMENTI 5

**Vendim
i Kuvendit Kushtetues
të Republikës Popullore Fedrative të Jugosllavisë
për shpalljen e kushtetutës
të Republikës Popullore Fedrative
të Jugosllavisë**

Kuvendi kushtetues i Republikës Popullore Fedrative të Jugosllavisë, si përfaqësues suprem i suverenitetit popullor dhe shprehje e dëshirës unike të të gjithë popujve të Republikës Popullore Fedrative të Jugosllavisë, në mbledhjen e përbashkët të të gjitha dhomave të Kuvendit Fedrativ dhe Kuvendit Popullor

Vendos

Që Kushtetuta e Republikës Popullore Fedrative e Jugosllavisë, e miratuar nga Kuvendi Fedrativ dhe Kuvendi Popullor, ku theksohet dhe publikohet për popujt dhe qytetarët e Republikës Popullore Fedrative të Jugosllavisë.

**KUSHTETUTA
E REPUBLIKËS POPULLORE FEDRATIVE TË
JUGOSLLAVISË**

PJESA E PARË

PARIMET THEMELORE

KREU I

**REPUBLIKA FEDRATIVE POPULLORE
E JUGOSLLAVISË**

Neni 1

Republika Fedrative Popullore e Jugosllavisë është shtet federativ popullor i formës republikane, bashkësi e popujve të barabartë, të cilët në bazë të të drejtave për vetëvendosjes, duke përfshirë edhe të drejtën për ndarje, kanë shprehur dëshirën që të jetojnë bashkë në shtetin federal.

Neni 2

Republikën Fedrative Popullore të Jugosllavisë e përbëjnë: Republika Popullore e Serbisë, Republika Popullore e Kroacisë, Republika Popullore e Sllovenisë, Republika Popullore e Bosnjes dhe Hercegovinës, Republika Popullore e Maqedonisë dhe Republika Popullore e Malit të Zi.

Republika Popullore e Serbisë në përbërjen e vet ka Krahinën Autonome të Vojvodinës dhe Krahinën Autonome të Kosovës dhe Metohisë.

.....

Neni 5

Kryeqyteti i Republikës Fedrative Popullore të Jugosllavisë është Beogradi.

....

Neni 12

Përkufizimin e territoreve të Republikave e bën Kuvendi Popullor i RFPJ-së.

Kufijtë e republikave popullore nuk mund të ndryshohen pa pëlqimin e tyre.

....

Neni 45

Territori i Republikës Federative të Jugosllavisë përbëhet nga territoret e republikave të saj dhe përfshin territor unik shtetëror e ekonomik.

....

KREU XI

ORGANET E PUSHTETIT SHTETËROR TË KRAHINËS
AUTONOME DHE PROVINCËS AUTONOME

Neni 103

Të drejtat dhe veprimet e autonomisë së krahinës autonome dhe provincës autonome përcaktohen me Kushtetutën e Republikës.

Neni 104

Statuti i krahinës autonome, përkatësisht i provincës autonome hartohet në harmoni me Kushtetutën e RFPJ-së dhe me Kushtetutën e Republikës si organi më i lartë i pushtetit shtetëror i krahinës autonome, përkatësisht provincës autonome, ndërsa e vërteton Kuvendi Popullor i Republikës.

Neni 105

Organi më i lartë i pushtetit të krahinës autonome është kuvendi i popullor i krahinës autonome, të cilin e zgjedhin qytetarët e krahinës autonome në periudhën prej tri viteve, i cili mbledhet sipas dispozitave të Kuvendit të Republikës.

Kuvendi popullor i krahinës autonome e zgjedh këshillin ekzekutiv të krahinës autonome si organ të vetin ekzekutiv dhe organ administrativ.

Neni 106

Organi më i lartë i provincës autonome është Këshilli Popullor Krahinor⁵⁵, të cilin e zgjedhin qytetarët e krahinës autonome në periudhën prej tri viteve dhe i cili i mban mbledhjet e tij sipas dispozitave të Kushtetutës së Republikës.

Këshilli popullor krahinor e zgjedh këshillin ekzekutiv si organ të vetin ekzekutiv dhe administrativ.

KREU XII

ORGANET E PUSHTETIT SHTETËROR TË NJËSIVE
ADMINISTRATIVE-TERRITORIALE

Neni 107

Organe të pushtetit shtetëror të vendeve (fshatrave, qyteteve të vogla, disktrikteve, rajoneve të qyteteve, qyteteve, qarqeve dhe krahinave) janë Këshillat Popullorë.

.....

Në Beograd

Kryeqytetin e Republikës Federative Popullore të Jugosllavisë,
31 janar 1946.

**KRYESIA KUSHTETUESE E KUVENDIT TË REPUBLIKËS
FEDRATIVE POPULLORE TË JUGOSLLAVISË**

Sekretari

Mile Perunçiq, d.v.

Kryetari

Dr. Ivan Ribar, d.v.

.....

(ASHK, Službeni list FNRJ nr. 10/1 februar 1946)

⁵⁵ Në dokument Krahinë e Vojvodinës quhet "Pokrajina", ndërsa Kosova "Oblast", që do të thotë shkallë më e ulët dhe me të drejta më të kufizuara.

DOKUMENTI 6

DEKRET

Në bazë të nenit 74, pika 6 e Ligjit të Presidiumit të Kuvendit Popullor të RFPJ-së shpallet Ligji i Përgjithshëm për Këshillat Popullorë të cilin e kanë sjellë Dhoma Fedrative dhe Dhoma e Popujve të Kuvendit Popullor të RFPJ-së, në të cilin thuhet:

Ligji i përgjithshëm për Këshillat Popullorë

Me qëllim të forcimit të mëtejshëm dhe zhvillimit të këshillave popullorë si organe themelore të pushtetit shtetëror të krijuara gjatë luftës nacionalçlirimtare kundër fashizmit dhe reaksionit dhe me qëllim të ndërtimit të plotë të organizimit shtetëror të Republikës Popullore Fedrative të Jugosllavisë në bazë të parimeve të Kushtetutës,

Në mënyrë që të jepet edhe bazë më e gjerë për pjesëmarrjen aktive të popullit në realizimin e pushtetit;

Që masat e gjera të popullit të jenë të përfshira, të cilat me shekuj kanë qëndruar jashtë pushtetit, janë përfshirë në administrimin shtetëror dhe janë mësuar të udhëheqin shtetin;

Që në të gjitha nivelet e organizimit të pushtetit shtetëror në masë të plotë janë shprehur parimet e vërteta të demokracisë popullore; dhe

Të sigurohet bashkimi i parimeve demokratike në punën e organeve të pushtetit shtetëror në rregullimin dhe punën e organeve të pushtetit shtetëror dhe administratës shtetërore në republikat e reja popullore, krahinat dhe provincat autonome.

KUVENDI POPULLOR I RFPJ-së

miraton

Ligjin e përgjithshme për Këshillat Popullorë**PJESA I****PARIMET THEMELORE****Neni 1**

Këshillat popullorë janë organe më të larta në pushtetin shtetëror nëpërmjet të të cilit populli realizon pushtetin e vet në njësitë administrative-territoriale.

Neni 2

Këshillat popullorë janë organet më të larta të pushtetit shtetëror në aspektin e rëndësisë lokale në territorin e vet.

Këshillat popullorë në territorin e vet i realizojnë detyrat e rëndësisë së përgjithshme.

Neni 3

Këshillat popullorë janë organe përfaqësuese, të zgjedhura në bazë të së drejtës së zgjedhjeve të përgjithshme, të barabarta dhe të drejtpërdrejta me votë të fshehtë.

Neni 4

Këshillat popullorë e realizojnë pushtetin që hyjnë në kuadër të kompetencave të tyre të mbështetur dispozita të përgjithshme, të bazuar në Kushtetutën e RFPJ-së, kushtetutën e republikës popullore, ligjeve të RFPJ, ligjeve të republikës, dispozitave të përgjithshme të organeve më të larta shtetërore dhe të administratës shtetërore.

.....

Neni 9

Këshillat popullorë themelohen në territoret e njësisve administrative-territoriale: vendeve (fshatrave dhe qyteteve të vogla), qyteteve, rretheve, qarqeve, përkatësisht krahinave.

Republika popullore mund të ketë edhe krahina. Republika popullore e vogël nuk është e detyruar të ketë qarqet.

Territori i krahinës autonome dhe i krahinave ndahet në rrethe, qytete dhe vende (fshatra dhe qytete të vogla).

Çdo trevë gjendet në territorin e një vendi ose qyteti.

Me ligjin e republikës bëhet ndarja administrative-territoriale e republikës.

Neni 10

Në fshatra dhe në qytete të vogla (qyteza, vendet e tregut) formohen këshillat popullore të vendeve. Dy ose më shumë fshatra të vogla, të cilat sipas numrit të banorëve dhe forcës ekonomike nuk janë në gjendje që vetë të administrojnë me punët e veta, formojnë një këshill popullor të vendit, me kusht që me atë mos t'iu krijojnë dëme në jetën ekonomike dhe kulturore atyre fshatrave të vogla.

Vendimin për themelimin e një këshilli popullor të vendit me dy ose më shumë fshatra të vogla e merr presidiumi i kuvendit popullor i republikës, përkatësisht kuvendi popullor, përkatësisht kuvendi popullor i krahinës autonome me propozim të këshillit popullor të qarkut, përkatësisht të krahinës.

Neni 11

Në qytete formohen këshillat popullore të qyteteve.

Ligji i republikës përcakton vendet ose vendbanimet, qytetet, si dhe emrat dhe kufijtë e tyre. Ligji i republikës përcakton se cilat qytete ndahen nga përbërja administrative e rrethit, përkatësisht e qarkut.

Neni 12

Me ligjin e Republikës mundësohet që në qytete të mëdha të formohen këshilla popullore të rajoneve, e në raste të veçanta në qytete të mëdha edhe këshillat popullore të vendbanimeve.

Neni 13

Këshillat popullore të qyteteve janë në shkallën e këshillit popullor të rrethit. Këshillat popullore të qyteteve, të cilat janë ndarë nga përbërja administrative e qarkut, janë në shkallën e këshillit

popullor të qarkut. Rregullimi dhe kompetencat e këshillave popullorë të rajoneve, përkatësisht të vendbanimeve përcaktohen me statut të këshillit popullor të qytetit.

Neni 14

Në rreth formohen këshillat popullorë të rretheve. Rrethi përfshin territorin, i cili lidh në një tërësi natyrore dhe ekonomike disa vende (fshatra dhe qytete të vogla), të cilat kanë interesa të përbashkëta ekonomike, kulturore dhe administrative.

Këshilli popullor i rrethit drejtpërsëdrejt është kompetent për këshillat popullorë të vendeve.

Neni 15

Në qarqe formohen këshillat popullorë të qarqeve. Qarku përfshin territorin e disa rretheve, të cilat e përbëjnë një tërësi natyrore dhe ekonomike.

Selia e këshillit të qarkut është në vendin i cili është qendër jetësore e qarkut. Këshilli popullor i qarkut drejtpërsëdrejti është kompetent si organ shtetëror i këshillave popullorë të rretheve dhe këshillave popullorë të qyteteve në territorin e vet, të cilat janë në shkallën e këshillave popullorë të rretheve.

Neni 16

Në raste të jashtëzakonshme, në territoret të cilat paraqesin sipërfaqe të gjerë nga ajo e një qarku, ndërsa përbëjnë një tërësi historike, ekonomike dhe kulturore, mund të formohet këshilli popullor krahinor.

Këshilli popullor krahinor drejtpërsëdrejti është kompetent, si organ i pushtetit shtetëror për këshillat popullorë të rrethit dhe këshillat popullorë të qytetit në territorin e vet, të cilët e kanë statusin e këshillit popullor të rrethit.

Neni 17

Fuzionimi, ndarja dhe suprimimi i njësisë administrative-territoriale, si dhe vendosja e kontesteve për kufijtë e tyre në kuadër të një republike popullore bëhet sipas dispozitave të ligjit të republikës.

.....

25 maj 1946, Beograd

Presidiumi i Kuvendit Popullor i Republikës Popullore
Federative të Jugosllavisë

Sekretari

Mile Perunçiq, d.v.

Kryetari

Dr. Ivan Ribar, d.v.

(ASHK, Službeni list FNRJ, nr. 43/28 maj 1946)

DOKUMENTI 7**Ligji për ndryshimin e ligjit për rregullimin dhe formimin e
Krahinës Autonome të Kosovë dhe Metohisë**

Neni 1

Në nenin 1 të Ligjit për themelimin dhe rregullimin e Krahinës Autonome të Kosovës dhe Metohisë, fjalia e fundit ndryshohet dhe shkruhet: “**Selia e Krahinës asht në Prishtinë**”.

Neni 2

Ky Ligj hyn në fuqi kur të publikohet në “Gazetën zyrtare të Republikës Popullore të Serbisë”.

Presidiumi i Kuvendit Popullor i Republikës Popullore të Serbisë.

Në Beograd, 27 shtator 1946.

Nr. 1157.

Sekretari

Dr. Mil. Vlajković, d.v.

Nënkryetari

Radovan Grujić, d.v.

(ASHK, Službeni glasnik NRS, br. 46/28.09.1946)

DOKUMENTI 8

Me Kushtetutën e RP të Serbisë prej 17 janarit 1947, territori i RP të Serbisë është ndarë në 6 krahina dhe Krahinën Autonome të Vojvodinës e KA të Kosovës dhe Metohisë.

Ligji për ndarjen administrative-territoriale të Republikës së Serbisë

Neni 1

Njësitë administrative-territoriale në territorin e Republikës së Serbisë janë: rrethet, qytetet, rajonet e qyteteve dhe territoret e këshillave popullorë të vendeve ose vendbanimet urbane.

Çdo pjesë e territorit të Republikës Popullore të Serbisë është në përbërjen territoriale-administrative të një qyteti, rajoni të qytetit ose territorit të këshillit popullor të vendit a të vendbanimit urban.

Neni 2

Kryeqyteti i Republikës Popullore të Serbisë është Beogradi në të cilin janë selitë e organeve më të larta të pushtetit shtetëror dhe të administratës shtetërore të Republikës Popullore të Serbisë.

Selia e organeve më të larta të pushtetit shtetëror dhe e organeve të administratës shtetërore të Krahinës Autonome të Vojvodinës është Novi Sadi.

Selia e organeve më të larta të pushtetit shtetëror dhe e organeve të administratës shtetërore të Krahinës Autonome të Kosovës dhe Metohisë është Prishtina.

Neni 3

Rrethi përfshin disa territore të këshillave popullorë të vendeve, të cilat paraqesin ndërlydhjet e tërësisë natyrore dhe ekonomike dhe kanë interesa të përbashkëta ekonomike, kulturore dhe administrative.

Neni 4

Qyteti është vendi i cili me numër të banorëve dhe me strukturë të zhvilluar ekonomike, me rëndësi të madhe ekonomike dhe kulturore ndahet nga vendet e tjera.

Territori i qytetit nuk hyn në përbërjen administrative-territoriale të rrethit.

Neni 5

Rajoni i qytetit është njësi administrative-territoriale në territorin e qytetit të madh dhe krijohet me qëllim të realizimit të pjesëmarrjes sa më të madhe të qytetarëve në organet përfaqësuese të pushtetit shtetëror ose të veçorive të tjera ekonomike, kulturore, sociale dhe të tjera të asaj pjese të territorit të qytetit.

Presidiumi i Kuvendit Popullor i Republikës Popullore të Serbisë përcakton se cilat qytete i kanë rajonet e qyteteve, numrin e tyre dhe territorin.

Neni 6

Territorin e këshillit popullor të vendit si njësi administrative-territoriale e përbëjnë një ose më shumë vendbanime (fshatra, qytete ose qyteza apo vendbanimet e punëtorëve dhe të tjera). Dy ose më shumë vendbanime hyjnë në përbërje të një njësie administrative-territoriale, nëse secila veç e veç nuk kanë kushte për jetën e veçantë administrative, ekonomike dhe kulturore.

Neni 7

Kufijtë e territoreve të qyteteve dhe të këshillave popullorë të vendeve përcaktohen me kufijtë e vendbanimeve nga përbërja e tyre. Kufijtë e rretheve janë përcaktuar me kufijtë e territoreve të këshillave popullorë të vendeve nga përbërja e tyre.

NJËSITË ADMINISTRATIVE-TERRITORIALE

Neni 10

Në territorin e Krahinës Autonome të Kosovës dhe Metohisë përcaktohen këto rrethe dhe territore të këshillave popullorë të vendeve:

1. **Vushtrrisë**, me seli të Këshillit Popullor të Rrethit në Vushtri, i cili përfshin këta këshilla popullorë të vendeve:

<i>Nr.r.</i>	KPV	Selia	Vendet (qytezat, fshatrat, lagjet, e punëtorëve dhe vendbanimet e tjera) në përbërje të KPV-së
1.	Babimoc	Babimoc	Babimoc ⁵⁶ , Barilevë, Breznicë, Drenoc.
2.	Vushtri	Vushtri	Vushtri
3.	Gojbulë	Gojbulë	Gojbulë, Studime e Poshtme, Karaçë, Miraçë, Novosellë e Begut, Shlivovicë.
4.	Rashan i Poshtëm	Rashan i Poshtëm	Rashan i Epërm, Rashan i Poshtëm, Tërstenë.
5.	Stanovc i Poshtëm	Stanovc i Poshtëm	Velikarekë, Stanovc i Epërm, Gracë, Stanovc i Poshtëm.
6.	Dërvar	Dërvar	Dervar, Reznik, Shalle.
7.	Dumnicë e Llugave	Dumnicë e Llugave	Dumnicë e Epërme, Dumnicë e Poshtme, Zagori dhe Dumnicë e Llugave.
8.	Novolan	Novolan	Brusnik, Bukosh, Vërnice, Kollë, Novolan, Taraxhë.
9.	Nedakoc	Nedakoc	Svaraçak i Epërm, Svaraçak i Poshtëm, Mavriq, Nedakoc, Pestovë.
10.	Novosellë ⁵⁷	Novosellë	Vilanc, Novosellë, Ropicë. Samadrexhë.
11.	Pantinë	Pantinë	Balincë, Dolak, Jezerë ⁵⁸ , Akrahticë, Ashlan, Pantinë, Shitaricë, Pirç.
12.	Prilluzhë	Prilluzhë	Beçuk, Bivolak, Gllavatin, Mihaliq, Prilluzhë, Strofc.

⁵⁶ Në dokument – Babin Most.

⁵⁷ Në popull është quajtur Novosella e Maxhunit, ndërsa sot Maxhunaj.

⁵⁸ Sot nga popullata shqiptare quhet me emrin Liqe.

13.	Skromë	Skromë	Boshlan, Vesekovc, Gumnishtë, Kurillovë, Skromë.
14.	Sibovc	Sibovc	Zhilivodë, Plemetin, Sibovc, Hamidi.
15.	Smrekonicë	Smrekonicë	Banjë, Kçiq i Madh, Dobërllukë, Pasomë, Sllatinë, Smrekonicë, Tarllabuq.
16.	Ceceli	Ceceli	Studime e Epërme, Kunovik, Skoçnë, Sllakovc, Ceceli.

2. **Gjilanit**, me seli të Këshillit Popullor të Rrethit në Gjilan, i cili përfshin këto territore të këshillave popullore të vendeve:

Nr.r.	KPV	Selia	Vendet (qytezat, fshatrat, lagjet, lagjet e punëtorëve dhe vendbanimet e tjera) në përbërje të KPV-së
1.	Beguncë	Beguncë	Beguncë, Buzovik, Debelde ⁵⁹ , Lubizhdë.
2.	Bostan	Bostan	Bostan, Makresh i Epërm, Makresh i Poshtëm, Dragancë, Jasenovik, Kllobukar, Novobërdë, Tërniçevc.
3.	Bresallc	Bresallc	Bresallc, Ponesh, Strazhë.
4.	Viti	Viti	Viti, Drobesh, Ramnishtë.
5.	Llashticë	Llashticë	Burincë, Llashticë, Lipovicë, Muçibabë.
6.	Vërboc	Vërboc	Vërboc, Gërçar, Mogillë, Podgorc.
7.	Gjilan	Gjilan	Gjilan
8.	Sllakoci i Epërm	Sllakoci i Epërm	Gadish, Sllakoc i Epërm, Sllakoc i Poshtëm, Kishnapolë.
9.	Zhegër	Zhegër	Lladovë, Zhegër, Nasalë.
10.	Kabash	Kabash	Binçë, Kabash, Smirë.
11.	Letnicë	Letnicë	Vërnez, Vërnakollë, Stubllë e Epërme, Letnicë, Shashar.
12.	Malishevë	Malishevë	Bukovik, Malishevë, Capar, Shillovë.
13.	Parallovë	Parallovë	Vërbicë ⁶⁰ , Zhegoc, Parallovë.
14.	Partesh	Partesh	Budrigë e Poshtëm, Livoq i Poshtëm, Partesh.
15.	Pasjan	Pasjan	Velekincë, Pasjan, Uglar.

⁵⁹ Vendbanimet janë regjistruar ashtu siç shqiptohen nga popullata vendore shqiptare e jo siç është në dokumente.

⁶⁰ Në popull quhet Vërbica e Zhegovcit, meqë në komunën e Gjilanit gjendet edhe vendbanimi Vërbica e Kmetocit.

16.	Pograxhë	Pograxhë	Bilinicë, Inatovc, Llovcë, Maxherë ⁶¹ , Pograxhë, Ranatovc ⁶² , Sllubicë, Stublinë.
17.	Pozharan	Pozharan	Ramjan i Epërm, Ramjan i Poshtëm, Tërpezë e Vogël, Pozharan, Çiflluk.
18.	Prekoc	Prekoc	Zebincë, Izvor, Manishincë, Prekoc.
19.	Prilepnicë	Prilepnicë	Vërbicë, Kmetoc, Mozgovë, Prilepnicë.
20.	Radivojc	Radivojc	Budrigë e Epërme, Devajë, Kllokot, Radivojc.
21.	Stanishor	Stanishor	Kufcë e Epërme, Koretishtë, Pasjak, Stanishor.
22.	Tërpezë	Tërpezë	Ballancë, Zhiti, Tërpezë.
23.	Gjelekare	Gjelekare	Goden, Stubëll e Poshtme, Remnik, Gjelekare.
24.	Cërnice	Cërnice	Vrapçiq, Gumnishtë, Livoq i Epërm, Kravaricë, Cërnice.
25.	Shurdhan	Shurdhan	Dunav, Pidiq, Stançiq, Çelik, Shurdhan.

3. **Gorës**, me seli të Këshillit popullor të Rrethit në Dragash, i cili përfshin këto këshilla popullorë të vendeve:

<i>Nr.r.</i>	<i>KPV</i>	<i>Selia</i>	<i>Vendet (qytezat, fshatrat, lagjet, lagjet e punëtorëve dhe vendbanimet e tjera) në përbërje të KPV-së</i>
1.	Bellobradë	Bellobradë	Bellobradë, Breznë, Buçe, Brrut, Zym, Kosovë, Kapër, Pllavë, Pllajnik, Rrenc.
2.	Brodosanë	Brodosanë	Blaç, Brodosanë, Buzez, Zapluxhe, Zgatar, Kuklibeg, Kuk.
3.	Brod	Brod	Brod
4.	Vranishtë	Vranishtë	Baçkë, Vranishtë, Dikanc, Kukolan, Mlikë, Orçushë.
5.	Dragash	Dragash	Dragash, Xërxë, Kërstec, Leshtan, Lubovishtë, Radeshë, Rapçë, Shajne.
6.	Krushevë	Krushevë	Gllloboçicë, Zlipotok, Krushevë, Restelicë.

⁶¹ Sot vendbanim në territorin e Serbisë.

⁶² E njëjtë.

4. **Graçanicës**, me seli të Këshillit Popullor të Rrethit në Prishtinë, i cili përfshin këta këshilla popullore të vendit:

<i>Nr.r.</i>	<i>KPV</i>	<i>Selia</i>	<i>Vendet (qytezat, fshatrat, lagjet, lagjet e punëtorëve dhe vendbanimet e tjera) në përbërje të KPV-së</i>
1.	Besi	Besi	Besi, Vranidoll, Leban, Prugoc, Rimanishtë.
2.	Graçanicë	Graçanicë	Ajvali, Badovc, Graçanicë, Zllatar, Matičan, Novosellë ⁶³ , Sushicë
3.	Nëntë Jugoviq	Nëntë Jugoviq	Bërrnicë e Epërme, Nëntë Jugoviq, Bërrnicë e Poshtme, Siçevë, Trudë.
4.	Dobrevë ⁶⁴ e Poshtme	Dobrevë e Poshtme	Harilaq, Sllatinë e Madhe, Vragoli, Dobrevë e Poshtme, Sllatinë e Vogël.
5.	Kaçikollë	Kaçikollë	Kaçikollë, Prapashticë.
6.	Komarar	Komarar	Berishë, Zabel i Posht., Fushticë e Ep., Zabel i Ep., Fushticë e Posht., Domanek, Kishnarekë, Komarar, Mirenë, Nekoc, Stankoc, Shtrubullojë.
7.	Fushë-Kosovë	Fushë-Kosovë	Bresje, Bellaqevc ⁶⁵ i M., Graboc ⁶⁶ , Dobrevë ⁶⁷ e Ep., Dobërdup ⁶⁸ , Fushë-Kosovë, Kuzmin, Bellaqevc i Vogël, Nakaradë, Pomozotin, Uglar.
8.	Llappllasellë	Llappllasellë	Llappllasellë, Preoc, Çagllavicë.
9.	Llukar	Llukar	Butovc, Grashticë, Kolovicë, Llukar, Makoc, Radashec, Sofali, Ugr ⁶⁹ .
10.	Marec	Marec	Marec
11.	Milloshëvë	Milloshëvë	Bakshi, Llazarevë, Milloshevë, Raskovë.
12.	Obiliq	Obiliq	Hade, Graboc i Vushtrrisë ⁷⁰ , Janinovodë ⁷¹ , Krushevç ⁷² ,

⁶³ Sot ky vendbanim nuk ekziston. Lokaliteti i tij është mbuluar me liqenin e Badovcit.

⁶⁴ Në popull sot quhet me emrin Miradi e Poshtme.

⁶⁵ Nga banorët vendorë quhet me emrin Bardh.

⁶⁶ Ka të bëjë me vendbanimin Grabovc i Poshtëm në komunën e Fushë-Kosovës.

⁶⁷ Në popull quhet me emrin Miradi e Epërme.

⁶⁸ Në popull quhet me emrin Lismir.

⁶⁹ Sot lagje e fshatit Grashticë.

			Leskovçiq, Mazgit, Obiliq, Orllloviq ⁷³ , Minjerë e Kosovës, Minjera Krushevc ⁷⁴ , Cerkvonavodicë ⁷⁵ , Shipitullë.
13.	Slivovë	Slivovë	Busi, Dragancë, Kukavicë, Llabjan, Mramor, Slivovë.

5. **Drenicës**, me seli të Këshillit Popullor të Rrethit në Sërbicë, i cili përfshin territorin e këtyre këshillave popullorë të vendeve:

<i>Nr.r.</i>	<i>KPV</i>	<i>Selia</i>	<i>Vendet (qytezat, fshatrat, lagjet, lagjet e punëtorëve dhe vendbanimet e tjera) në përbërje të KPV-së</i>
1.	Banjë	Banjë	Banjë, Padalishtë, Suhogërlle ⁷⁶ , Dren, Çitak.
2.	Gllanasellë	Gllanasellë	Gllanasellë, Gradicë, Godanc, Dobrashec.
3.	Glllogoc ⁷⁷	Glllogoc	Bajincë, Glllobar, Glllogoc, Krajkovë, Çikatovë.
4.	Klinë e Epërme	Klinë e Epërme	Klinë e Epërme, Kotor, Kuçicë, Klinë e Mesme, Tërnavc.
5.	Abri e Epërme	Abri e Epërme	Vuçak, Abri e Epërme, Abri e Poshtme, Murgë, Terdec.
6.	Dubovc	Dubovc	Beçiq, Galicë, Dubovc, Krasaliq, Lubovec, Mikushnicë, Prelloc.
7.	Kllodërnice	Kllodërnice	Belicë, Vitak, Izbicë, Kllodërnice.
8.	Llaushë	Llaushë	Llaushë, Rakinicë, Çubrel.
9.	Poklek	Poklek	Vasilevë, Korroticë e Epërme, Korroticë e Poshtme, Poklek.
10.	Polac	Polac	Krushec, Marinë, Polac, Rezallë.
11.	Runik	Runik	Kosterc, Leçinë, Radishevë, Runik.
12.	Sërbicë	Sërbicë	Prekaz i Epërm, Klinë e Poshtme, Prekaz i Poshtëm, Sërbicë ⁷⁸ .
13.	Ticë	Ticë	Likoshan, Açarevë, Plluzhinë, Ticë.

⁷⁰ Sot Grabovci i Epërm në komunën e Obiliqit.

⁷¹ Sot lagje e fshatit Carnavodicë, që quhet nga popullata vendore Palaj.

⁷² Sot në popull quhet me emrin Dardhishtë.

⁷³ Tani nga popullata vendore quhet me emrin Shkabaj.

⁷⁴ Sot është lagje dhe i takon vendbanimit Dardhishtë (Kryshevc).

⁷⁵ Sot në popull quhet me emrin Palaj.

⁷⁶ Në popull quhet Syrigonë.

⁷⁷ Në dhjetë vjetët e fundit quhet me emrin Drenas.

⁷⁸ Sot qendra komunale Skënderaj.

14.	Tërstenik	Tërstenik	Tërstenik, Polluzhë, Vërbovc, Makërma.
15.	Turiçec	Turiçec	Brojë, Vojnik, Kopiliq i Epërm, Kopiliq i Poshtëm, Turiçec, Tushilë.
16.	Çirez	Çirez	Baks, Dashec, Kozhicë, Krasmiroc, Likoshan, Çirez, Shtuticë.

6. **Gjakovës**, me seli të Këshillit Popullor të Rrethit në Gjakovë, i cili përfshin këta këshilla popullore të vendit:

<i>Nr.r.</i>	<i>KPV</i>	<i>Selia</i>	<i>Vendet (qytezat, fshatrat, lagjet, lagjet e punëtorëve dhe vendbanimet e tjera) në përbërje të KPV-së</i>
1.	Botushë	Botushë	Botushë, Brovinë, Dobrosh, Koshare, Molliq, Nivelokaz, Pacaj.
2.	Bec	Bec	Bec, Bërdosan, Vraniq, Doblbare, Zhdrellë, Janosh, Kodrali, Lugbunar, Marmullë, Meqë, Netec ⁷⁹ , Rashkoc, Rrezinë, Qerim, Cërmjan.
3.	Brekoc	Brekoc	Brekoc, Vogovë, Guskë, Devë, Zhub, Zylfaj, Jahoc, Korenicë, Madanaj, Mejë, Moglicë, Orize, Ramoc, Raçë, Rrypaj, Firzë.
4.	Grmaçel	Grmaçel	Baballoq, Glllogjan, Grmaçel, Dobrukhë, Dubravë, Hereq, Rastavicë, Shaptej.
5.	Gërgoc	Gërgoc	Gërgoc, Zhabel, Jabllanicë, Kralan, Llugaxhi, Maznik, Radoniq ⁸⁰ , Rakovinë, Rakoc.
6.	Deçan	Deçan	Beleg, Llukë e Epërme., Carabreg i Epërm, Deçan, Carabreg i Poshtëm.
7.	Drenoc	Drenoc	Voksh, Drenoc, Lloçan, Pobërxhë, Prilep, Sllup.
8.	Gjakovë	Gjakovë	Gjakovë, Zidi i Sadik Agës ⁸¹ .
9.	Junik	Junik	Gjocaj, Jasiq, Junik.
10.	Ponoshec	Ponoshec	Babaj Bokës, Berjah, Nec i Ep.,

⁷⁹ Sot lagje e fshatit Rashkoc.

⁸⁰ Sot i pabanuar. Në lokalitetin e tij është ngritur Liqeni i Radoniqit.

⁸¹ Sot lagje e Gjakovës.

			Nec i P., Duzhnje, Morinë, Ponoshec, Popoc, Potok ⁸² , Smolicë, Stubëll, Shishman i Bokës, Shishman i Rrafshit.
11.	Irzniq	Irzniq	Ratish i Ep., Dashinoc, Llukë e P., Ratish i Poshtëm, Kodrali, Lumbardh, Vranoc i Vogël, Pozhar, Prekollukë, Irzniq.
12.	Rogovë	Rogovë	Damjan, Kushnin, Rogovë.
13.	Skivjan	Skivjan	Novosella e Ep., Dallashaj, Novosellë e P., Dujakë, Osek Pashë, Osek Hylë, Palabardh, Plançor, Rracaj, Skivjan, Trakaniq, Sheremetaj.
14.	Smaq	Smaq	Bishtazhin, Goden, Gërçinë, Dol, Kusar, Kushavec, Lipovec, Pjetërshan, Smaq, Ujëz.

7. **Zveçanit**, me seli të Këshillit Popullor të Rrethit në Mitrovicë, i cili përfshin territorin e këtyre këshillave popullorë të vendeve:

<i>Nr.r.</i>	<i>KPV</i>	<i>Selia</i>	<i>Vendet (qytezat, fshatrat, lagjet, lagjet e punëtorëve dhe vendbanimet e tjera) në përbërje të KPV-së</i>
1.	Banjskë	Banjskë	Banjskë, Banjska Rekë, Suhadoll i Banjës, Bresnicë, Vallq, Villishtë, Vojmislq, Jankov Potok, Joshevik, Kamenicë, Kozarevë, Lipovicë, Llozishhtë, Llokvë, Llovac, Mekindoll, Rahovicë, Rudinë.
2.	Bare	Bare	Bajgorë, Bare, Vidishiq, Kaçanoll, Kovaçicë, Rzhanë.
3.	Bërrnjak	Bërrnjak	Babiq, Banjë, Bërrnjak, Vukojeviq, Dragalicë, Okllacë, Presekë.
4.	Vllahi	Vllahi	Batahir, Bistricë, Vllahi, Dedi, Zhazhë, Zabërxhë, Zijaqë, Koshutovë, Maxherë, Ovçar, Cerajë.
5.	Zveçan	Zveçan	Banovdoll, Boletin, Vidomiriq, Grabovc, Gushavc, Dolan, Vinarc i P., Zherovnicë, Zhitkovc, Zveçan, Korile, Lipë, Maticë, Rudar, Sendoll, Sërbovec ⁸³ , Suhadoll.

⁸² Sot lagje e fshatit Molliq.

⁸³ Më parë është quajtur me emrin Bugariq.

6.	Zubin Potok	Zubin Potok	Velibreg, Kalludra e Madhe, Gazivodë, Dobroshevinë, Jasenovik i Poshtëm, Zagul, Zubin Potok, Jabukë, Kobillagllavë, Padinë, Prevllakë, Pridvoricë, Uglar, Crepulë, Qiflluk.
7.	Leposaviq	Leposaviq	Vitanoviqi, Kërnini i Epërm, Gnjezdani, Desetak, Dren, Dubokë, Zabrgjë, Zërnosek, Joshanicë, Kajkovë, Kijevçi, Koporiqi, Kostin Potok, Krusheve, Krushçicë, Kutinje, Leposaviq, Majdevë, Mekindoll, Mioliqi, Pllakaonicë, Popovce, Rodel, Tvrđjen, Triskose, Ulije.
8.	Tunel i Parë	Tunel i Parë	Zasellë, Kutlloc, Lisicë, Kçiq i Vogël, Rahovë, Tunel i Parë, Rekë, Shupkoc.
9.	Rezallë	Rezallë	Babudevicë, Bojnoviq, Bube, Vukosavljeviqi, Jasenoviku i E., Drainoviqi, Zagraxhë, Zeqevi, Kijevci, Kovaqë, Kopiloviqë, Lluçka Rekë, Mexheqi Potok, Rançiq, Rezalla, Rovce, Tushiq, Çeshanovi, Çeqevë.
10.	Sllatinë	Sllatinë	Borçan, Berzance, Vuçë, Graniçan, Gërkaje, Dobravë, Zavrata, Jellakce, Kamenicë, Llazinë, Llozno, Moshnicë, Pridvoricë, Rumance, Seoce, Sllatinë, Soçanicë, Stërshin, Cërveni.
11.	Stantërg	Stantërg	Mazhiq, Melenicë, Stantërg, Stantërg (fshati), Strana.
12.	Çabër	Çabër	Varagë, Vinarc i Ep., Stërme i Ep., Zupçë, Jagnjenicë, Prelez, Rujishtë, Çabër.
13.	Shipol	Shipol	Broboniq, Vaganicë, Vërbnicë, Zhabar i Ep., Zhabar i Poshtëm, Koprivë, Koshutovë, Kërligatë, Lushtë, Svinjar ⁸⁴ , Shipol.

⁸⁴ Sot në popull quhet me emrin Frashër.

8. **Istogut**, me seli të Këshillit Popullor të Vendit në Gjurakovc⁸⁵, i cili përfshin territorin e këshillave popullorë të vendit:

<i>Nr.r.</i>	<i>KPV</i>	<i>Selia</i>	<i>Vendet (qytezat, fshatrat, lagjet, lagjet e punëtorëve dhe vendbanimet e tjera) në përbërje të KPV-së</i>
1.	Banjë	Banjë	Banjë, Banjicë, Kashicë, Lubovë, Dubovë e Vogël, Orobërdë, Carrallukë.
2.	Vrellë	Vrellë	Vrellë, Kamenicë ⁸⁶ , Prigodë, Studenicë.
3.	Dobushë	Dobushë	Dobrushë, Pre kallë, Starodran.
4.	Dubravë	Dubravë	Dubravë, Bellopojë, Veriq, Dragolec i Epërm, Dragolec i Poshtëm, Gusar, Dubravë, Mojstir, Sine.
5.	Gjurakovc	Gjurakovc	Llukavc i Begut, Gjurakovc, Kovragë, Llukavci i Thatë, Tomoc.
6.	Zallq	Zallq	Drejë, Zallq, Rudicë, Turbuhoc.
7.	Zllokuqan	Zllokuqan	Berkovë, Zllokuqan, Potoçan, Radullovc, Ranoc.
8.	Istog	Istog	Istog, Llugë, Lubozhdë, Muzhevinë, Cërcë.
9.	Jashanicë	Jashanicë	Dush, Jelloc, Jashanicë, Pograxhë, Reznik, Siçevë.
10.	Klinë	Klinë	Gjurgjevik, Klinë, Klinavc, Krushevë.
11.	Jabllanicë e Vogël	Jabllanicë e Vogël	Jabllanicë e Madhe, Kaliçan, Jabllanicë e Vogël, Radavc.
12.	Osojan	Osojan	Kosh, Veriq i Ri, Oprashkë ⁸⁷ , Osojan, Polanë, Tuçep, Shalinovicë.
13.	Rakosh	Rakosh	Zhakovë, Kërninë, Rakosh, Stropac ⁸⁸ , Sushicë.
14.	Cërkolez	Cërkolez	Suhogërlle, Uçë, Cërkolez, Dren.
15.	Shtupel	Shtupel	Binxhë ⁸⁹ , Grabc, Kërmicë, Shtupel.

⁸⁵ Në popull quhet me emrin Gurrakoc.

⁸⁶ Sot është lagje e fshatit Studenicë.

⁸⁷ Sot është lagje e fshatit Kosh.

⁸⁸ Sot lagje e pabanuar e fshatit Zhakovë që është mjaft larg qendrës së fshatit, në pjesën malore.

⁸⁹ Në dokument – Biç.

9. **Kamenicës**, me seli të Këshillit Popullor të Rrethit në Kamenicë, i cili përfshin territorin e këshillave popullorë të vendeve:

<i>Nr.r.</i>	<i>KPV</i>	<i>Selia</i>	<i>Vendet (qytezat, fshatrat, lagjet, lagjet e punëtorëve dhe vendbanimet e tjera) në përbërje të KPV-së).</i>
1.	Hajkobillë	Hajkobillë	Hajkobillë, Dabishec, Zajçevc.
2.	Hajnovc	Hajnovc	Hajnovc, Bratilloç, Bushincë, Kostadincë, Meshinë, Tirincë, Firiquejë.
3.	Ropotovë e Madhe	Ropotovë e Madhe	Bozhevc, Ropotovë e Madhe, Drenovc, Ropotovë e Vogël, Hodec, Rajnovc.
4.	Shipashnicë e Ep.	Shipashnicë e Ep.	Shipashnicë e Epërme, Kranidell, Sedllar.
5.	Kormjan i Poshtëm	Kormjan i Poshtëm	Kormjan i Poshtëm, Kormjan i Epërm, Domoroc.
6.	Shipashnicë e P.	Shipashnicë e P.	Dajkoc, Shipashnicë e Poshtme, Kollollec, Muçivrc, Çarakovc.
7.	Zarbincë	Zarbincë	Zarbincë, Pribovc ⁹⁰ .
8.	Kamenicë	Kamenicë	Berivojc, Bosce, Grizimë, Kamenicë, Moçar, Strellicë.
9.	Koretin	Koretin	Bllatë, Koretin, Topanicë.
10.	Krilevë	Krilevë	Glllogovicë, Krilevë.
11.	Lisockë	Lisockë	Gjurishec, Lisockë, Zhujë, Shahiq.
12.	Hogosht	Hogosht	Dazhdincë, Hogosht, Kopërnice.
13.	Poliçkë	Poliçkë	Velegllavë, Vriçec, Desivojc, Lajiq, Marocë, Poliçkë, Tërstenë.
14.	Ranillug	Ranillug	Glllogoc, Dobërçan, Paçellë, Petrovc, Ranillug, Tomancë.
15.	Rubovc	Rubovc	Busovatë, Gogullovc, Miganovc, Rubovc.
16.	Rogoçicë	Rogoçicë	Karaçevë e Epërme, Karaçevë e Poshtme, Novosellë, Hodanoc, Rogoçicë.
17.	Strezovc	Strezovc	Bolevc, Vaganesh, Gragjenik, Kremenatë, Leshtar, Rahovicë, Strezovc, Carevc.
18.	Tugjevc	Tugjevc	Gmicë, Cvircë, Tugjevc.

⁹⁰ Këto dy vendbanime sot në territorin e Serbisë, komuna e Bujanovcit.

10. **Llapit**, me seli të Këshillit Popullor të Rrethit në Podujevë, i cili përfshin territoret e këshillave popullorë të vendeve:

<i>Nr.r.</i>	<i>KPV</i>	<i>Selia</i>	<i>Vendet (qytezat, fshatrat, lagjet, lagjet e punëtorëve dhe vendbanimet e tjera) në përbërje të KPV-së</i>
1.	Halabak	Halabak	Halabak, Bellopojë, Tërrnavë, Sharban.
2.	Bajçinë	Bajçinë	Bajçinë, Dobërdol, Dobratin.
3.	Ballaban	Ballaban	Ballaban, Barainë, Koliq.
4.	Batllavë	Batllavë	Batllavë, Gërdoc, Dyz, Kaçibeg, Radujevc ⁹¹ .
5.	Brainë	Brainë	Brainë, Bërvenik, Kalaticë, Nishevc.
6.	Gllamnik	Gllamnik	Burincë, Gllamnik, Sibovc i Epërm, Sibovc i Poshtëm, Konushevc, Penuhë.
7.	Llapashtcë e Ep.	Llapashtcë e Ep.	Llapashticë e Epërme, Llapashticë e Poshtme, Popovë.
8.	Dumnicë e Poshtme	Dumnicë e Poshtme	Dumnicë e Epërme, Dumnicë e Poshtme, Llaushë, Përpellac.
9.	Lupç i Poshtëm	Lupç i Poshtëm	Lupç i Epërm, Lupç i Poshtëm, Majanc, Teneshdoll.
10.	Kërpimeh	Kërpimeh	Zakut, Kërpimeh, Metehi, Pakashticë, Revuçë, Repë.
11.	Lluzhan	Lluzhan	Godishnjak, Sollobajë, Llugë, Lluzhan, Shakovicë.
12.	Orllan	Orllan	Bllatë, Kushevicë, Muhazob, Metërgoc, Orllan, Rakinicë, Turuçicë.
13.	Peran	Peran	Bradash, Velikarekë, Letanc, Obranxhë, Peran.
14.	Pollatë	Pollatë	Brecë, Dvorishtë, Zhiti, Murgullë, Pollatë, Potok, Reçicë, Sylevicë, Sllatinë, Tërrnavicë.
15.	Podujevë	Podujevë	Podujevë
16.	Sveçël	Sveçël	Dumosh, Ladovc, Sveçël, Surkish.
17.	Shajkovc	Shajkovc	Surdull, Hërrticë, Shajkovc.
18.	Shtedim	Shtedim	Ballovc, Livadicë, Merdar, Mirovc, Shtedim.

⁹¹ Është krijuar si koloni sllave në vitin 1920 ndërmjet fshatrave Batllavë dhe Dumosh.

11. **Nerodimes**, me seli të Këshillit Popullor të Rrethit në Ferizaj, i cili përfshinë këto territore të këshillave popullorë të rretheve:

<i>Nr.r.</i>	<i>KPV</i>	<i>Selia</i>	<i>Vendet (qytezat, fshatrat, lagjet, lagjet e punëtorëve dhe vendbanimet e tjera) në përbërje të KPV-ë.</i>
1.	Gaçkë	Gaçkë	Banjicë, Burnik, Gaçkë, Greme, Izhancë, Semajë.
2.	Nerodime e Epërme	Nerodime e Epërme	Balaj, Bozhoviq ⁹² , Nerodime e Epërme, Nerodime e Poshtme, Dërmjak, Jezerc, Muhaxher ⁹³ , Stojkoviç ⁹⁴ .
3.	Gushicë	Gushicë	Vërban, Gërmovë, Gushicë, Sadovinë e Jerlive, Smirë.
4.	Doganaj	Doganaj	Bush, Vatë, Gabricë, Gërlicë, Doganaj, Dubravë, Duraj, Elezaj, Kamenicë, Rakë, Rekë, Sllatinë, Sopotincë.
5.	Drajkovc	Drajkovc	Brod, Viçë, Gotovushë, Drajkovc, Kashtanjevë, Firajë.
6.	Han i Elezit	Han i Elezit	Balazh ⁹⁵ , Bacbrav ⁹⁶ , Vërtomicë, Gorancë, Bush i Epërm, ⁹⁷ Bush i Poshtëm, Dremjak, Dimcë, Han i Elezit, Krivenik, Miliq, Neçavc, Paldonicë, Pustenik, Rezhancë, Seçishtë, Hasallar, Hunel.
7.	Zaskok	Zaskok	Varosh, Doganaj, Zaskok, Manastirc, Nikodin, Pleshinë.
8.	Ivajë	Ivajë	Glloboçicë, Dragomac ⁹⁸ , Çair, Ivajë, Kotlinë, Strazhë.
9.	Kaçanik	Kaçanik	Agjani ⁹⁹ , Bob, Biçec, Bunjak ¹⁰⁰ , Drenogllavë, Gjurgjedel, Zubertaq,

⁹² Dikur lagje e fshatit Nerodime.

⁹³ Sot lagje e fshatit Dërmjak.

⁹⁴ Lagje e fshatit Nerodime.

⁹⁵ Lagje e Pustenikut.

⁹⁶ E njëjtë.

⁹⁷ Lagje e fshatit Pustenik.

⁹⁸ Lagje e fshatit Glloboçicë.

⁹⁹ Sot lagje e Gjurgjedellit, Llanishtës dhe Kaçanikut.

¹⁰⁰ Sot lagje e fshatit Biçec.

			Kaçanik, Kovaçec, Korbliç, Kosharishtë, Llanishtë, Mijak Bela ¹⁰¹ , Mjak, Nikaj, Nikovc, Lumi Dardhishtë ¹⁰² , Reç, Runjevë, Çaka Kuka. ¹⁰³
10.	Kosin	Kosin	Publicë ¹⁰⁴ , Kosinë, Koshare, Llashkobare, Prelez, Slivovë, Tërn.
11.	Kaçanik i Vjetër	Kaçanik i Vjetër	Begracë, Krivanjevë, Kuçishtë ¹⁰⁵ , Reç, Stagovë, Kaçanik i Vjetër, Teneçe ¹⁰⁶ , Topojan ¹⁰⁷ , Tren-Luzhë ¹⁰⁸ , Harun ¹⁰⁹ .
12.	Talinovc	Talinovc	Bibaj, Gërbol ¹¹⁰ , Talinovc i Jerlive, Muhovc, Papaz, Pojatishtë, Rahovicë, Retkocer, Sazli, Softoviq, Sojevë, Starasellë ¹¹¹ , Talinovc.
13.	Tankosiq ¹¹²	Tankosiq	Zllatar, Mirosal, Tankosiq.
14.	Ferizaj	Ferizaj	Ferizaj.
15.	Sadovinë e Çerkezëve	Sadovinë e Çerkezëve	Sllatinë e Ep., Sllatinë e P., Komogllavë, Tërstenik, Sadovinë e Çerkezëve.
16.	Shtërrpc	Shtërrpc	Berovce, Vërbeshticë, Biti e Ep., Biti e P., Jazhincë, Sevcë, Sushicë, Shtërrpcë.

¹⁰¹ Sot lagje e Gjurgjedellit dhe e Kaçanikut.

¹⁰² Dardhishta, lagje e fshatit Korbliç.

¹⁰³ Lagje e fshatit Bob.

¹⁰⁴ Sot lagje e fshatit Lloshkobare.

¹⁰⁵ Sot lagje e fshatit Begracë.

¹⁰⁶ Sot lagje e fshatit Stagovë.

¹⁰⁷ Lagje e fshatit Kaçanik i Vjetër.

¹⁰⁸ Sot lagje të fshatit Begracë.

¹⁰⁹ E njëjtë.

¹¹⁰ Sot lagje e fshatit Rahovicë.

¹¹¹ Nga populli quhet me emrin Fshati i Vjetër.

¹¹² Është formuar si koloni sllave pas vitit 1919 dhe pushteti e pagëzoi në bazë të biemrit të një udhëheqësi famkeq serb nga Lufta e Parë Botërore, Voja Tankosiq.

12. **Pejës**, me seli të Këshillit Popullor të Rrethit në Pejë, i cili përfshin territorin e këshillave popullorë të vendeve:

<i>Nr.r.</i>	<i>KPV</i>	<i>Selia</i>	<i>Vendet (qytezat, fshatrat, lagjet, lagjet e punëtorëve dhe vendbanimet e tjera) në përbërje të KPV-së.</i>
1.	Brestovik	Brestovik	Brestovik, Letinë ¹¹³ , Lipë, Lëvoshë, Cigë, Maja e Zezë ¹¹⁴ .
2.	Vide	Vide	Vide, Jagodë, Krushevë, Novosellë e Dejës, Novosellë e Zajmit.
3.	Glllogjan	Glllogjan	Glllogjan, Kosuriq, Kpuz, Lugaxhi, Nepolë, Çeskovë.
4.	Gorazhdec	Gorazhdec	Bërzhënik, Gorazhdec, Grabovc, Llozhan, Orashje ¹¹⁵ .
5.	Vitomiricë e Ep.	Vitomiricë e Ep.	Burnut ¹¹⁶ , Vitomiricë e Epërme, Dubovë, Novosellë, Ozrim.
6.	Strelcë i Epërm	Strelcë i Epërm	Beleja, Strelcë i Epërm, Strelcë i Poshtëm, Isniq, Lëbushë.
7.	Baran i Poshtëm	Baran i Poshtëm	Buçan, Vranoc, Baran i Ep., Baran i P., Kotradiq, Rosujë, Turjakë, Çellopek.
8.	Drelaj	Drelaj	Reka e Allagës, Bellopaq, Bogë, Shtupeq i Madh, Drelaj, Dugajevë, Jashanicë, Hani i Jusufit ¹¹⁷ , Llaz, Koshutan, Kuçishtë, Lutovë, Malaj, Shtupeq i Vogël, Pepiq, Haxhaj, Shkrel.
9.	Drenoc	Drenoc	Bokshiq, Pjetërq i Epërm, Grabanicë, Dollovë, Pjetërq i Poshtëm, Drenoc, Dugajevë, Miliceviq ¹¹⁸ .
10.	Zahaq	Zahaq	Bllagajë, Zahaq, Llabjan, Pavlan, Ramun, Çyshk.
11.	Kryshec	Kryshec	Broliq, Dubovik, Kryshec, Papiq, Prapaçan, Rashiq.
12.	Leshan	Leshan	Gllaviçicë, Jabllanicë, Kliçinë, Leshan, Sferkë ¹¹⁹ .

¹¹³ Sot lagje e fshatit Maja e Zezë.

¹¹⁴ Në dokument Černi Vrh.

¹¹⁵ Sot administrativisht lagje e fshatit Bërzhënik.

¹¹⁶ Sot lagje e fshatit Novosellë që tani në popull quhet Fierzë.

¹¹⁷ Sot lagje në fshatin Shtupeq i Madh.

¹¹⁸ Lagje e fshatit Drenoc.

¹¹⁹ Në popull quhet Sferka e Thatë.

13.	Poçestë	Poçestë	Babiq, Vragoc, Dobërdol, Kërstec, Millovanc, Pishtan, Poçestë.
14.	Raushiq	Raushiq	Bellopojë, Zagërme, Zlllopek, Loxhë, Lubeniç, Murinë, Raushiq.
15.	Stup	Stup	Budisalc, Lutogllavë, Naglavkë, Osojë, Ruhot, Stup, Tërstenik.
16.	Treboviç	Treboviç	Vitimoricë e Poshtme, Nabërxfan, Katunii Pashës, Treboviç.

13. Podrimës, me seli të Këshillit Popullor të Rrethit në Rahovec, i cili përfshin këto territore të këshillave popullorë të vendit:

<i>Nr.r.</i>	<i>KPV</i>	<i>Selia</i>	<i>Vendet (qytezat, fshatrat, lagjet, lagjet e punëtorëve dhe vendbanimet e tjera) në përbërje të KPV-së</i>
1.	Banjë	Banjë	Banjë, Bellanicë, Gajrak, Ldroviç, Senik.
2.	Bellacërkë	Bellacërkë	Bellacërkë, Bërnjaq, Gexhë, Potoçan i Poshtëm, Xërxë, Sopniç.
3.	Hoçë e Madhe	Hoçë e Madhe	Brestovc, Hoçë e Madhe, Hoçë e Vogël, Nagavc.
4.	Dollc	Dollc	Gremnik, Dollc, Dërsnik, Gjurgjevik, Çupevë.
5.	Ujëmir	Ujëmir	Ujëmir, Dobërdol, Zabërzhë, Gllarevë, Cerovik, Çabiq.
6.	Dragobil	Dragobil	Guriç, Dragobil, Lubizhdë, Malishevë, Mirushë, Marali, Pagarushë.
7.	Drenovc	Drenovc	Bratotin, Bërnjak, Drenovc, Potoçan të Epërm, Zatriç, Nushpal, Polluzhë, Pastasel, Sanovc.
8.	Kijevë	Kijevë	Bubavec, Gullboc, Kijevë, Llazicë, Mleçan, Plloçicë.
9.	Apterushë	Apterushë	Zoçishtë, Apterushë, Reti.
10.	Rahovec	Rahovec	Rahovec
11.	Arllat	Arllat	Balincë, Arllat, Llapushnik, Negroc, Tërpezë.
12.	Astrazub	Astrazub	Jançishtë, Joviç ¹²⁰ , Maxharë, Millanoviç ¹²¹ , Astrazub, Turjak, Caravranë.

¹²⁰ Në popull sot quhet me emrin Burim.

¹²¹ Në popull sot quhet me emrin Shkozë.

13.	Petkoviq	Petkoviq	Koznik, Kranovik, Llapçevë, Mrasor, Petkoviq, Ponorc, Rud, Çifllak.
14.	Ratkoc	Ratkoc	Denjë, Dobërdol, Ratkoc, Radostë.
15.	Svërkë	Svërkë	Bubël, Volljak, Dush, Përçevë, Svërkë.
16.	Carallukë	Carallukë	Drenovc i Madh ¹²² , Vërmicë, Damanek, Shkarashnik.

14. **Sitnicës**, me seli të Këshillit Popullor të Rrethit në Lipjan, i cili përfshin këshillat popullorë të vendeve:

<i>Nr.r.</i>	<i>KPV</i>	<i>Selia</i>	<i>Vendet (qytezat, fshatrat, lagjet, lagjet e punëtorëve dhe vendbanimet e tjera) në përbërje të KPV-së</i>
1.	Babush	Babush	Bablak, Babush i Serbëve, Mirash, Prelez i Muhaxhirëve, Rubovc, Surçinë, Cërnillë.
2.	Gadime e Poshtme	Gadime e Poshtme	Gadime e Epërme, Gadime e Poshtme, Llugaxhi, Marevc, Babush i Muhaxhirëve.
3.	Gushtericë e Epërme	Gushtericë e Epërme	Gushtericë e Epërme, Dobratin, Gushtericë e Poshtme, Livaxhë, Akllap, Plitkoviq, Sillovi, Smallushë.
4.	Janjevë	Janjevë	Honroc, Bogacinci, Brus, Bukovicë, Janjevë, Oksiq ¹²³ , Shisharë, Teqe, Shashkoc.
5.	Lipjan	Lipjan	Banullë, Gllogoc, Gumnasellë, Konjskë, Konjuh, Lipjan, Hallaq i Vogë, Rufc i Ri, Rufc i Vjetër, Suhadoll.
6.	Magure	Magure	Dobrajë e Madhe, Vrellë, Vërshevc, Leletiq, Magure, Dobrajë e Vogël, Medvec, Poturovc, Torinë, Qylagë.
7.	Muzeqinë	Muzeqinë	Vojnoc, Davidovc, Gjirkovc, Muzeqinë, Rashincë.
8.	Radevë	Radevë	Batusë, Henc, Lepi, Llugë, Radevë, Skullan.
9.	Sedllar	Sedllar	Baincë, Divjakë, Kleçkë, Karaçicë,

¹²² Fjala është për vendbanimin Llashkadrenoc.

¹²³ Fjala është për fshatin Okosnicë.

			Krojmirovç, Pjetreshticë, Rusinovç, Sedllar ¹²⁴ .
10.	Grackë e Vjetër	Grackë e Vjetër	Bujan, Varigoc, Hallaç i Madh, Ribar i Madh, Zllokuçan, Kraishtë, Grackë e Vogël, Ribar i Vogël, Grackë e Vjetër, Topliçan.
11.	Shtime	Shtime	Belincë, Godanc i Ep., Godanc i P., Zborc, Mollopoc, Petrovë, Rancë, Raçak, Topillë, Bregu i Zi, Caralevë, Shtime.

15. **Suharekës**, me seli të Këshillit Popullor të Rrethit në Suharekë, i cili përfshin këto territore të këshillave popullorë të vendeve:

<i>Nr.r.</i>	<i>KPV</i>	<i>Selia</i>	<i>Vendet (qytezat, fshatrat, lagjet, lagjet e punëtorëve dhe vendbanimet e tjera) në përbërje të KPV-së</i>
1.	Bukosh	Bukosh	Budakovë, Bukosh, Vraniq, Krushicë, Movlan, Papaz, Popovlan.
2.	Dule	Dule	Bllacë, Vershevc, Greiçevc, Guncat, Dragaçinë, Dule, Javor, Lladrovic, Jançishtë, Lluzhnicë, Stravuçinë, Tumeçinë, Çadraq.
3.	Mamushë	Mamushë	Mamushë, Medvec.
4.	Mushtisht	Mushtisht	Dvoran, Dellovç, Maçitevë, Mushtisht.
5.	Semetisht	Semetisht	Kosterc, Kravasari, Nishor, Semetisht.
6.	Sopi	Sopi	Grejkoc, Dubravë, Gjinoc, Savrovë, Sellograzhdë, Sopi.
7.	Studençan	Studençan	Dobërdolan, Kosançiq ¹²⁵ , Njëpërbishtë, Samadrexhë, Studençan, Tërnje.
8.	Suharekë	Suharekë	Leshan, Peçan, Rashtan, Reçan, Sllapuzhan, Suharekë, Shirokë.

16. **Sharrit**, me seli të Këshillit Popullor të Rrethit në Prizren, i cili përfshin territoret e këshillave popullorë të vendeve:

<i>Nr.r.</i>	<i>KPV</i>	<i>Selia</i>	<i>Vendet (qytezat, fshatrat, lagjet, lagjet e punëtorëve dhe vendbanimet e tjera) në përbërje të KPV-së</i>
1.	Krushë e Madhe	Krushë e Madhe	Krushë e Madhe, Krushë e Vogël, Randobravë, Celinë.
2.	Sërbicë e	Sërbicë e	Velezhë, Gilanc, Sërbicë e

¹²⁴ Në popull quhet me emrin Shalë.

¹²⁵ Sot lagje e fshatit Studençan. Është krijuar si koloni sllave në vitin 1934.

	Epërme	Epërme	Epërme, Sërbicë e Poshtme, Zojz, Novak, Piranë, Smaç, Trepetnicë, Caparc, Shpinadi.
3.	Dushanovë ¹²⁶	Dushanovë	Atmaxhë, Grazhdanik, Dushanovë, Landovicë, Nashec, Petrovosellë, Tupec.
4.	Zhur	Zhur	Vllashnje, Vërrnicë, Dobrushtë, Zhur, Kobajë, Shkozë.
5.	Zym	Zym	Dedaj, Gjonaj, Zym, Kabash, Krajk, Luki, Karashëngjergj, Lubizhdë, Romajë.
6.	Lubizhdë	Lubizhdë	Vërbiçan, Gërçar, Dojnicë, Kabash, Korishë, Lubizhdë, Lutogllavë, Novosellë, Skorobisht.
7.	Plane	Plane	Gorozhup, Kojushë, Mazrek, Milaj, Plane.
8.	Reçan	Reçan	Zhivinjan, Jabllanicë, Llokvicë, Manastirc, Nebregoshte, Reçan, Struzhje.
9.	Sreckë	Sreckë	Lubinje e Ep., Gornjesello, Lubinje e P., Drajçiq, Mushnikovë, Pllanjan, Sreckë.
10.	Hoçë e Qytetit	Hoçë e Qytetit	Bilushë, Jeshkovë, Kushnin, Leskovec, Lez, Lybiçevë, Poslishtë, Hoçë e Qytetit.

Neni 11

Qytetet në Republikën Popullore të Serbisë janë:

.....

3. Në territorin e Krahinës Autonome të Kosovës dhe Metohisë: Prishtina, Mitrovica, Peja dhe Prizreni.

.....

Nr. 1090, në Beograd, 18 prill 1947.

Kryesia e Presidiumit të Kuvendit të Republikës Popullore të Serbisë.

(ASHK, Službeni glasnik N.R. Srbije br. 17/24 prill 1947)

¹²⁶ Sot është lagje e Prizrenit. Është krijua si koloni sllave prej vitit 1928. Sot në popull quhet me emrin Arbanë.

DOKUMENTI 9

Vendimi kushtetues i Kuvendit të Republikës së Serbisë për shpalljen e kushtetutës së Republikës së Serbisë

Kuvendi kushtetues i Republikës Popullore të Serbisë, si përfaqësues i suverenitetit të popujve të Republikës Popullore të Serbisë dhe shprehje e dëshirës unanime të popujve të Republikës Popullore të Serbisë

VENDOS

Që Kushtetuta e Republikës Popullore e Serbisë, e miratuar nga ky Kuvend, e shpall dhe e publikuar për qytetarët e Republikës Popullore të Serbisë:

PJESA E PARË

PARIMET THEMELORE

KAPITULLI I PARË

Republika Popullore e Serbisë

Neni 1

Republika Popullore e Serbisë është shtet popullor i formës republikane.

....

Neni 3

Republika Popullore e Serbisë përfshin territoret:

1. E qarqeve të tanishme: Beogradit, Vranjës, Valevës, Kragujevcit, Krushevcit, Leskovcit, Moravës, Novi Pazarit, Nishit, Pirotit, Podrimës, Pozharevcit, Timokut, Toplicës, Uzhicës, Koçanit dhe qytetit të Beogradit;
2. E Krahinës Autonome të Kosovës dhe Metohisë dhe
3. E Krahinës Autonome të Vojvodinës.

.....

Neni 13

Krahina Autonome e Vojvodinës dhe Krahina Autonome e Kosovës dhe Metohisë i kanë të drejtat autonome të siguruara me Kushtetutën e Republikës Popullore të Serbisë në harmoni me Kushtetutën e Republikës Federative Popullore të Jugosllavisë.

Krahina Autonome e Vojvodinës dhe Krahina Autonome e Kosovës dhe Metohisë i miratojnë vetë statutet e veta dhe ia dërgojnë për miratim Kuvendit të Republikës Popullore të Serbisë.

Neni 14

Pakicat nacionale në Republikën Popullore të Serbisë i gëzojnë të drejtat dhe mbrojtjen e zhvillimit të vet kulturor dhe përdorimit të lirë të gjuhëve të veta.

.....

Neni 46

Në kompetencë të Republikës Popullore të Serbisë, në nivelin e organeve më të larta të pushtetit shtetëror dhe administratës shtetërore bëjnë pjesë:

1. Prurja, ndryshimi dhe plotësimi i Kushtetutës së Republikës së Serbisë dhe kujdesi për ekzekutimin e tyre;
2. Vendosja për ndërprerjen dhe plotësimin e kufijve të Republikës Popullore të Serbisë.
3. Vërtetimi i statuteve të njësive autonome,
4. Përcaktimi i kufijve të njësive autonome,

5. Vërtetimi i ndryshimit të kufijve të rretheve dhe qyteteve të Krahinës Autonome të Vojvodinës dhe Krahinës Autonome të Kosovës dhe Metohisë,
6. Ndarja administrative-territoriale e Republikës Popullore të Serbisë.

.....

KREU I DHJETË

Organet e pushtetit shtetëror të Krahinës Autonome të Kosovës dhe Metohisë

Neni 106

Krahina Autonome e Kosovës dhe Metohisë në frymën e organeve të pushtetit shtetëror dhe administratës shtetërore kryen të drejta autonome, të cilat iu janë dhënë në kompetenca të kësaj Kushtetute.

Duke i realizuar kompetencat e veta, Krahina Autonome e Kosovës dhe Metohisë udhëheq ekonominë dhe ndërtimin kulturor të Krahinës; e miraton planin ekonomik dhe buxhetin e Krahinës; siguron zbatimin e ligjeve dhe bën ruajtjen e të drejtave të qytetarëve; mbron barazinë dhe të drejtat kulturore të nacionaliteteve në Krahinën Autonome të Kosovës dhe Metohisë; udhëheq shkollat fillore dhe të mesme në kuadër të planit arsimor të RPS-së; udhëheq punët e kujdesit social; udhëheq shërbimin e mbrojtjes e shëndetit popullor; realizon udhëheqjen në të gjitha punët të cilat barten me ligjet dhe dispozitat e përgjithshme të RFPJ-së dhe RPS-së në kompetenca të Krahinës Autonome të Kosovës dhe Metohisë.

Neni 107

Organi më i lartë i pushtetit shtetëror i Krahinës Autonome të Kosovës dhe Metohisë është Këshilli Popullor i Krahinës Popullore të Kosovës dhe Metohisë.

Këshilli Popullor Krahinor i Krahinës Autonome të Kosovës është kompetent për:

1. Miratimin, ndryshimet dhe plotësimet e Statutit të Krahinës Autonome të Kosovës dhe të Metohisë, me vërtetim të

- Kuvendit Popullor të RPS-së, Zgjedhjen dhe revokimin e Këshillit Popullor Krahinor ose të anëtarëve të caktuar,
2. Miratimin e buxhetit dhe planit ekonomik të Krahinës,
 3. Miratimin e dispozitave të përgjithshme krahinore – vendimeve,
 4. Përcaktimin e taksave krahinore në kuadër të ligjeve,
 5. Ndryshimin e kufijve të rretheve, qyteteve dhe këshillave të caktuar popullorë të vendit, me vërtetim të Presidiumit të Kuvendit Popullor të RPS-së.

Neni 108

Këshilli Popullor Krahinor i KAKM zgjidhet për tri vjet.

Me statutin e KAKM përcaktohet se në numrin e banorëve do të zgjidhet një këshilltar i KAKM-së.

Neni 109

Këshilli Popullor Krahinor i Krahinës Autonome të Kosovës dhe Metohisë i realizon të drejtat e tij dhe merr vendime në bazë të Kushtetutës së RPS-së, dispozitave federative, ligjeve të RPS-së dhe Statutit të Krahinës Autonome, në harmoni me Kushtetutën e RFPJ-së.

.....

Neni 115

Statuti dhe vendimet krahinore të KAKM publikohen në Gazetën zyrtare të KAKM-së në gjuhën serbe dhe gjuhën shqipe me nënshkrim të kryetarit dhe sekretarit të Këshillit Ekzekutiv Krahinor të KAKM-së.

Neni 116

Organ ekzekutiv dhe administrativ i Këshillit Popullor Krahinor është Këshilli Ekzekutiv Krahinor.

Këshillin Ekzekutiv Krahinor e zgjedh dhe e revokon Kuvendi i Këshillit Popullor i KAKM-së.

Këshilli Ekzekutiv Krahinor i përgjigjet Këshillit Popullor Krahinor dhe atij i paraqet llogari për punën e tij.

.....

Në Beograd, Kryqytetin e Republikës Popullore të Serbisë, më 17 janar 1947.

Presidiumi i Kuvendit Kushtetues i Republikës Popullore të Serbisë.

Sekretarët:

Dr. Millorad Vlajković, d.v.

Xhavit Nimani, d.v.

Nënkryetarët:

Millan Smilaniq, d.v.

Aleksandër Sheviq, d.v.

Radovan Grujiq, d.v.

Kryetari

Dr. Sinisha Stanković, d.v.

(ASHK, Službeni glasnik Narodne Republike Srbije, nr. 3, 22 januar 1947)

DOKUMENTI 10**Ligji
për shpalljen e Prishtinës, Pejës dhe
Mitrovicës për qytete**

Neni 1

Prishtina, Peja dhe Mitrovica shpallen qytete dhe këshillat popullore të tyre e kanë shkallën e këshillave popullore të rretheve.

Neni 2

Ky Ligj hyn në fuqi në ditën e shpalljes në “Gazetën zyrtare të Republikës Popullore të Serbisë”.

Nr. 379

Në Beograd, më 22 shkurt 1947

Presidiumi i Kuvendit Popullor i Republikës Popullore të Serbisë.

Sekretari

Dr. Millorad Vllajković, d.v.

Kryetari

Dr. Sinisha Stanković, d.v.

(ASHK, Službeni glasnik N.R. Srbije, br. 9, 26 februar 1947).

DOKUMENTI 11

Në bazë të nenit 4, pika 24, në lidhje me nenin 7 të Ligjit për Presidiumin e Kuvendit Popullor të Republikës Popullore të Serbisë dhe nenit 13 të Ligjit për ndarjen administrative-territoriale të Republikës Popullore të Serbisë, Presidiumi i Kuvendit Popullor i Republikës së Serbisë ka miratuar:

VENDIMIN

Që të vërtetohet vendimi i Këshillit Popullor Krahinor i Krahinës Autonome të Kosovës dhe Metohisë të miratuar më datën 23 dhe 24 maj 1949, nën nr. 39190, me të cilën:

Fshati Ponorc në Rrethin e Podrimës ndahet nga territori i KPV-së së Sferkës i të njëjtit rreth;

Fshati Damanek në Rrethin e Podrimës ndahet nga territori i KPV-së së Carallukës dhe i bashkëngjitet KPV-së së Sferkës, i të njëjtit rreth;

Fshati Potoçan i Poshtëm në Rrethin e Podrimës ndahet nga territori i Bellacërkës dhe i bashkëngjitet territorit të KPV-së të Drenovcit, i të njëjtit rreth;

Fshati Balincë dhe lagja Suhapole në Rrethin e Podrimës ndahet nga territori i KPV-së të Arllatit dhe i bashkëngjitet territorit të KPV-së të Carallukës, i të njëjtit rreth;

Fshati Lladroviq ndahet nga territori i KPV-së të Duljes të Rrethit të Suharekës dhe i bashkëngjitet territorit të KPV-së Banjë, i rrethit të Podrimës;

Fshati Shtuoce në Rrethin e Zveçanit ndahet nga territori i KPV të Zubin Potokut dhe i bashkëngjitet territorit të KPV-së së Rezallës, i rrethit të njëjtë;

Fshati Sefali në Rrethin e Graçanicës ndahet nga KPV e Llukarit dhe i bashkëngjitet territorit të KPQ-së në Prishtinë;

Fshatrat Damanek dhe Shtrubullojë ndahen nga territori i KPV-së në Komaran, Rrethi i Graçanicës dhe i bashkëngjitet KPV-së në Glllogovc, Rrethi i Drenicës;

Fshatrat Korratica e Epërme dhe Korratica e Poshtme në Rrethin e Drenicës ndahen nga territori i KPV-së në Poklek, Rrethi i Drenicës dhe i bashkëngjitet territorit të KPV-së në Komaran, Rrethi i Graçanicës;

Fshati Kukulan në Rrethin e Gorës ndahet nga territori i KPV Vranishte dhe i bashkëngjitet territorit të KPV në Dragash, i njëjtit rreth;

Lagja Gërlica e fshatit Varosh në Rrethin e Nerodimës ndahet nga territori i KPV-së në Zaskok dhe i bashkëngjitet KPV-së në Dragash, i të njëjtit rreth;

Fshati Lubozhdë në Rrethin e Istogut ndahet nga territori i KPV-së në Istog dhe i bashkëngjitet territorit të KPV-së në Vrellë, i të njëjtit rreth;

Fshati Lëvoshë në Rrethin e Pejës ndahet nga territori i KPV-së në Brestovik dhe i bashkëngjitet Këshillit Popullor të Qytetit të Pejës;

Lagja Godeni i Vogël e fshatit Goden në Rrethin e Gjilanit ndahet nga përbërja e territorit të KPV-së në Gjylekare dhe i bashkëngjitet territorit të KPV-së në Shurdhan, i të njëjtit rreth;

Fshati Çikatovë ndahet nga territori i KPV-së në Glllogovc, Rrethi i Drenicës dhe i bashkëngjitet KPV-së në Glllanasellë, i të njëjtit rreth.

Presidiumi i Kuvendit Popullor i Republikës Popullore të Serbisë.

Nr. 6836

Në Beograd, 28 gusht 1948

Sekretari

Dr. Millorad Vllajkoviç, d.v.

Nënkryetari

Aleksandër Sheviç, d.v.

(ASHK, Službeni glasnik N.R. Srbije, nr. 41/ 4 septembar 1948)

DOKUMENTI 12

Statuti i Krahinës Autonome i Kosovës e Metohisë në Republikën Popullore të Serbisë

Kreu i parë

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Krahina Autonome e Kosovës dhe Metohisë është krahinë autonome në kuadër të Republikës së Serbisë.

Neni 2

Me qëllim të realizimit të parimeve të bashkëpunimit vëllazëror ndërmjet kombësive, të cilët jetojnë në Kosovë dhe Metohi dhe të drejtat e pakicave kombëtare të përcaktuara me Kushtetutën e Republikës Federative Popullore të Jugosllavisë dhe Kushtetutës së Republikës Popullore të Serbisë, Krahina Autonome e Kosovës e Metohisë gëzon, në pajtim me shprehjen e lirë të dëshirës së popujve, të drejta të veçanta autonome të përcaktuara me këtë statut.

Të drejtat autonome të Krahinës Autonome të Kosovës dhe Metohisë sigurohen me Kushtetutën e Republikës Popullore të Serbisë, në harmoni me Kushtetutën e Republikës Federative Popullore të Jugosllavisë.

Neni 3

Të gjitha kombësitë në Krahinën Autonome të Kosovës e Metohisë janë të barabarta.

Gjuha serbe dhe shqipe janë të barabarta në përdorim në të gjitha shërbimet shtetërore në Krahinën Autonome të Kosovës e Metohisë.

Procedura para gjykatave udhëhiqet në gjuhën serbe, përkatësisht gjuhën shqipe.

Neni 4

Krahina Autonome e Kosovës e Metohisë përfshin territoret e rretheve të tanishme: Vushtrrisë, Gjakovës, Gjilanit, Gorës, Graçanicës, Drenicës, Zveçanit, Istogut, Kamenicës, Llapit, Nerodimës, Pejës, Podrimës, Sitnicës, Suharekës dhe Sharrit.

1. Qytetet e tanishme: Mitrovica, Prizreni, Peja dhe Prishtina.

Neni 5

Selia e organeve më të larta të pushtetit shtetërore dhe e administratës shtetërore e Krahinës Autonome të Kosovës e Metohisë është Prishtina.

.....

Prishtinë, 23 maj 1948.

KËSHILLI POPULLOR I KRAHINËS AUTONOME I KOSOVËS E METOHISË

Sekretari

Pavle Joviçević, d.v.

Kryetari

Fadil Hoxha, d.v.

(ASHK, Službeni glasnik N.R. Srbije, nr. 54, 27 nëntor 1948)

DOKUMENTI 13

Në bazë të nenit 4, pika 24 e Ligjit për Presidiumin e Kuvendit Popullor të Republikës Popullore të Serbisë, neni 13, 14 dhe 15, të Ligjit për ndarjen administrative-territoriale të Republikës Popullore të Serbisë, Presidiumi i Kuvendit Popullor i Republikës Popullore të Serbisë ka miratuar:

Dekretin për ndryshimet administrative-territoriale

a. Në territorin e Krahinës Autonome të Kosovës dhe Metohisë:

Rrethi i Graçanicës

1. Suprimohet Këshilli Popullor i Vendit në Dobrevë të Poshtme. Nga përbërja e Këshillit Popullor të vendit të suprimuar Dobrevë e Poshtme, fshatrat Vragoli, Dobrevë e Epërme dhe Dobrevë e Poshtme hyjnë në përbërje të Këshillit Popullor të Vendit në Fushë-Kosovë.

2. Formohet Këshilli i ri Popullor i Vendit i quajtur Këshilli Popullor i Vendit në Sllatinë të Madhe, me seli të Këshillit Popullor të Vendit në Sllatinë të Madhe. Në përbërje të këtij Këshilli Popullor të Vendit hyjnë fshatrat: Harilaq, Sllatinë e Madhe dhe Sllatinë e Vogël – nga përbërja e Këshillit Popullor të Vendit në Miradi të Poshtme, fshati Bellaqevci i Madh – nga përbërja e Këshillit Popullor të Vendit të Fushë-Kosovës dhe fshati Henc – nga përbërja e Këshillit Popullor të Vendit në Radevë – Rrethi i Sitnicës.

3. Formohet Këshilli i ri Popullor i Vendit me emrin Këshilli Popullor i Vendit në Bellaqevc të Madh, me seli të Këshillit Popullor të Vendit në Bellaqevc të Madh. Në përbërje të këtij Këshilli Popullor të Vendit hyjnë fshatrat Bellaqevci i Madh, Grabovci dhe Pomozotini – nga përbërja e Këshillit Popullor të Vendit në Fushë-Kosovë dhe Shipitullë – nga përbërja e Këshillit Popullor të Vendit në Obiliq.

Rrethi i Drenicës

4. Suprimohet Këshilli Popullor i Vendit në Poklek. Nga përbërja e fshatrave Këshillit Popullor të Vendit të suprimuar në Poklek i bashkohet fshati Poklek i territorit të Këshillit Popullor të Vendit në Glllogoc, ndërsa fshati Vasilevë i territorit të Këshillit Popullor të Vendit në Gllanasellë.

Rrethi i Nerodimës

5. Formohet Këshilli Popullor i ri i Vendit me emrin Fshati i Vjetër, me seli të Këshillit Popullor të Vendit në Fshat të Ri. Në përbërje të Këshillit Popullor të Vendit hyjnë fshatrat Biba, Sojeva dhe Fshati i Vjetër – nga përbërja e Këshillit Popullor të Vendit Talinoc, fshati Komogllavë – nga përbërja e Këshillit Popullor të Vendit në Zaskok.

Rrethi i Podrimës

6. Nga përbërja e Këshillit Popullor të Drenocit ndahet fshati Poklek dhe hyn në përbërje të Këshillit Popullor të Vendit në Petkoviç.

7. Selia e Këshillit Popullor të Vendit në Petkoviç transferohet nga fshati Petkoviç në Polluzhë dhe emri i Këshillit Popullor të Vendit Petkoviç ndryshohet në Këshilli Popullor i Vendit në Polluzhë.

8. Selia e Këshillit Popullor të Vendit në Dragobil transferohet nga fshati Dragobil në Malishevë dhe emri i Këshillit Popullor të Vendit në Dragobil ndryshohet në Këshilli Popullor i Vendit në Malishevë.

9. Selia e Këshillit Popullor i Vendit në Apterushë – transferohet nga Apterusha në Zoqishtë dhe emri i Këshillit Popullor të Vendit në Apterushë ndryshohet në Këshill Popullor të Vendit në Zoqishtë.

....

Nr. 166, Beograd, 7 janar 1949

Presidiumi i Kuvendit Popullor i Republikës Popullore të Serbisë.

(ASHK, Službeni glasnik NRS, nr. 2, 15 januar 1949)

DOKUMENTI 14

DEKRET

Në bazë të nenit 74, pika 3 e Kushtetutës së Republikës Popullore të Serbisë dhe nenit 4, pika 5 e Ligjit për Presidiumin e Kuvendit Popullor të Republikës Popullore të Serbisë shpallet Ligji për plotësimet dhe ndryshimet e Ligjit për ndarjen administrative-territoriale të Republikës Popullore të Serbisë, të cilin e ka votuar Kuvendi Popullor i Republikës Popullore të Serbisë në mbledhjen e mbajtur më 18 shkurt 1949, që shkruhet:

Ligji për ndryshimet dhe plotësimet e ligjit për ndarjen administrative- territoriale të Republikës së Serbisë

....

Neni 6

Neni 10 i Ligjit për ndarjen administrative-territoriale të Republikës së Serbisë ndryshohet dhe plotësohet me:

1. Në pikën 9: ndahet nga përbërja e Rrethit të Kamenicës territori i këshillit popullor të vendit Zarbincë dhe përfshihet në përbërje të Rrethit të Bujanovcit.

2. Në pikën 13: ndahet nga përbërja e Rrethit të Podrimës territori i këshillit popullor të Dollcit dhe përfshihet në përbërje të Rrethit të Istogut.

....

Nr. 1652

Në Beograd, më 1 mars 1949

PRESIDIUMI I KUVENDIT POPULLOR I
REPUBLIKËS POPULLORE TË SERBISË

Sekretari

Dr. Millorad Vllajković, d.v.

Nënkryetari

Aleksandër Sheviq, d.v.

(ASHK, Službeni glasnik N.R. Srbije, nr. 11/7 mart 1949)

DOKUMENTI 15

Në bazë të nenit 4 të Ligjit për Presidiumin e Kuvendit Popullor të Republikës Popullore të Serbisë, neni 13, 14 dhe 15 i Ligjit për ndarjen administrative-territoriale të Republikës Popullore të Serbisë dhe neni 12 dhe 107 të Ligjit të përgjithshëm për Këshillat Popullorë, Presidiumi i Kuvendit Popullor i Republikës Popullore të Serbisë miraton:

Dekretin për ndryshimet administrative territoriale në territorin e Republikës Popullore të Serbisë

1. NË ASPEKTIN E TERRITOREVE, EMRAVE DHE SELIVE
TË KËSHILLAVE POPULLORË TË VENDEVE

....

B. NË TERRITORIN E KRAHINËS AUTONOME TË KOSOVËS DHE METOHISË

1. Rrethi i Gorës

Vendbanimet Kosava dhe Pllajnik ndahen nga përbërja e KPV-së Bellobradë dhe i bashkëngjiten përbërjes së KPV-së në Brodosanë;

Vendbanimi Zgatar ndahet nga përbërja e KPV-së Brodosanë dhe bashkëngjitet në përbërje të KPV-së në Bellobradë.

2. Rrethi i Graçanicës

Vendbanimi Siçevë ndahet nga përbërja e KPV-së të Nëntë Jugoviqve dhe i bashkëngjitet KPV-së në Llukar;

Vendbanimi Kuzmin ndahet nga përbërja e KPV-së në Fushë-Kosovë dhe i bashkëngjitet KPV-së në Bellaqevc të Madh;

Vendbanimi Mirenë ndahet nga përbërja e KPV-së në Komaran dhe i bashkëngjitet KPV-së në Magure, rrethi i Sitnicës;

Vendbanimet Vragoli, Dobrevë e Epërme dhe Dobrevë e Poshtme ndahen nga përbërja e KPV-së në Fushë-Kosovë dhe për to formohet këshilli popullor i veçantë me emër Dobrevë e Poshtme me seli të Këshillit Popullor të vendit në Dobrevë të Poshtme;

Vendbanimet Hade, Leshkoshiq, Minjera Kosova, Janinovoda dhe Cërkvenavodica ndahen nga përbërja e KPV-së në Obiliq dhe për to formohet këshilli popullor i veçantë i vendit me emrin Minjera e Kosovës me seli në Minjerën e Kosovës;

Vendbanimet Busi dhe Mramor ndahen nga KPV në Slivovë dhe për to formohet këshilli i vendit i veçantë me emër Mramor me seli në Mramor;

3. Rrethi i Drenicës

Vendbanimet Mikushnicë dhe Lubovec ndahen nga përbërja e KPV-së Dubovc, ndërsa Prekazi i Epërm nga përbërja e KPV-së në Sërbicë dhe për ato formohet këshilli popullor i veçantë me emër Prekazi i Epër me seli në Prekaz të Epërm;

Vendbanimet Rezallë nga përbërja e KPV-së në Polac dhe Likoc nga përbërja e KPV-së Tica dhe Tushila nga përbërja e KPV-së në Turiçec ndahen dhe për to formohet këshill popullor i veçantë me emër KPV në Rezallë me seli në Rezallë;

Vendbanimet Brojë dhe Vojnik ndahen nga përbërja e KPV-së në Turiçec dhe për to formohet këshill popullor i veçantë i vendit me emër Vojnik me seli në Vojnik;

Suprimohet KPV në Dubovc dhe vendbanimet nga përbërja e tij i bashkëngjiten: Beçiqi, Krasaliqi dhe Prelloci në përbërje të KPV-së në Qirez, ndërsa Dubovci dhe Galica në përbërje të KPV-së Novolan, rrethi i Vushtrrisë;

Vendbanimet Dashec dhe Shtuticë ndahen nga KPV në Qirez dhe ato i bashkëngjiten: Dashecit në përbërje të KPV-së në Polac, ndërsa Shtutica në përbërje të KPV-së në Tërstenik.

Emri i KPV-së në Ticë ndryshohet në KPV në Plluzhinë me seli të Këshillit Popullor të Vendit në Plluzhinë.

4. Rrethi i Zveçanit

Vendbanimi Kalludra e Madhe ndahet nga përbërja e KPV-së në Zubin Potok dhe i bashkëngjitet përbërjes së KPV-së në Rezallë;

Vendbanimi Kërlligatë ndahet nga përbërja e KPV-së në Shipol dhe i bashkëngjitet KPV-së në Klinë të Epërme, rrethi i Drenicës;

Vendbanimi Drajnoviqi ndahet nga përbërja e KPV-së Rezallë dhe i bashkëngjitet përbërjes së KPV-së në Rajetiç, rrethi i Dezhëvës;

Vendbanimet Babudovica, Bojnoviçi, Bube, Burllata, Vërba, Vukosavljeviçi, Zagragja, Zeçeviçi, Kijeviçi, Luçka Reka, Rançiçi dhe Qeshanoviçi ndahen nga përbërja e KPV-së Rezalla dhe për to formohet këshilli popullor i vendit i veçantë me emrin KPV në Lluçka Rekë, me seli në Lluçka Rekë.

5. Rrethi i Istogut

Vendbanimi Gjurgjevik ndahet nga përbërja e KPV-së në Dollc dhe i bashkëngjitet KPV-së në Joshanicë;

Vendbanimi Siçevë ndahet nga përbërja e KPV-së në Joshanicë dhe i bashkëngjitet përbërjes së KPV-së në Ujmir, rrethi i Anadrinisë (Podrimës).

6. Rrethi i Nerodimes

Vendbanimet Korbliç, Dardhishtë, Drenogllavë, Mjak dhe Nikovc ndahen nga përbërja e KPV të Kaçanikut dhe për to themelohet këshilli popullor i vendit i veçantë me emrin Korbliç, me seli në Korbliç.

7. Rrethi i Pejës

Vendbanimet Bogë, Dugojevë, Joshanicë, Koshutan, Kuçishtë, Haxhaj dhe Shkrel ndahen nga përbërja e KPV-së në Drelaj dhe për to formohet këshilli popullor i veçantë me emrin KPV Kuçishtë, me seli të këshillit në Kuçishtë.

8. Rrethi i Podrimës¹²⁷

Vendbanimet Guriç, Dragobil, Marali dhe Pagarushë ndahen nga përbërja e KPV të Malishevës dhe bashkëngjiten në përbërje të KPV-së në Astrazub;

¹²⁷ Fjala është për Anadrininë.

Vendbanimet Joviq, Turjak dhe Caravranë ndahen nga KPV në Astrazub dhe i bashkëngiten përbërjes së KPV-së në Malishevë.

9. Rrethi i Sitnicës

Selia e KPV-së në Gadime të Poshtme transferohet nga vendbanimi Gadime e Poshtme në vendbanimin Babushi i Muhaxhirëve;

Vendbanimet Glllogovc, Gumnasellë, Banullë dhe Konjuh ndahen nga përbërja e KPV-së në Lipjan dhe për to formohet këshilli popullor i vendit i veçantë me emrin KPV në Glllogovc, me seli të KPV-së në Glllogovc;

Vendbanimet Godonci i Epërm, Godonci i Poshtëm, Zborci dhe Bregu i Zi ndahen nga përbërja e KPV-së në Shtime dhe për to formohet këshill popullor i vendit i veçantë me emrin Godonci i Poshtëm me seli të Këshillit në Godanc të Poshtëm;

Vendbanimet Akllap, Plitkoviq, Sllovi dhe Smallushë ndahen nga përbërja e KPV-së në Gushtericë të Poshtme dhe për to formohet këshill popullor i vendit i veçantë me emrin KPV në Sllovi, me seli të këshillit në Sllovi.

10. Rrethi i Suharekës

Vendbanimi Vërshevc ndahet nga përbërja e KPV-së në Duhle dhe i bashkëngjitet përbërjes së KPV-së në Bukosh;

Vendbanimet Guncat dhe Tumeçinë ndahen nga përbërja e KPV-së në Dulje dhe së bashku me vendbanimin Bellanicë e Lladroviq nga KPV në Bonjë, Rrethit të Anadrinisë formohet këshill popullor i vendit i veçantë me emrin KPV në Bellanicë me seli në Bellanicë.

11. Rrethi i Sharrit

Vendbanimi Gilancë ndahet nga përbërja e KPV-së në Sërbicë të Poshtme dhe i bashkëngjitet përbërjes së KPV në Sopi, rrethi i Suharekës.

.....

II. SHPALLJA E VENDBANIMEVE PËR QYTETE NË
KUADËR TË RRETHEVE

....

**B. Në territorin e Krahinës Autonome të Kosovës dhe
Metohisë**

Vushtrri (rrethi i Vushtrrisë)

Gjilan (rrethi i Gjilanit)

Gjakovë (rrethi i Gjakovës)

Ferizaj (rrethi i Nerodimës).

.....

Nr. 5009, Beograd, 6 tetor 1949

Presidiumi i Kuvendit Popullor i Republikës Popullore të
Serbisë.

(ASHK, Službeni glasnik N.R. Srbije, nr. 44/12 tetor 1949)

DOKUMENTI 16

Në bazë të nenit 74, pika 3 e Kushtetutës së Republikës së Serbisë dhe nenit 4 të Ligjit për Presidiumin e Kuvendit Popullor të Republikës Popullore të Serbisë shpallet Ligji për ndarjen administrative-territoriale të Republikës Popullore të Serbisë, të cilin e ka votuar Kuvendi Popullor i Republikës Popullore të Serbisë në mbledhjen e mbajtur më 28 janar 1950 dhe e miraton

Ligjin për ndarjen administrative-territoriale të Republikës Popullore të Serbisë

Njësitë administrative-territoriale

Neni 1

Njësitë administrative-territoriale në Republikën Popullore të Serbisë janë: krahinat, rrethet, qytetet, rajonet e qyteteve, vendbanimet e qyteteve dhe vendet (territoret e këshillave popullore të vendeve).

Neni 2

Krahinat në territorin e Republikës Popullore të Serbisë janë:

- A. E Beogradit me seli të Këshillit Popullor Krahinor në Beograd,
- B. E Kragujevcit me seli të Këshillit Popullor Krahinor në Kragujevc,
- C. E Nishit me seli të Këshillit Popullor Krahinor në Nish,
- D. E Timokut me seli të Këshillit Popullor Krahinor në Zajeçar,
- E. E Titovo Uzhicës me seli të Këshillit Popullor Krahinor në Titovo Uzhicë.

Neni 3

Rrethet janë:

- I. Në territorin e Krahinës Autonome të Vojvodinës:
.....
- II. Në territorin e Krahinës Autonome të Kosovës dhe Metohisë:
 1. I Vushtrisë me seli të Këshillit Popullor të Rrethit në Vushtri,
 2. I Gjilanit me seli të Këshillit Popullor të Rrethit në Gjilan,
 3. I Moravës së Epërme me seli të Këshillit Popullor të Rrethit në Viti,
 4. I Gorës me seli të Këshillit Popullor të Rrethit në Dragash,
 5. I Graçanicës me seli të Këshillit Popullor të Rrethit në Prishtinë,
 6. I Drenicës me seli të Këshillit Popullor të Rrethit në Sërbicë,
 7. I Gjakovës me seli të Këshillit Popullor të Rrethit në Gjakovë,
 8. I Zveçanit me seli të Këshillit Popullor të Rrethit në Mitrovicë,
 9. I Istogut me seli të Këshillit Popullor të Rrethit në Gjurakoc,
 10. I Kamenicës me seli të Këshillit Popullor të Rrethit në Kamenicë,
 11. I Llapit me seli të Këshillit Popullor të Rrethit në Podujevë,
 12. I Nerodimes me seli të Këshillit Popullor të Rrethit në Ferizaj,
 13. I Pejës me seli të Këshillit Popullor të Rrethit në Pejë,
 14. I Podrimës me seli të Këshillit Popullor të Rrethit në Rahovec,
 15. I Sitnicës me seli të Këshillit Popullor të Rrethit në Lipjan,
 16. I Suharekës me seli të Këshillit Popullor të Rrethit në Suharekë,
 17. I Sharrit me seli të Këshillit Popullor të Rrethit në Prizren.
- v. Në territorin e Krahinës së Beogradit
.....

Neni 4

Qytetet jashtë përbërjes së rrethit janë:

.....

c. Në territorin e Krahinës Autonome të Kosovës dhe Metohisë:

- a) Mitrovica,
- b) Peja,
- c) Prizreni,
- d) Prishtina.

.....

Neni 7

Vendbanimet dhe qytetet në përbërje të rrethit janë:

1. Në territorin e Krahinës Autonome të Vojvodinës:

.....

2. Në territorin e Krahinës Autonome të Kosovës dhe Metohisë:

I. Rrethi i Vushtrrisë

<i>Nr.r.</i>	<i>Vendi dhe emri i KPV-së</i>	<i>Selia e KPV-së</i>	<i>Vendbanimi në përbërje të KPV-së</i>
1.	Babimoc	Babimoc	Babimoc, Barilevë, Breznicë, Drenoc
2.	Gojbulë	Gojbulë	Gojbulë, Studime e Poshtme, Karaçë, Miraçë, Novosellë e Begut, Shlivovicë.
3.	Stanovc i Posh.	Stanovc i Posh.	Velikarekë, Stanovc i Epërm, Gracë, Stanovc i Poshtëm.
4.	Dërvar	Dërvari	Dërvar, Mihaliq, Reznik, Shallc.
5.	Dumnicë e Llugave	Dumnicë e Llugave	Dumnicë e Ep., Dumnicë e Posht., Zagori dhe Dumnicë e Llugave.
6.	Novolan	Novolan	Brusnik, Bukosh, Vërrnicë, Galicë, Dubovc, Kollë, Novolan, Taraxhë.
7.	Nedakoc	Nedakoc	Svaraçak i Epërm, Svaraçak i Poshtëm, Mavriq, Nedakoc, Pestovë.
8.	Novosellë	Novosellë	Vilanc, Novosellë, Ropicë, Samadrexhë.
9.	Pantinë	Pantinë	Balincë, Dolak, Jezerë, Akrashticë, Ashlan, Pantinë, Pirç, Hercegovë, Shitaricë.

10.	Pasomë	Pasomë	Rashtani i Epërm, Rashtani i Poshtëm, Pasomë, Tarllabuq, Tërstenë.
11	Prilluzhë	Prilluzhë	Beçuk, Bivolak, Gllavatin, Prilluzhë, Strofc.
12.	Sibovc	Sibovc	Zhilivodë, Plemetin, Sibovc, Hamidi.
13.	Skromë	Skromë	Boshlan, Vesekoc, Gumnishtë, Kurillovë, Skromë.
14.	Smrekonicë	Smrekonicë	Banjë, Kçiq i Madh, Dobërlukë, Sllatinë, Smrekonicë.
15.	Ceceli	Ceceli	Studime e Epërme, Kunovik, Skoçnë, Sllakovc, Ceceli.

Në përbërje të Rrethit të Vushtrrisë hyn territori i Këshillit Popullor të qytetit të Vushtrrisë.

II. Rrethi i Gjilanit

<i>Nr.r.</i>	<i>Vendi dhe emri i KPV-së</i>	<i>Selia e KPV-së</i>	<i>Vendbanimi në përbërje të KPV-së</i>
1.	Bostan	Bostan	Bostan, Makresh i Epërm, Makresh i Poshtëm, Dragancë, Jasenovik, Kllobukar, Novobërdë, Tëriçevc.
2.	Bresallc	Bresallc	Bresallc, Ponesh, Strazhë.
3.	Llashticë	Llashticë	Burincë, Llashticë, Lipovicë, Muçibabë.
4.	Sllakoc i Epërm	Sllakoc i Epërm	Gadish, Sllakoc i Epërm, Sllakoc i Poshtëm, Kishnapolë.
5.	Zhegër	Zhegër	Lladovë, Zhegër, Nasalë.
6.	Malishevë	Malishevë	Bukovik, Malishevë, Capar, Shillovë.
7.	Parallovë	Parallovë	Vërrnicë, Zhegoc, Parallovë.
8.	Partesh	Partesh	Budrigë e Posh., Livoq i Posh., Partesh.
9.	Pasjan	Pasjan	Velekincë, Pasjan, Uglar.
10.	Pograxhë	Pograxhë	Bilinicë, Inatovc ¹²⁸ , Llovcë, Pograxhë, Sllubicë, Stublinë.
11.	Prekoc	Prekoc	Zebincë, Izvor, Manishincë, Prekoc.
12.	Prilepnicë	Prilepnicë	Vërbicë, Kmetoc, Mozgovë, Prilepnicë.
13.	Stanishor	Stanishor	Kufcë e Epërme, Koretishtë, Pasjak, Stanishor.

¹²⁸ Nga popullata vendore quhet me emrin Kokaj.

14.	Cërnicë	Cërnicë	Vrapçiq, Gumnishtë, Livoq i Epërm, Kravaricë, Cërnicë.
15.	Shurdhan	Shurdhan	Dunav, Goden i Vogël, Pidiq, Stançiq, Çelik, Shurdhan.

Në përbërje të Rrethit të Gjilanit hyn edhe territori i Këshillit Popullor të qytetit të Gjilanit.

III. Rrethi i Moravës së Epërme

<i>Nr.r.</i>	<i>Vendi dhe emri i KPV-së</i>	<i>Selia e KPV-së</i>	<i>Vendbanimi në përbërje të KPV-së</i>
1.	Beguncë	Beguncë	Beguncë, Buzovik, Debelde, Lubizhdë.
2.	Viti	Viti	Viti, Drobesh, Ramnishtë.
3.	Vërboc	Vërboc	Vërboc, Gërçar, Mogillë, Podgorc.
4.	Gushicë	Gushicë	Vërban, Gërmovë, Gushicë, Sadovina e Jerlive.
5.	Gjylekare	Gjylekare	Goden, Stublla e P., Remnik, Gjylekare.
6.	Kabash	Kabash	Binçë, Kabash, Smirë.
7.	Korbuliq	Korbuliq	Dardhishtë, Drenogllavë, Korbuliq, Mjak, Nikoc.
8.	Letnicë	Letnicë	Vërnez, Vërnakollë, Stubëll e Epërm, Letnicë, Shashar.
9.	Pozharan	Pozharan	Ramjan i Poshtëm, Novosellë, Pozharan, Çifllak.
10.	Radivojc	Radivojc	Budrigë e Epërme, Devajë, Kllokot, Radivojc.
11.	Tërpezë	Tërpezë	Ballancë, Zhiti, Tërpezë.
12.	Sadovinë e Çerkezëve	Sadovinë e Çerkezëve	Sllatinë e Epërme, Sllatinë e Poshtme, Tërstenik, Sadovinë e Çerkezëve.

IV. Rrethi i Gorës

<i>Nr.r.</i>	<i>Vendi dhe emri i KPV-së</i>	<i>Selia e KPV-së</i>	<i>Vendbanimi në përbërje të KPV-së</i>
1.	Bellobradë	Bellobradë	Bellobradë, Breznë, Buçe, Brut, Zgatar, Zym, Kapër, Pllavë, Renc.
2.	Brodosanë	Brodosanë	Blaç, Brodosanë, Buzez, Zapluxhe, Kosavë, Kuklibeg, Kuk, Pllajnik.
3.	Brod	Brod	Brod
4.	Vranishtë	Vranishtë	Baçkë, Vranishtë, Dikanc, Mlikë, Orçushë.

5.	Dragash	Dragash	Dragash, Xërxë, Kërstec, Kukolan, Leshtan, Lubovishtë, Radeshë, Rapçë, Shajne.
6.	Krushevë	Krushevë	Gllloboçicë, Zlipotok, Krushevë, Restelicë.

V. Rrethi i Graçanicës

<i>Nr.r.</i>	<i>Vendi dhe emri i KPV-së</i>	<i>Selia e KPV-së</i>	<i>Vendbanimi në përbërje të KPV-së</i>
1.	Besi	Besi	Besi, Vranidoll, Leban, Prugoc, Rimanishtë.
2.	Sllatinë e M.	Sllatinë e M.	Sllatinë e Madhe, Harilaq, Henc, Sllatinë e Vogël, Bellaqevci i Vogël.
3.	Bellaqevci i M.	Bellaqevci i M.	Graboc i Bustinjës ¹²⁹ , Grabovc, Kuzmin, Pomozotin, Shipitullë.
4.	Graçanicë	Graçanicë	Ajvali, Badovc, Graçanicë, Zllatar, Matiçan, Novosellë, Sushicë.
5.	Nëntë Jugoviq	Nëntë Jugoviq	Bërmicë e Epërme, Nëntë Jugoviq, Bërmicë e Poshtme, Trudë.
6.	Dobrevë e Poshtme	Dobrevë e Poshtme	Vragoli, Dobrevë e Epërme, Dobrevë e Poshtme
7.	Kaçikollë	Kaçikollë	Kaçikollë, Prapashticë.
8.	Komaran	Komaran	Berishë, Korroticë e Epërme, Fushticë e Epërme, Zabel i Epërm, Fushticë e Poshtme, Zabel i Poshtëm, Domanek, Kishnarekë, Komaran, Nekoc, Stankoc,
9.	Fushë-Kosovë	Fushë-Kosovë	Fushë-Kosovë, Bresje, Dobërdup, Fushë-Kosovë, Uglar.
10.	Llappllasellë	Llappllasellë	Llappllasellë, Preoc, Çagllavicë.
11.	Llukar	Llukar	Grashticë, Kolovicë, Llukar, Makoc, Radashevc, Siçevë.
12.	Marec	Marec	Marec
13.	Millosevë	Millosevë	Bakshi, Lazarevë, Millosevë, Raskovë.
14.	Mramor	Mramor	Busi, Mramor.
15.	Obiliq	Obiliq	Kryshevc, Mazgjit, Obiliq, Orllloviq.
16.	Minjera Kosova	Minjera Kosova	Hade, Dobrosellë, Leshkoshiq, Minjera Kosova, Cërkvenavodicë.
17.	Slivovë	Slivovë	Dragovc, Kukavicë, Llabjan, Slivovë.

¹²⁹ Ashtu figuron në dokument. Ka të bëjë me vendbanimin e sotëm Grabovci i Poshtëm.

VI. Rrethi i Drenicës

<i>Nr.r.</i>	<i>Vendi dhe emri i KPV-së</i>	<i>Selia e KPV-së</i>	<i>Vendbanimi në përbërje të KPV-së</i>
1.	Banjë	Banjë	Banjë, Padalishtë, Suhogërlle, Çitak.
2.	Vojnik	Vojnik	Brojë, Vojnik.
3.	Gllanasellë	Gllanasellë	Vasilevë, Gllanasellë, Gradicë, Godanc, Dobrashec, Çikatovë e Re, Çikatovë e Vjetër.
4.	Glllogoc	Glllogoc	Bajincë, Glllobar, Glllogoc, Domanek, Krajkovë, Poklek, Shtrubullova.
5.	Klinë e Epërme	Klinë e Epërme	Klinë e Epërme, Kotor, Kërligatë, Kuçicë, Klinë e Mesme, Tërnac.
6.	Abri e Epërme	Abri e Epërme	Vuçak, Abri e Epërme, Abri e Poshtme, Murgë, Terdec.
7.	Prekaz i Ep.	Prekaz i Ep.	Prekaz i Epërm, Lubovec, Mikushnicë.
8.	Kllodërnice	Kllodërnice	Belicë, Vitak, Izbicë, Kllodërnice.
9.	Llaushë	Llaushë	Llaushë, Rakinicë, Çubrel.
10.	Plluzhinë	Plluzhinë	Açarevë, Plluzhinë, Ticë.
11.	Polac	Polac	Dashec, Kralicë ¹³⁰ , Krushec, Marinë, Polac i Ri, Polac.
12.	Rezallë	Rezallë	Likoc, Rezallë, Tushilë.
13.	Runik	Runik	Kosterc, Leçinë, Radishevë, Runik.
14.	Sërbicë	Sërbicë	Klinë e Poshtme, Prekaz i Poshtëm, Sërbicë.
15.	Tërstenik	Tërstenik	Vërboc, Makërmal, Polluzhë, Tërstenik, Shtuticë.
16.	Turiçec	Turiçec	Kopiliq i Epërm, Kopiliq i Poshtëm, Turiçec.
17.	Çirez	Çirez	Baks, Beçiç, Krasaliq, Kozhicë, Krasmiroc, Likoshan, Prelloc, Çirez.

VII. Rrethi i Gjakovës

<i>Nr.r.</i>	<i>Vendi dhe emri i KPV-së</i>	<i>Selia e KPV-së</i>	<i>Vendbanimi në përbërje të KPV-së</i>
1.	Botushë	Botushë	Botushë, Brovinë, Dobrosh, Koshare, Molliq, Nivokaz, Pacaj.
2.	Bec	Bec	Bec, Bërdosan, Vraniq, Doblibare, Zhdrellë, Janosh, Kodrali, Lugbunar, Meçë, Netec, Rashkoc, Rrezinë, Qerim, Cërmjan.

¹³⁰ Vendbanim i krijuar si koloni sllave në tokat e disa fshatrave në juglindje të Skënderaj në periudhën ndërmjet dy luftërave botërore.

3.	Brekoc	Brekoc	Brekoc, Vogovë, Guskë, Devë, Zhub, Zylfaj, Jahoc, Korenicë, Madanaj, Mejë, Moglicë, Orize, Ramoc, Raçë, Rrypaj, Firzë.
4.	Gramaçel	Gramaçel	Baballoq, Glllogjan, Gramaçel, Dobrixhe, Dubravë, Hereq, Rastavicë, Shaptej.
5.	Gërgoc	Gërgoc	Bardhaniq, Gërgoc, Zhabel, Jabllanicë, Kralan, Llugaxhi, Maznik, Radoniq, Rakovinë, Rakoc.
6.	Deçan	Deçan	Beleg, Llukë e Epërme, Carabreg i Epërm, Deçan, Carabreg i Poshtëm.
7.	Drenoc	Drenoc	Voksh, Drenoc, Lloçan, Pobërzhë, Prilep, Sllup.
8.	Junik	Junik	Gjocaj, Jasiq, Junik.
9.	Ponoshec	Ponoshec	Babaj Bokës, Berjah, Nec i Epërm, Nec i Poshtëm, Duzhnje, Morinë, Ponoshec, Popoc, Potok, Smolicë, Stubëll, Shishman i Bokës, Shishman i Rrafshit.
10.	Irzniq	Irzniq	Ratish i Ep., Dashinoc, Llukë e P., Ratish i P., Kodrali, Lumbardh, Vranoc i V., Pozhar, Prekollukë, Irzniq.
11.	Rogovë	Rogovë	Damjan, Kushnin, Rogovë.
12.	Skivjan	Skivjan	Novosella e Epërme, Dallashaj, Novosellë e Poshtme, Dujakë, Osek Pashë, Osek Hylë, Palabardh, Plançor, Rracaj, Skivjan, Trakaniq, Sheremetaj.
13.	Smaç	Smaç	Bishtazhin, Goden, Gërçinë, Dol, Kusar, Kushavec, Lipovec, Marmullë, Pjetërshan, Smaç, Ujëz.

Në përbërje të Rrethit të Gjakovës hyn edhe territori i qytetit të Gjakovës dhe Sadik Agës.

VIII. Rrethi i Zveçanit

<i>Nr.r.</i>	<i>Vendi dhe emri i KPV-së</i>	<i>Selia e KPV-së</i>	<i>Vendbanimi në përbërje të KPV-së</i>
1.	Banjskë	Banjskë	Banjskë, Banjska Reka, Suhadoll i Banjës, Bresnicë, Vallq, Villishtë, Vojmislq, Jankov Potok, Joshevik, Junakë, Kamenicë, Kozarevë,

			Lipovicë, Llovac, Llozishtë, Llokvë, Mekindoll, Rahovicë, Parucë, Rudninë, Shipovë.
2.	Bare	Bare	Bajgorë, Bare, Vidishiq, Kaçanoll, Kovaçicë, Rëzhanë, Selac.
3.	Bërrnjak	Bërrnjak	Babiq, Banjë, Bërrnjak, Varagë, Vukojeviq, Dragalicë, Okllace, Presjekë.
4.	Vllahi	Vllahi	Batahir, Bisticë, Vllahi, Dedi, Zhazhë, Zabërxhë, Zijaqë, Koshutovë, Maxherë, Ovçar, Cerajë.
5.	Zveçan	Zveçan	Banovdoll, Boletin, Vidimiriq, Grabovc, Gushavc, Dolan, Vinarc i Poshtëm, Zherovnicë, Zhitkovc, Zveçan, Korile, Lipë, Maticë, Rudar, Sendoll, Sërbovec, Suhadoll.
6.	Zubin Potok	Zubin Potok	Velibreg, Gazivodë, Dobroshevinë, Jasenovik i P., Zagulë, Zubin Potok, Jabukë, Kobillagllavë, Padinë, Prevllakë, Pridvoricë, Uglar, Crepulë, Çiflluk.
7.	Leposaviq	Leposaviq	Vitanoviqi, Kërnini i Ep., Gnjezdani, Desetak, Dren, Dubokë, Zabërxhë, Zërnosek, Joshanicë, Kajkovë, Kijevçiq, Koporiq, Kostin Potok, Krushevë, Krushçicë, Kutinje, Leposaviq, Majdevë, Mekishiq, Mioliq, Plakaonicë, Popovce, Rodel, Tvrgjen, Triskose, Ulije.
8.	Lluçka Rekë	Lluçka Rekë	Babudovicë, Vojnoviq, Bube, Burllat, Vërbë, Vukosavleviq, Zagraxhë, Zeçeviq, Kijevci, Lluçka Rekë, Rançiq, Çeshanoviq.
9.	Tunel i Parë	Tunel i Parë	Zasellë, Kutllac, Lisicë, Kçiq i Vogël, Rahovë, Tunel i Parë, Rekë, Shupkoc.
10.	Rezallë	Rezallë	Kalludra e Madhe, Jasenoviku i Epërm, Kovaqi, Kopiloviqi, Megjeqi Potok, Rezallë, Rovcë, Tushiqi, Çeçeva.
11.	Sllatinë	Sllatinë	Borçan, Berzancë, Vuçë, Graniçan, Gërkaje, Dobravë, Zavrata, Jellakce, Kamenicë, Llazinë, Llozno,

			Moshnicë, Pridvoricë, Rumance, Seoce, Sllatinë, Soçanicë, Strërzhin, Cërveni.
12.	Stantërg	Stantërg	Mazhiq, Melenicë, Stantërg, Stranë.
13.	Çabër	Çabër	Varagë, Vinarc i Epërm, Stërme i Epërm, Zupçe, Jagnjenicë, Prelez, Rujishtë, Çabër.
14.	Shipol	Shipol	Broboniq, Vaganicë, Vërbnicë, Zhabar i Epërm, Zhabar i Poshtëm, Koprivë, Koshutovë, Lushtë, Svinjar, Shipol.

IX. Rrethi i Istogut

<i>Nr.r.</i>	<i>Vendi dhe emri i KPV-së</i>	<i>Selia e KPV-së</i>	<i>Vendbanimi në përbërje të KPV-së</i>
1.	Banjë	Banjë	Banjë, Banjicë, Kashicë, Lubovë, Dubovë e Vogël, Orobërdë, Carrallukë.
2.	Vrellë	Vrellë	Vrellë, Kamenicë, Prigodë, Studenicë.
3.	Dobrushë	Dobrushë	Dobrushë, Prekallë, Starodran.
4.	Dollc	Dollc	Dërsnik, Dollc, Çupevë.
5.	Dubravë	Dubravë	Bellopojë, Veriq, Dragolec i Epërm, Dragolec i Poshtëm, Gusar, Dubravë, Mojstir, Sine.
6.	Gjurakoc	Gjurakoc	Llukvac i Begut, Gjurakoc, Kovragë, Llukvac i Thatë, Tomoc.
7.	Zallq	Zallq	Drejë, Zallq, Rudicë, Turbuhoc.
8.	Zllokuçan	Zllokuçan	Berkovë, Zllokuçan, Potoçan, Radullovc, Renoc.
9.	Istog	Istog	Istog i Poshtëm, Istog, Llugë, Muzhevinë, Cërcë.
10.	Jashanicë	Jashanicë	Dush, Gjurgjevik, Jelloc, Jashanicë, Pograxhë, Resnik.
11.	Klinë	Klinë	Gjurgjevik, Klinë, Klinavc, Krushevë.
12.	Jabllanicë e V.	Jabllanicë e V.	Jabllanicë e Madhe, Kaliçan, Jabllanicë e Vogël, Radac.
13.	Osojan	Osojan	Kosh, Veriq i Ri, Oprashkë, Osojan, Polanë, Tuçep, Shalinovicë.
14.	Rakosh	Rakosh	Zhakovë, Këminë, Rakosh, Stropac, Sushicë.
15.	Cërkolez	Cërkolez	Suhogërrllë, Uçë, Cërkolez, Dren.
16.	Shtupel	Shtupel	Binxhë, Grabc, Kërnice, Shtupel.

X. Rrethi i Kamenicës

<i>Nr.r.</i>	<i>Vendi dhe emri i KPV-së</i>	<i>Selia e KPV-së</i>	<i>Vendbanimi në përbërje të KPV-së</i>
1.	Hajkobillë	Hajkobillë	Hajkobillë, Dabishec, Zajçevc.
2.	Hajnovc	Hajnovc	Hajnovc, Bratilloç, Bushincë, Kostadincë, Meshinë, Tirincë, Firiqejë.
3.	Ropotova e Madhe	Ropotova e Madhe	Bozhevc, Ropotovë e Madhe, Drenovc, Ropotovë e Vogël, Hodec, Rajnovc.
4.	Shipashnicë e Epërme	Shipashnicë e Epërme	Shipashnicë e Epërme, Kranidell, Sedllar.
5.	Shipashnicë e Poshtme	Shipashnicë e Poshtme	Dajkoc, Shipashnicë e Poshtme, Kollollec, Muçivërc, Çarakovc.
6.	Kormjan i Poshtme	Kormjan i Poshtme	Kormjan i Poshtëm, Kormjan i Epërm, Domoroc.
7.	Kamenicë	Kamenicë	Berivojc, Bosce, Grizimë, Kamenicë, Moçar, Strellicë.
8.	Koretin	Koretin	Bllatë, Koretin, Topanicë.
9.	Krilevë	Krilevë	Glllogovicë, Krilevë.
10.	Lisockë	Lisockë	Gjurishec, Lisockë, Zhujë, Shahiq.
11.	Hogosht	Hogosht	Dazhdincë, Hogosht, Kopërmicë.
12.	Poliçkë	Poliçkë	Velegllavë, Vriçec, Desivojc, Lajiq, Marocë, Poliçkë, Tërstenë.
13.	Ranillug	Ranillug	Glllogoc, Dobërçan, Pançellë, Petrovc, Ranillug, Tomancë.
14.	Rubovc	Rubovc	Busovatë, Gogullovc, Miganovc, Rubovc.
15.	Rogoçicë	Rogoçicë	Karaçevë e Epërme, Karaçevë e Posht., Novosellë, Hodanoc, Rogoçicë.
16.	Strezovc	Strezovc	Bolevc, Vaganesh, Gragjenik, Carevc, Kremenatë, Leshtar, Rahovicë, Strezovc.
17.	Tugjevc	Tugjevc	Gmicë, Cvirçë, Tugjevc.

XI. Rrethi i Llapit

<i>Nr.r.</i>	<i>Vendi dhe emri i KPV-së</i>	<i>Selia e KPV-së</i>	<i>Vendbanimi në përbërje të KPV-së</i>
1.	Halabak	Halabak	Halabak, Bellopojë, Tërnavë, Sharban.
2.	Bajçinë	Bajçinë	Bajçinë, Dobërdol, Dobratin.
3.	Ballaban	Ballaban	Ballaban, Barainë, Koliq.
4.	Batllavë	Batllavë	Batllavë, Gërdoc, Dyz, Kaçibeg, Radujevc.
5.	Brainë	Brainë	Brainë, Bërvenik, Kalaticë, Nishevc.

6.	Gllamnik	Gllamnik	Burincë, Gllamnik, Sibovc i Epërm, Sibovc i Poshtëm, Konushevc, Penuhë.
7.	Llapashticë e Epërme	Llapashticë e Epërme	Llapashticë e Epërme, Llapashticë e Poshtme, Popovë.
8.	Dumnicë e Poshtme	Dumnicë e Poshtme	Dumnicë e Epërme, Dumnicë e Poshtme, Llaushë, Përpellac.
9.	Lupç i P.	Lupç i P.	Lupç i Epërm, Lupç i Poshtëm, Majanc, Teneshdoll.
10.	Kërpimeh	Kërpimeh	Zakut, Kërpimeh, Metehi, Pakashticë, Revuçë, Repë.
11.	Lluzhan	Lluzhan	Godishnjak, Sollobajë, Llugë, Lluzhan, Shakovicë.
12.	Orllan	Orllan	Bllatë, Kushevicë, Muhazob, Metërgoc, Orllan, Rakinicë, Turuçicë.
13.	Peran	Peran	Bradash, Velikarekë, Letanc, Obranhë, Peran.
14.	Pollatë	Pollatë	Brecë, Dvorishtë, Zhiti, Murgullë, Pollatë, Potok, Reçicë, Sylevicë, Sllatinë, Tërnavicë.
15.	Podujevë	Podujevë	Podujevë
16.	Sveçël	Sveçël	Dumosh, Ladovc, Sveçël, Surkish.
17.	Shajkovc	Shajkovc	Surdull, Hërrticë, Shajkovc.
18.	Shtedim	Shtedim	Ballovc, Livadicë, Merdare, Mirovc, Shtedim.

XII. Rrethi i Nerodimes

<i>Nr.r.</i>	<i>Vendi dhe emri i KPV-së</i>	<i>Selia e KPV-së</i>	<i>Vendbanimi në përbërje të KPV-së</i>
1.	Gaçkë	Gaçkë	Banjicë, Burrnik, Gaçkë, Greme, Izhancë, Semajë.
2.	Nerodime e Epërme	Nerodime e Epërme	Balaj, Bozhoviq, Nerodime e Epërme, Nerodime e Poshtme, Dremjak, Jezerc, Muhaxher, Stojkoviç.
3.	Doganaj	Doganaj	Vatë, Vishë, Gabricë, Gërlicë e Epërme, Doganaj, Dubravë, Duraj, Elezaj, Kamenicë, Rakë, Rekë, Sllatinë, Sopotincë.
4.	Drajkovc	Drajkovc	Brod, Viçë, Gotovushë, Drajkovc, Kashtanjevë, Firajë.
5.	Han i Elezit	Han i Elezit	Balazh, Vërtomicë, Gorancë, Bush i

			Epërm, Bush i Poshtëm, Dac-Bravë, Dremjak, Dimcë, Han i Elezit, Krivenik, Miliq, Neçavc, Paldonicë, Pustenik, Rëzhancë, Seçishtë, Hasallar, Hunel.
6.	Zaskok	Zaskok	Varosh, Doganaj, Zaskok, Manastirc, Pleshinë.
7.	Ivajë	Ivajë	Gajre, Gllloboçicë, Dragomac, Ivajë, Kotlinë, Strazhë.
8.	Kaçanik	Kaçanik	Axham, Bela-Mjak, Bob, Biçec, Kukaj, Bunjak, Gjurgjedel, Zymer-Thaç, Kaçanik, Kovaçec, Kosharishtë, Llanishtë, Nikaj, Reç, Runjevë, Çaka.
9.	Kosin	Kosin	Publicë, Prelez i Jerlive, Kosin, Koshare, Llashkobare, Slivovë, Tërn.
10.	Kaçaniku i Vjetër	Kaçaniku i Vjetër	Begracë, Gërllicë e P., Krivanjivë, Reç, Kuçishtë, Stagovë, Kaçanik i Vjetër, Teneçe, Topojan, Tren-Luzhë, Horun.
11.	Fshati i Vj.	Fshati i Vj.	Bibaj, Komogllavë, Nikodin, Sojevë, Fshati i Vjetër.
12.	Talinovc	Talinovc	Gërbol, Talinovc i Jerlive, Muhovc, Papaz, Pojatishtë, Rahovicë, Retkocer, Sazli, Softoviq.
13.	Tankosiq	Tankosiq	Zllatar, Mirosalë, Tankosiq.
14.	Shtërrpc	Shtërrpc	Berivojcë, Vërbeshiticë, Biti e Epërme, Biti e Poshtme, Jazhincë, Sevcë, Sushicë, Shtërrpcë.

Në kuadër të Rrethit të Nerodimës hynë edhe territori i Këshillit Popullor të qytetit të Ferizajt në përbërjen e të cilit gjendet qyteti Ferizaj.

XIII. Rrethi i Pejës

<i>Nr. r.</i>	<i>Vendi dhe emri i KPV-së</i>	<i>Selia e KPV-së</i>	<i>Vendbanimi në përbërje të KPV-së</i>
1.	Brestovik	Brestovik	Brestovik, Letinë, Lipë, Lëvoshë, Cigë, Maja e Zezë.
2.	Videje	Videje	Videje, Jagodë, Krushevë, Novosellë e Dejës, Novosellë e Zajmit.
3.	Vitomiricë	Vitomiricë	Burnut, Vitomiricë, Dubovë, Novosellë, Ozrim.
4.	Glllogjan	Glllogjan	Glllogjan, Kosuriq, Kpuz, Lugaxhi, Napolë, Çeskovë.

5.	Gorazhdec	Gorazhdec	Bërzhënik, Gorazhdec, Grabovc, Llozhan, Orashje.
6.	Strelle i Epërm	Strelle i Epërm	Belejë, Strelle i Epërm, Strelle i Poshtëm, Isniq, Lëbushë.
7.	Baran i Poshtëm	Baran i Poshtëm	Buçan, Vranoc, Baran i Epërm, Baran i Poshtëm, Kotradiq, Rosujë, Turjakë, Çellopek.
8.	Drelaj	Drelaj	Reka e Allagës, Bellopaq, Bogë, Shtupeq i Madh, Hani i Jusufit, Llaze, Llutovë, Malaj, Shtupeq i Vogël, Pepiq.
9.	Drenoc	Drenoc	Bokshiq, Pjetërq i Epërm, Grabanicë, Dollovë, Pjetërq i Poshtëm, Drenoc, Dugajevë, Milliqeviq.
10.	Zahaq	Zahaq	Bllagajë, Zahaq, Llabjan, Pavlan, Ramun, Qyshk.
11.	Kryshec	Kryshec	Broliq, Dubovik, Kryshec, Papiq, Prapaçan, Rashiç.
12.	Kuçishtë	Kuçishtë	Bogë, Dugajevë, Jashanicë, Koshutan, Kuçishtë, Haxhaj, Shkrel.
13.	Leshan	Leshan	Gllaviçicë, Jabllanicë, Kliçinë, Leshan, Sfërkë.
14.	Poçestë	Poçestë	Babiq, Vragoc, Dobërdol, Kërstec, Millovanc, Pishtan, Poçestë.
15.	Raushiq	Raushiq	Bellopojë, Zagërme, Zillopek, Loxhë, Lybeniq, Morinë, Raushiq.
16.	Stup	Stup	Budisalc, Lutogllavë, Nagllavkë, Osojë, Ruhot, Stup, Tërstenik.
17.	Treboviq	Treboviq	Nabërxhan, Nakëll, Fshati i Pashës, Treboviq.

XIV. Rrethi i Podrimes

<i>Nr.r.</i>	<i>Vendi dhe emri i KPV-së</i>	<i>Selia e KPV-së</i>	<i>Vendbanimi në përbërje të KPV-së</i>
1.	Banjë	Banjë	Banjë, Gajrak, Ladrovç, Senik.
2.	Bellacërkë	Bellacërkë	Bellacërkë, Bërnjaçë, Gexhë, Xërxë, Sopniq.
3.	Hoçë e Madhe	Hoçë e Madhe	Brestovc, Hoçë e Madhe, Hoçë e Vogël, Nagavc.
4.	Ujëmir	Ujëmir	Ujëmir, Dobërdol, Zabërxhë, Gllarevë, Siçevë, Cerovik, Çabiq.
5.	Drenovc	Drenovc	Bratotin, Vërnjak, Potoçan i Epërm, Potoçan i Poshtëm, Drenoc, Zatriq, Nushpalë, Pastasel, Sanovc.

6.	Zoçishtë	Zoçishtë	Zoçishtë, Apterushë, Reti.
7.	Kijevë	Kijevë	Bubavec, Gullboc, Kijevë, Llazicë, Mleçan, Plloçicë.
8.	Malishevë	Malishevë	Joviq, Lubizhdë, Malishevë, Mirushë, Turjakë, Caravranë.
9.	Rahovec	Rahovec	Rahovec
10.	Arllat	Arllat	Llapushnik, Negroc, Arllat, Tërpezë.
11.	Astrazub	Astrazub	Guriq, Dragobil, Jançishtë, Maxharë, Marali, Millanoviq, Astrazub, Pagarushë.
12.	Polluzhë	Polluzhë	Koznik, Kramovik, Llapçevë, Mrasor, Petkoviq, Polluzhë, Çifllak.
13.	Ratkoc	Ratkoc	Denjë, Dobërdol, Ratkoc, Radostë.
14.	Svërkë	Svërkë	Bubël, Volljak, Damanek, Dush, Ponorc, Përçevë, Rud, Sfërkë.
15.	Carallukë	Carallukë	Llashkadrenoc, Balincë, Shkarashnik, Vërmicë, Carallukë.

XV. Rrethi i Sitnicës

<i>Nr.r.</i>	<i>Vendi dhe emri i KPV-së</i>	<i>Selia e KPV-së</i>	<i>Vendbanimi në përbërje të KPV-së</i>
1.	Babush	Babush	Bablak, Babush i Serbëve, Mirash, Prelez, Rubovc, Surçinë, Cërnillë.
2.	Glllogoc	Glllogoc	Banullë, Glllogoc, Gumnasellë, Kojskë.
3.	Gadime e Poshtme	Babushi i Madh	Gadime e Epërme, Gadime e Poshtme, Llugaxhi, Marevc, Babush i Muhaxhirëve.
4.	Gushtericë e Poshtme	Gushtericë e Poshtme	Gushtericë e Poshtme, Dobratin, Gushtericë e Epërme, Livaxhë.
5.	Godanc i Epërm	Godanc i Epërm	Godanc i Epërm, Godanc i Poshtëm, Zborc, Bregu i Zi.
6.	Janjevë	Janjevë	Honroc, Brus, Bukovicë, Janjevë, Okosnicë, Shashkoc, Teqe, Shisharkë.
7.	Lipjan	Lipjan	Konjuh, Lipjan, Hallaq i Vogël, Rufc i Ri, Rufc i Vjetër, Suhadoll.
8.	Magure	Magure	Dobrajë e Madhe, Vrellë, Vërshevc, Leletiq, Magure, Dobrajë e Vogël, Medvec, Poturovc, Torinë, Qylagë.
9.	Muzeçinë	Muzeçinë	Vojnovc, Davidovc, Gjirkovc, Muzeçinë, Rashincë.

10.	Radevë	Radevë	Batusë, Lepi, Llugë, Radevë, Skullan.
11.	Sedllar	Sedllar	Baincë, Divjak, Dugë, Kleçkë, Karaçicë, Krojmirovç, Pjetreshticë, Rusinovç, Sedllar.
12.	Grackë e Vjetër	Grackë e Vjetër	Bujan, Varigoc, Hallaç i Madh, Ribar i Madh, Zllokuçan, Kraishtë, Grackë e Vogël, Ribar i Vogël, Grackë e Vjetër, Topliçan.
13.	Shtime	Shtime	Belincë, Llanishtë, Mollopolc, Petrovë, Rancë, Topillë, Raçak, Caralevë, Shtime.

XVI. Rrethi i Suharekës

<i>Nr.r.</i>	<i>Vendi dhe emri i KPV-së</i>	<i>Selia e KPV-së</i>	<i>Vendbanimi në përbërje të KPV-së</i>
1.	Bellanicë	Bellanicë	Bellanicë, Guncat, Lladroviq, Tumeçinë.
2.	Bukosh	Bukosh	Budakovë, Bukosh, Vraniq, Vërshevc, Krushicë, Movlan, Papaz, Popovlan.
3.	Duhle	Duhle	Bllacë, Greiçevc, Dragaçinë, Duhle, Javor, Luzhnicë, Stravuçinë, Çadrak.
4.	Mamushë	Mamushë	Mamushë, Medvec.
5.	Mushetisht	Mushetisht	Dvoran, Dellovc, Maçitevë, Mushtisht.
6.	Semetisht	Semetisht	Kosterc, Kravasari, Nishor, Semetisht.
7.	Sopi	Sopi	Gilanc, Grejkoc, Dubravë, Gjinoc, Savrovë, Sellograzhdë, Sopi, Topliçan.
8.	Studençan	Studençan	Dobërdolan, Kosançiq, Nëprebisht, Samadrexhë, Studençan, Tërne.
9.	Suharekë	Suharekë	Leshan, Peçan, Rashtan, Reçan, Sllapuzhan, Suharekë, Shirokë.

XVII. Rrethi i Sharrit

<i>Nr.r.</i>	<i>Vendi dhe emri i KPV-së</i>	<i>Selia e KPV-së</i>	<i>Vendbanimi në përbërje të KPV-së</i>
1.	Krushë e Madhe	Krushë e Madhe	Krushë e Madhe, Krushë e Vogël, Randobravë, Celinë.
2.	Sërbicë e Ep.	Sërbicë e Ep.	Velezhë, Gilanc, Serbicë e Epërme, Serbicë e Poshtme, Zojz, Novak, Piranë, Smaç, Trepetnicë, Caparc, Shpinadi.
3.	Dushanovë	Dushanovë	Atmaxhë, Grazhdanik, Dushanovë, Landovicë, Nashec, Petrovosellë, Tupec.

4.	Zhur	Zhur	Vllashnje, Vërmicë, Dobrushtë, Zhur, Kobajë, Shkozë.
5.	Zym	Zym	Dedaj, Gjonaj, Zym, Kabash, Karashëngjergj, Krajk, Lubizhdë, Lukinje, Romajë.
6.	Lubizhdë	Lubizhdë	Vërbiçan, Gërçar, Dojnicë, Kabash, Korishë, Lubizhdë, Lutogllavë, Shumadia e Re, Novosellë, Skorobisht.
7.	Plane	Plane	Gorozhup, Kojushë, Mazrek, Milaj, Plane.
8.	Reçan	Reçan	Zhivinjan, Jabllanicë, Llokvicë, Manastirc, Nebregoshte, Reçan, Struzhje.
9.	Sreckë	Sreckë	Lubinja e Epërme, Gornjesellë, Lubinje e Poshtme, Drajçiq, Mushnikovë, Pllanjan, Sreckë.
10.	Hoçë e Qytetit	Hoçë e Qytetit	Bilushë, Jeshkovë, Kushtendil, Lez, Leskovec, Lybiçevë, Poslishtë, Hoçë e Qytetit.

v. Në territorin e Krahinës së Beogradit:

.....
.....

Neni 8

Procedurat dhe afatet për përcaktimin dhe shënimin e kufijve të territoreve administrative-territoriale i përcakton Qeveria.

Kompetenca e organeve për ndryshimin e ndarjes administrative - territoriale

Neni 9

Nëse në nenin 10 të këtij Ligji nuk është përcaktuar ndryshe, ndarja administrative-territoriale bëhet vetëm me ligj.

Neni 10

Për ndryshimet administrative-territoriale të përcaktuara me këtë ligj vendos Presidiumi i Kuvendit Popullor i RPS-së për këtë çështje:

1. Për krijimin, suprimimin dhe ndryshimin e territoreve të rajoneve të qyteteve dhe vendbanimeve të qyteteve;
2. Për përcaktimin e vendit për qytet në përbërje të rrethit;
3. Për themelimin, fuzionimin dhe suprimimin e njësive ekzistuese administrative-territoriale;
4. Për ndarjen e disa vendbanimeve dhe pjesëve të tyre nga përbërja e territorit të këshillit popullor të vendit, përkatësisht këshillit popullor të qytetit dhe bashkimit të ndonjë këshilli tjetër të vendit të rrethit të njëjtë, përkatësisht këshillit popullor të qytetit, si dhe përmirësimin e kufijve të vendeve dhe qyteteve;
5. Për ndryshimin e emrave të vendbanimeve të caktuara në kuadër të territorit të këshillave popullorë të vendeve, si dhe për ndryshimet e selive të organeve të pushtetit të njësive administrative-territoriale.

Për ndryshimet nga pika 3, 4 dhe 5 për territorin e Krahinës Autonome të Vojvodinës vendos Kuvendi Popullor i KAV. Vendimet e Kuvendit Popullor të KAV nga pika 4, me të cilën ndryshohen

kufijtë e rretheve ose të qyteteve jashtë përbërjes së rrethit si dhe vendimet nga pika 5 i nënshtrohen miratimit nga Presidiumi i Kuvendit Popullor të RPS.

Për ndryshimet nga pika 4 për territorin e Krahinës Autonome të Kosovës e Metohisë vendos Këshilli Popullor Krahinor i KAKM-së, me miratim të Presidiumit të Kuvendit Popullor të RPS-së.

Neni 11

Kontestet për vendet kufitare dhe të qyteteve në kuadër të një rrethi administrativ i vendos këshilli ekzekutiv i Këshillit Popullor të Rrethit. Kontestet për kufijtë e rajoneve të qyteteve dhe vendbanimeve të qyteteve i vendos Këshilli Ekzekutiv i Këshillit Popullor të Qytetit.

Kontestet për kufijtë e territoreve të vendeve dhe qyteteve në përbërje të rretheve të ndryshme dhe kontestet e kufijve të territoreve të vendeve, përkatësisht qyteteve në përbërje të rrethit dhe qytetit jashtë përbërjes së rrethit, në kuadër të një krahine unike i vendos Këshilli Ekzekutiv i Këshillit Popullor Krahinor, ndërsa për territorin e Krahinës Autonome të Vojvodinës, Këshilli Kryesor Ekzekutiv i Kuvendit Popullor të KAV-së.

Kontestet për kufijtë e territoreve të vendeve dhe të qyteteve nga territoret e ndryshme të krahinave i vendos Qeveria.

Dispozitat përfundimtare

Neni 12

Evidencat për ndarjen administrative-territoriale i udhëheq Komiteti për Legjislacion dhe Ndërtim i pushtetit popullor i Qeverisë së RPS-së.

Neni 13

Dispozitat e përafërta për zbatimin e këtij Ligji, si dhe afatet për zbatimin e ndryshimeve administrative-territoriale të përcaktuara me këtë ligj i rregullon Qeveria.

Neni 14

Ky Ligj hyn në fuqi në ditën e publikimit në “Gazetën zyrtare të RPS-së”.

PRESIDIUMI I KUVENDIT POPULLOR I
REPUBLIKËS POPULLORE TË SERBISË

Nr. 59.

Në Beograd, 11 shkurt 1950.

Sekretari

Dr. Millorad Vllajković, d.v.

Kryetari

Dr. Sinisha Stanković, d.v.

(ASHK, Službeni glasnik NRS nr. 7/20 februar 1950)

DOKUMENTI 17

Me Dekretin e Presidiumit të RP të Serbisë më 22 prill 1952 lidhur me vendimin për decentralizimin e aparatit ekonomik dhe administrativ është bërë ndarja e re e territorit të RS Serbisë në komuna, qytete dhe rrethe.

Me Ligjin prej 20 shtatorit 1952 është plotësuar ndarja e paraparë me Dekretin e theksuar.

Nr.	RRETHET	SIPËRFAQJA në km ²
1.	I Vushtrisë	380,00
2.	I Gjilanit	566,97
3.	I Moravës së Epërme	281,40
4.	I Gorës	432,22
5.	I Graçanicës	726,08
6.	I Drenicës	562,16
7.	I Gjakovës	868,71
8.	I Zveçanit	1.100,00
9.	I Istogut	703,34
10.	I Kamenicës	562,29
11.	I Nerodimës	859,63
12.	I Pejës	737,58
13.	I Podrimës	590,79
14.	I Sitnicës	561,04
15.	I Suharekës	416,63
16.	I Sharrit	646,71
17.	I Prishtinës, qyteti	30,86
	Gjithsej	10.671.70

(Stanovništvo Narodne Republike Srbije od 1934 – 1953. Zavod za statistiku i evidenciju N.R. Srbije, Beograd, juna 1953 god. Serija B, Sveska I, fq. 80).

DOKUMENTI 18

Në bazë të nenit 74, pika 3 e Kushtetutës së Republikës Popullore të Serbisë dhe nenit 4, pika 5 e Ligjit për Presidiumin e Kuvendit Popullor të Republikës Popullore të Serbisë, Presidiumi i Kuvendit Popullor i Republikës Popullore të Serbisë shpall Ligjin për ndarjen e Republikës Popullore të Serbisë në komuna, qytete dhe rrethe, të cilin ligj e ka votuar Kuvendi Popullor i Republikës Popullore të Serbisë në mbledhjen e vet prej datës 3 prill 1952 në të cilin thuhet:

Ligji për ndarjen e territorit të Republikës Popullor të Serbisë në komuna, qytete dhe rrethe

Neni 1

